



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2019:288264

Datë: 30.03.2023

Numri i dokumentit: 04138606

**PS.nr. 5/2020**

### **NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË P, DEPARTAMENTI SPECIAL**, trupi gjykues në përbërje nga gjyqtarët Suzana Çerkini, kryetare, M Bajraktari dhe Kujtim Krasniqi dhe anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Vanesa Rama, në çështjen penale kundër të akuzuarve **A F, A S, P F, A F, P F, G F** të gjithë nga P, **M.sh, I.R**, të dy nga F, **R.M** nga fshati S Komuna F.K, **P M** nga G, **D F** nga P, **Xh.S**nga fshati D Komuna H.Et, dhe **K.S** nga Lipjani, të akuzuar sipas aktakuzave të bashkuara PPS.42/2019 e datës 10.12.2019 dhe PPS.nr.105/13 e dates 30.05.2014 për veprën penale Pjesëmarrja dhe organizimi i grupit kriminal të organizuar nga neni 277 par.1 të KPRK, lidhur me veprën penale Importi, eksporti, furnizimi, transportimi, prodhimi, këmbimi, ndërmjetësimi ose shitje e paautorizuar e armëve apo materieve plasëse nga neni 364 par.2 të KPRK, të **ricilësuar** nga gjykata për vepër penale në bashkëkryerje dhe vazhdimësi Importi, eksporti, furnizimi, transportimi, prodhimi, këmbimi, ndërmjetësimi ose shitje e paautorizuar e armëve apo materieve plasëse nga neni 364 par.2 lidhur me nenin 31 dhe 77 të KPRK, pas shqyrtimit gjyqësor të hapur për publikun të mbajtur me datat 10.06.2021, 07.10.2021, 24.03.2022, 16.05.2022, 04.07.2022, 14.07.2022, 15.09.2022, 10.11.2022, 28.12.2022, me praninë e prokurores nga Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës Merita Bina-Rugova, të akuzuarve dhe mbrojtësve të tyre: A F me av. Imer Beka sipas autorizimit, A S me av.Valdrin Behrami sipas autorizimit, P F me av.Ali Beka sipas autorizimit, A F me av. Osman Havolli sipas autorizimit, P F me av.Osman Mehemti sipas detyrës zyrtare, G F me av.Fortesa M sipas detyrës zyrtare, M.sh me av. Kosovare Kelmendi sipas autorizimit, I.R me av. Labinota Qosa Ilazi sipas detyrës zyrtare, R.M me av.Hasan Jashari sipas detyrës

zyrtare, P M me av. Reshat Mku dhe Haxhi Millaku sipas autorizimit, D F me av. Shemsije Sheholli sipas detyrës zyrtare, Xh.Sme av.M N., sipas autorizimit, K.S me av.Qëndrim Reçica sipas autorizimit, me datë 15.12.2022 mori dhe publikisht shpalli këtë:

## **A K T G J Y K I M**

### ***Të akuzuarit:***

1. **A F**, i biri i Rr dhe nënës H, e gjinisë B, i lindur me datë //, në P, ku edhe tani jeton në lagjen //, rr. “//”, nr./, ka të kryer shkollën e mesme, i pa martuar, i gjendjes së dobët ekonomike, i identifikuar me LNJ të RKS me numër personal //, Shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës,
2. **A S**, i biri i Ramizit dhe nënës Sh, e gjinisë B, i lindur me datë // në P, me vendbanim në //, rr.”//”, ka të kryer shkollën e mesme, i pa martuar, i gjendjes së dobët ekonomike, i identifikuar me LNJ të RKS me numër personal \, Shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës,
3. **P F**, i biri i Rr dhe nënës H, e gjinisë B, i lindur me datë // në P, ku edhe tani jeton në lagjen Kodra e Trimave, rr. “//”, nr./, ka të kryer shkollën e mesme, i martuar, baba i dy fëmijëve, i gjendjes së mesme ekonomike, i identifikuar me LNJ të RKS me numër personal //, Shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës,
4. **A F**, i biri i Rr dhe nënës H, e gjinisë B, i lindur me datë // në P, ku edhe tani jeton në lagjen //, rr. “//”, nr./, ka të kryer shkollën e mesme, i martuar, baba i dy fëmijëve, i gjendjes së mesme ekonomike, me numër personal të leternjoftimit të evidentuar nga Republika e Kosovës //, Shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës,
5. **P F**, i biri i Rr dhe nënës H, e gjinisë B, i lindur me datë //, në P, ku edhe tani jeton në lagjen //, rr. “//”, nr./, ka të kryer shkollën emesme, i martuar, baba i dy fëmijëve, i gjendjes së mesme ekonomike, me numër personal të leternjoftimit të evidentuar nga Republika e Kosovës //, Shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës,

6. **M.sh**, i biri i Sh dhe nënës F, e gjinisë T, i lindur me datë /// në fshatin ///, Komuna F, tani jeton në F me vendbanim në rr. “/”, nr.///, ka të kryer shkollën e lartë komerciale, i martuar, baba i tre fëmijëve, i gjendjes së mesme ekonomike, i identifikuar me LNJ të RKS me numër personal ///, Shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës,

7. **D F**, i biri i Imerit dhe nënës Xh, e gjinisë K, i lindur me /// në P, ku edhe tani jeton me vendbanim në rrugën “///i” nr.///, ka të kryer shkollën e mesme, i pa punë, i pamartuar, i gjendjes së mesme ekonomike, i identifikuar me LNJ të RKS me numër personal //// Shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës,

8. **Xh,S**, i biri i Sh dhe nënës L, e gjinisë L, i lindur me ////në fshatin D Komuna H E , ku dhe tani jeton, ka të kryer shkollën e mesme, i pamartuar, i i papunë, i gjendjes së mesme ekonomike, i identifikuar me LNJ të RKS me numër personal /// Shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës,

9. **K.S**, i biri i A dhe nënës A, e gjinisë K/i, i lindur me /// në P, ku edhe tani jeton me vendbanim në L rr:”/” nr.///, i martuar, baba i tre fëmijëve, ka të kryer shkollën e mesme, me profesion këngëtar, i gjendjes së mesme ekonomike, i identifikuar me LNJ të RKS me numër personal ///, Shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës,

## I JANË FAJTOR

Sepse, duke vepruar në bashkëkryerje, me dashje direkte, me marrëveshje reciproke, me qëllim të përfitimit të dobisë pasurore financiare, në shkelje të ligjit të zbatueshëm për armë 05/L-022, në mënyrë të pa autorizuar kanë importuar nga Maqedonia, furnizuar, transportuar, prodhuar, ndërmjetësuar ose shitur armë dhe fishekë në sasi të mëdha dhe atë;

**I.1. Të akuzuarit A F, P F, A F, P F, D F, Xh.Sdhe K.S** gjatë periudhës kohore **01.07.2013 deri më 23.11.2013** kanë kryer veprimet si më poshtë:

- me datë **21.09.2013** i akuzuari **A F** pas marrveshjes me telefon me të pandehurin M B<sup>1</sup>, bashkë me djalin e axhës, të akuzuarin **D F** me veturën “Golf 5” me targa regjistrimi 01-////kanë shkuar në Maqedoninë e Veriut dhe kanë **blerë 153 pistoleta të tipit Ecol Special, Ecol Tun dhe Ecol Jacal Dual dhe 1500 fishekë të kal. 8 mm dhe 9 mm** për t’i importuar në Kosovë, pastaj në anën maqedone të njëjtat armë i janë dorëzuar të akuzuarit **Xh,S**, i cili duke përdorur si mjet transporti kalin e tij ka **transportuar** atë ngarkesë duke e kaluar kufirin në rrugë ilegale, ku gjatë gjithë kohës ishte në kontakt me të pandehurin M B dhe, pasi të akuzuarit A dhe D F kanë kaluar në territorin e Kosovës armët përsëri i janë dorëzuar të njëjtëve në afërsi të restorantit "Alba" në Elez Han, pastaj i akuzuari A përmes telefonit në ora 21:35 ka kërkuar nga vëllezërit e tij, të akuzuarit **P dhe P F** që të shkojnë në Elez Han edhe ata me veturën tjetër “Golf 2” me targa regjistrimi ////, ashtu që duke iu përgjigjur thirrjes së të akuzuarit A, vëllezërit P dhe P F kanë shkuar dhe të gjithë janë takuar në parkingun e restorantit të lartshënuar dhe, pasi armët i kanë vendosur në veturën “Golf 2” me targa ////, pas një kohe të shkurtër të akuzuarit D, P dhe P F janë nisur në drejtim të Ps me veturën “Golf 5” me targa 01-///-ET, kurse i akuzuari A i vetëm, tani me veturën “Golf 2” me targa regjistrimi 01-////është nisur pas tyre, por në fshatin Llugagji Komuna Lipjan, është ndaluar nga zyrtarët policor dhe gjatë kontrollit të dokumenatacionit i njëjti ka ikur nga vendi i ngjarjes duke lënë veturën, derisa në veturë i janë gjetur **72** pistoleta të modeleve të lartshënuara dhe 30 kutia me nga 50 fishek të kalibrave 8 mm dhe 9 mm, ndërsa

- me datë **23.11.2013** në pronat e të akuzuarit A F dhe vëllezërve të tij, në lagjën "Kodra e Trimave" në P me rastin e kontrollit policor janë gjetur gjithsej **81** pistoleta të modeleve të lartshënuara dhe atë **17** pistoleta janë gjetur në objektin përcjellës, ndërsa **64** pistoleta në automjetin "Xhip Suzuki" me targa 06-///-AG që ishte në shfrytëzim të t’akuzuarve Sh dhe F H, e të cilat armë dhe municion i kishin sjellë nga Maqedonia e Veriut në Kosovë pas kontakteve të drejtpërdrejta dhe telefonike me të akuzuarit A dhe M F, kurse të akuzuarit **A F** dhe **K.S** kanë realizuar detyra të caktuara nga të akuzuarit e lartshënuar lidhur me blerjen dhe shitjen e armëve personave të ndryshëm,

**I.2.** Të akuzuarit **A F, A F, P F, A S dhe M.sh**, gjatë periudhës kohore nga fillimi i vitit **2018 deri me datë 24.07.2019** në F, P dhe në vende tjera në territorin e Republikës së Kosovës, në mënyrë të paautorizuar kanë importuar armë dhe municion të kalibrave të

---

<sup>1</sup> Tani në arrati

ndryshme, ashtu që i pandehuri K.i<sup>2</sup> në rolin e furnizuesit nga Republika e Maqedonisë Veriore ka siguruar furnizimin me armë dhe municion për të akuzuarit **A F** dhe **M.sh** të cilët kishin porositur armë (revole) me gas nga i pandehuri K.i, i cili armët varësisht nga porosia i sillte kryesisht deri në kufirin e Republikës së Kosovës, pastaj ndërmjetësuesi i tij përkatësisht i akuzuari **A S** me veturën e tij të tipit Golf V ngjyrë hiri me targa regjistrimi **/// KS ///** i transportonte armët tek të akuzuarit **A F** në **P** dhe **M.sh** në **F** sipas porosisë, ku më pas i akuzuari **A F** në bashkëpunim edhe me vëllezërit të akuzuarit **P, M dhe A F** në punëtorin e tyre në **P** kanë bërë modifikimin e armëve, nga armët me gas në armë të rregullta, të cilat mëpas i **shitnin** të akuzuarve **R.M, N.M dhe I.R**, e të cilët pastaj ato armë të importuara kundërligjshëm i shitnin tek personat e ndryshëm, ashtu që:

- me date **31.05.2019** me rastin e kontrollit nga ana e policisë në automjetin Golf 5 ngjyre hiri me targa **/// KS ///** të cilin e drejtonte i akuzuari **A S**, në hyrje të **Fit** i janë gjetur dhe konfiskuar **10** pistoleta te armëve me gas te Ilojit Ecol Special 99, ndërsa,

- me datën **24.07.2019** në shtëpitë dhe oborrin pronë e të akuzuarve **F**, ne lagjen "Kodra e Trimave" në **P**, janë gjetur dhe konfiskuar armë dhe pjesë të armëve të modifikuara, vegla pune për modifikim të atyre armëve, mjete për shenjzimin e numrave serik të armëve, më saktë ne punëtorinë e shtëpisë së të akuzuarit **A F** nga zyrtaret policor janë gjetur dhe konfiskuar: fishek të kalibrave te ndryshëm, tyta te modifikuara me gjatësi te ndryshme, burgija te plota dhe te thyera, kutia me goditje për vënien e numrave ne metal, pjese metalike te armeve, brusha për pastrim të armeve, ndërsa të **groposura** në dheun në oborrin e shtëpisë së të akuzuarit **A F** nga zyrtaret policor janë gjetur dhe konfiskuar **25** pistoleta te armeve me gas te Ilojit Ecol Jackal Dual cal 9 m dhe Zoraki **///-B**,

- me këtë kanë kryer veprën penale: në bashkëkryerje dhe vazhdimesi Importi, eksporti, Furnizimi, këmbimi, ndërmjetësimi, ose shitja e paautorizuar e armëve apo mjeteve plasëse nga neni 364 par.2 lidhur me nenin 31 dhe 77 të KPRK,

## II.

---

<sup>2</sup> Tani në arati

**Në kuptim të nenit 364 par.1 nënpar.1.3 të KPP, LIROHEN nga aktakuza;**

- **G F**, i biri i Rr dhe nënës H, e gjinisë B, i lindur me datë //, në P, ku edhe tani jeton në lagjen //, rr. “//”, nr./, ka të kryer shkollën e mesme, i martuar, baba i tre fëmijëve, i gjendjes së mesme ekonomike, me numër personal të leternjoftimit të evidentuar nga Republika e Kosovës 1010552253, Shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës,

- për veprën penale si në pikët **I.1 dhe I.2**

- **I.R**, i biri i Et dhe nënës //, e gjinisë O, i lindur me datë // në fshatin B-Komuna V, tani jeton në F me vendbanim në, rr. “//”, p.n., ka të kryer shkollën e mesme, i martuar, baba i pesë fëmijëve, i gjendjes së dobët ekonomike, i identifikuar me LNJ të RKS me numër personal //, Shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës,

- për veprën penale si në pikën **I.2**

- **R.M**, i biri i I/ dhe nënës H/, e gjinisë S/, i lindur me datë // në fshatin M-Komuna L/, tani jeton në fshatin S e M-Komuna F.K, ka të kryer shkollën e mesme, i martuar, baba i tetë fëmijëve, i gjendjes së dobët ekonomike, i identifikuar me LNJ të RKS me numër personal // Shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës,

- për veprën penale si në pikën **I.2**

- Për shkak se nuk është provuar se kanë kryer veprën penale për të cilën janë akuzuar, Pjesmarrja ose organizimi i grupit kriminal të organizuar nga neni 277 par.1 lidhur me veprën penale Importi, eksporti, furnizimi, transportimi, prodhimi, këmbimi, ndërmjetësimi ose shitja e paautorizuar e armëve apo materieve plasëse, nga neni 364 par.2 lidhur me nenin 31 të KPRK,

**III.**

**Në kuptim të nenit 363 par.1 nënpar.1.1 të KPP, REFUZOHET aktakuza ndaj:**

- **P M**, i biri i Sheqirit dhe nënës Syleme, e gjinisë Kiqina, i lindur me datë //// në G// ku edhe tani jeton me vendbanim në rr. “///”, nr, ///, ka të kryer shkollën e mesme, i martuar, baba i katër fëmijëve, i gjendjes së mesme ekonomike, i identifikuar me LNJ të RKS me numër personal ///, Shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës,
  - për veprën penale si në pikën **I.2** të aktakuzës dhe,
- **P F**, për veprën penale si në pikën **I.2** të aktakuzës
- Për shkak se prokurorja është tërhequr nga akuza në shqyrtim gjyqësor;

Andaj gjykata, në bazë të neneve 7,17,21,31,38,39,40,42,43,69,70,77,79 dhe 364 par.4 të KPRK dhe neneve 359,365,366, të KPP i gjykon me:

### **DËNIM ME GJOBË DHE ME BURGIM**

1. Të akuzuarin **A F**, me dënim me **GJOBË** në shumë prej **7.000 (shtatëmijë)** euro dhe dënim me **BURGIM** në kohëzgjatje prej **4 (katër) vjet e 10 (dhjetë) muaj**, në të cilin dënim do t'i llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim nga data 18.12.2013 deri më 29.09.2014, në arrest shtëpiak nga data 25.09.2014 deri më 17.04.2015, poashtu në paraburgim nga data 24.07.2019 deri më 08.04.2020 dhe nga data 30.04.2020 deri më 01.07.2020,
2. Të akuzuarin **P F**, me dënim me **GJOBË** në shumë prej **3.000 (tremijë)** euro dhe dënim me **BURGIM** në kohëzgjatje prej **3 (tri) vjet e 6 (gjashtë) muaj**, në të cilin dënim do t'i llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim nga data 23.11.2013 deri më 23.09.2014, në arrest shtëpiak nga data 23.09.2014 deri më 17.04.2015, poashtu në paraburgim nga data 25.07.2019 deri më 08.04.2020 dhe nga data 30.04.2020 deri më 01.07.2020,

3. Të akuzuarin **A F**, me dënim me **GJOBË** në shumë prej **3.000 (tremijë)** euro dhe dënim me **BURGIM** në kohëzgjatje prej **3 (tri) vjet e 6 (gjashtë) muaj**, në të cilin dënim do t'i llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim nga data 23.11.2013 deri më 11.02.2014, poashtu nga data 25.07.2019 deri më 08.04.2020 dhe nga data 30.04.2020 deri më 01.07.2020,

4. Të akuzuarin **P F**, me dënim me **GJOBË** në shumë prej **3.000 (tremijë)** euro dhe dënim me **BURGIM** në kohëzgjatje prej **2 (vjet) vjet e 6 (gjashtë) muaj**, në të cilin dënim do t'i llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim nga data 18.12.2013 deri më 23.09.2014, në arrest shtëpiak nga data 23.09.2014 deri më 17.04.2015, poashtu në paraburgim nga data 24.07.2019 deri me datë 23.11.2019,

4. Të akuzuarin **A S**, me dënim me **GJOBË** në shumë prej **4.000 (katërmijë)** euro dhe dënim me **BURGIM** në kohëzgjatje prej **2 (dy) vjet e 6 (gjashtë) muaj**, në të cilin dënim do t'i llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim nga data 31.05.2019 deri më 26.06.2019,

5. Të akuzuarin **M.sh**, me dënim me **GJOBË** në shumë prej **2.000 (dy) mijë** euro dhe dënim me **BURGIM** në kohëzgjatje prej **1 (një) viti**, në të cilin dënim do t'i llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim nga data 24.07.2019 deri më 23.12.2019,

6. Të akuzuarin **D F**, me dënim me **GJOBË** në shumë prej **2.000 (dymijë)** euro dhe dënim me **BURGIM** në kohëzgjatje prej **2 (dy) vjet** në të cilin dënim do t'i llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim nga data 18.12.2013 deri më 23.09.2014 dhe në arrest shtëpiak nga data 23.09.2014 deri më 17.04.2015,

7. Të akuzuarin **Xh.S** me dënim me **GJOBË** në shumë prej **1.000 (njëmijë)** euro dhe dënim me **BURGIM** në kohëzgjatje prej **1 (një) viti** në të cilin dënim do t'i llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim nga data 31.05.2019 deri më 26.06.2019,



**8.** Të akuzuarin **K.S** me dënim me **GJOBË** në shumë prej **1.000 (njëmijë)** euro dhe dënim me **BURGIM** në kohëzgjatje prej **1 (një) viti** në të cilin dënim do t'i llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim nga data 31.05.2019 deri më 26.06.2019,

**KONFISKOHEN përherë:**

- Vetura e tipit “Golf 2” me targa regjistrimi 01-/// –BF, pronë e të akuzuarit A F, si mjet i kryerjes së veprës penale,

- Vetura e tipit “Xhip Suzuki” me targa regjistrimi 06-///-AG në oborr të familjes F, si mjet i kryerjes së veprës penale,

- Vetura e tipit “Golf 5” ngjyrë hiri, me targa regjistrimi ///në posedim të t’akuzuarit A S, si mjet i kryerjes së veprës penale,

- Vetura e tipit “Golf 6” me targa regjistrimi 01-///-MM, ngjyrë e kaltër, me numër identifikues të automjetit ////, nr.i librezës CRA 1/// i regjistruar në emër të A Ft si mjet i kryerjes së veprës penale,

- **ARMË** dhe municion që ndërlidhen me veprën penale nga pika **I.1:**

- 153 pistoleta të tipit Ecol Special, Ecol Tuna dhe Ecol Jacal Dual, prej tyre me datë 21.09.2013 të gjetura: 72 pistoleta dhe 1500 fishekë të kalibrit 8 mm dhe 9mm në veturën e të akuzuarit A F, Golf 2” me targa regjistrimi 01-/// –BF, kurse 81 pistoleta tjera të gjetura me datë 23.11.2013 në pronën e familjes së të akuzuarve F, prej tyre 17 pistoleta në objekte përcjellëse dhe 64 pistoleta në veturën Xhip Suzuki” me targa regjistrimi 06-///-AG brenda oborrit të familjes së të akuzuarve F, si dhe një thikë ngjyrë e zezë të gjitha si objekt i veprës penale, pastaj 1 (një) telefon i tipit “Iphone 4”, 1 (një) telefon i tipit Nokia, 2 (dy) telefona të tipit “Nokia”, 1 (një) telefon i tipit “Samsung” dhe 4 (katër) Radiolidhje të tipit “Putian”, si mjete të kryerjes së veprës penale si dhe para të gatshme në shumë prej 820 euro si përfitim nga kryerja e veprës penale:

- **ARMË**, municion dhe sendet që ndërlidhen me veprën penale nga pika **I.2:**

- 10 pistoleta të armëve me gas të llojit “Ecil Special” të gjetura në veturën e të akuzuarit A S derisa i transportonte të njëjtat me datë 31.05.2019, si mjet i kryerjes së veprës penale,
- 25 pistoleta të armëve me gas të llojit “ Ecol Jackal Dual” të kalibrit 9mm dhe Zoraki ///- B të gjetura të groposura në oborrin e shtëpisë së të akuzuarit A F në P gjatë kontrollit të dt 24.07.2019,
- Si dhe mbi 100 fishekë të kalibrave të ndryshëm, pjesë të armëve të modifikuara, vegla për modifikim të armëve, mjete për shenjëzimin e numrave serik të armëve, tyta të modifikuara me gjatësi të ndryshme, burgia të plota dhe të thyera, kutia për goditje për vënien e numrave në metal, pjesë metalike të armëve, brusha për pastrim të armëve, 4 (katër) telefona të precizuara si në Vërtetimet mbi sekuestrimin e përkohshëm të sendeve të dt.24.07.2019
- Në kuptim të nenit 116 të KPP Lirohet Vetura Golf V me targa regjstrimi 01-////ngjyrë hiri metalike, me numër identifikues të automjeit /// me nr.të librezës CRA1060543 i regjistruar në emër të G Ft, meqë nuk ka bazë për mbajtjen e mëtejme të kësaj veture,
- Në kuptim të nenit 266 par.10 të KPP Lirohen llogaritë bankare të përfshira në Urdhërin Ndalues PPRKR.nr.109/19 të dt.26.07.2019 të nxjerrë nga Gjykata Themelore në F,
- Pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, **urdhërohet** shkatërrimi i armëve, fishekëve dhe gjësendeve të tjera për prodhimin e armëve, të precizuara si në dispozitiv të këtij aktgjykimi,
- Pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, **obligohet** Agjencia për Administrimin e Pasurisë së Konfiskuar, të merr nën administrimin e saj pasurinë e konfiskuar -veturat e precizuara si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, në përputhje me Ligjin për Agjencinë Administrimin e Aseteve të Konfiskuara, t’i shes dhe të ardhurat nga shitja e tyre të derdhen në buxhetin e Republikës së Kosovës
- **Obligohen** të akuzuarit secili veç e veç që gjobat e shqiptuara t’i paguajnë në afat jo më gjatë se tre muaj pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, në të kundërtën gjykata do t’ia

zëvendësojë secilit dënimin me gjobë me dënim me burgim, duke ua llogaritur një ditë burgimi me 20 (njëzet) euro gjobë,

- **Obligohen** të akuzuarit që secili veç e veç të paguajnë shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë përfundimtare të kësaj gjykate dhe paushallin gjyqësor në shumë prej **100** (njëqind) euro, poashtu secili të paguajë edhe shumën nga 50 (pesëdhjetë) euro për Programin për kompensimin e viktimave të krimit, të gjitha në afat prej 15 ditësh e jo më gjatë se tre muaj pas plotfuqishmëris së këtij aktgjykimi,

## A r s y e t i m

### **I. Historiku i procedurës**

Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës ka ngritur Aktakuzë PPS.nr.42/19 të datës 10.12.2019<sup>3</sup>, kundër të akuzuarve A F, A S, P F, A F, P F, G F, M.sh, I.R, R.M, N.M dhe P.M, për veprë penale **Pjesëmarrja** dhe organizimi i grupit kriminal të organizuar nga neni 277 par.1 të KPRK lidhur me veprën penale **Importi**, eksporti, furnizimi, transportimi, prodhimi, këmbimi, ndërmjetësimi ose shitje e paautorizuar e armëve apo materieve plasëse nga neni 364 par.2 të KPRK (06/L-074) dhe kjo akuzë në gjykatë është evidentuar me shenjën si lënda PS.nr.5/2020.

Gjykata, përkatësisht Departamenti Special kompetent për të vendosur për aktakuzat e PSRK, fillimisht ka filluar të procedojë me lëndën penale PS.nr.5/2020 (*sipas aktakuzës PPS.nr.42/19*), ashtu që ka mbajtur shqyrtim fillestar me datë 16.01.2020, të akuzuarit përmes mbrojtësve kanë kundërshtuar ligjshmërinë e provave dhe, me aktvendim PS.nr.5/20 të datës 05.10.2020 gjykata ka shpallur të Papranueshme **Provat e siguruara**

---

<sup>3</sup> Aktakuza PPS.nr.42/19 e datës 10.12.2019 përfshinte 20 të akuzuar, mirëpo në fazën e shqyrtimit fillestar dhe të shqyrtimit të parë kryesor, gjithsejt 9 (nëntë) të akuzuar (B.a, F.u, S.N, A.H, k.p, E.B,k.d,B.J dhe S.K) kanë pranuar fajësinë për veprë penale **Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK** dhe për të njëjtit gjykata ka veçuar procedurën dhe ka nxjerrë aktgjykime të cilat tashmë kanë marrë formë të prerë, andaj edhe nuk janë objekt i këtij shqyrtimi gjyqësor. Poashtu pjesë e kësaj aktakuze ishte edhe i akuzuari N.M i cili gjatë fazës së gjykimit është bërë i paarritshëm andaj gjykata edhe për të njëjtin me pajtimin e palëve me aktvendim të datës 15.09.2022 ka veçuar procedurën.

**përmes aplikimit të masave të fshehta dhe teknike të vëzhgimit dhe hetimit nga data 14.01.2019 deri me datë 25.07.2019 vetëm në raport me të akuzuarit R.M, N.M, P M dhe I.R dhe, ky vendim ka marrë formën e prerë në bazë të të cilit gjykata ka vazhduar me shqyrtim gjyqësor<sup>4</sup>**

Gjykata, në fillim të shqyrtimit gjyqësor me Aktvendim të datës 10.06.2021, pa ndonjë vërejtje nga palët, lëndës penale PS.nr.5/2020 ia ka bashkuar edhe lëndën penale PS.nr.29/2020 (sipas aktakuzës PPS.nr.105/13 e PPS.42/19 të datës 07.07.2020)<sup>5</sup> ku i akuzuar ishte M F, pasiqë kishte konstatuar se ky i akuzuar nuk mund të gjykohej për veprë penale të krimit të organizuar si i vetëm dhe, për faktin se provat nga kjo aktakuzë janë të ndërlidhura me aktakuzën PPS.nr.42/19 dhe, ka vazhduar me procedimin e çështjes në shqyrtim gjyqësor si një lëndë e vetme e evidentuar me shenjën PS.nr.5/2020.

Në vazhdim, gjykata, është vënë në dijeni se Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës paraprakisht kishte ngritur poashtu aktakuzë PPS.nr. 105/2013 të datës 30.05.2014 kundër të akuzuarve A F, A F, P F, P F, D F, G F, Xh.S dhe K.S, për veprë penale **Pjesëmarrja** dhe organizimi i grupit kriminal të organizuar nga neni 283 par.1 të KPRK (lidhur me veprën penale **Importi**, eksporti, furnizimi, transportimi, prodhimi, këmbimi, ndërmjetësimi ose shitja e paautorizuar e armëve apo materieve plasëse nga neni 372 par.2 të KPRK (04/L-082) lidhur me nenin 31 të KPRK (04/L-082). Lidhur me këtë aktakuzë çështja ishte gjykuar një herë me Aktgjykim PKR.nr. 303/2014 të datës 18.06.2015, mirëpo me Aktvendim të Gjykatës së Apelit PAKR.nr.542/2015 të datës 18.01.2016 ishte anuluar dhe çështja ishte kthyer në rigjykim.

---

<sup>4</sup> Gjykata nuk ka bërë mbylljen dhe ndarjen fizike të proave të papranueshme nga shkresat e lëndës, meqë të njëjtat kanë qenë të pranueshme në raport me të akuzuarit tjerë, ato prova janë siguruar në procedurë të njëjtë në bazë të një urdhërese të përbashkët.

<sup>5</sup> Duke patur parasysh faktin se PSRK për të akuzuarin M F ka ngritur aktakuzë - me propozim për shqiptimin e masës për Trajtim të detyrueshëm psikiatrik me Ndalim në institucionin e kujdesit shëndetësor, gjykata ka dëgjuar fillimisht ekspertin nga Instituti i Psikiatrisë Forenzike të Kosovës dr. Shpend Haxhibeqiri i cili i ka konfirmuar gjykatës se i akuzuari M F mund të qëndrojë dhe të përcjellë procesin e gjyqimit, për më tepër ka deklaruar se mbetet pranë ekspertizës së dorëzuar në gjykatë të dt. 10.02.2020 për gjendjen e shëndetit mendor të të ekzaminuarit M F, duke ritheksuar konstatimin e dhënë edhe në ekspertizë, se përgjegjshmëria e të akuzuarit M F për veprën penale e cila i vihet në barrë është e zvogëluar por jo në shkallë esenciale, andaj edhe është vazhduar shqyrtimi gjyqësor i bashkuar edhe kundër të akuzuarit M F deri me datë 10.11.2022 kur është bërë veçimi i procedurës ndaj të njëjtit për shkak të pranimit të Raportit të ri nga Instituti i Forenzikës Psikiatrike të dt.09.11.2022 për shëndetin aktual mendor të t'akuzuarit M F.

Gjyakta, duke qenë në dijeni se lënda e kthyer në rigjykim tani evidentohet me PS.nr.100/16 (pra sipas aktakuzës PPS.nr.105/13<sup>6</sup> të datës 30.05.2014) me disa të akuzuar të njëjtë për vepër të njëjtë

penale, por dallon vetëm periudha e kryerjes së veprave penale (gjatë vitit 2013), bënë bashkimin edhe të kësaj lënde, ashtu që në bazë të nenit 35 par.7 dhe 8 të KPP pas shqyrtimit të rrethanave të gjithmbarshme të çështjes, duke vepruar në interes të drejtësisë dhe duke respektuar të drejtën e palëve në procedurë për një gjykim të drejtë në kohë të arsyeshme, e gjithashtu duke pas parasysh se provat e propozuara në këto aktakuza kanë ndërlidhje me njëra tjetrën, dëshmitarët janë të njëjtë, të akuzuarit nga familja F janë thuajse të njëjtë, rrjedhimisht edhe për shkak të ekonomizimit dhe zhvillimit më efikas të procedurës, sipas detyrës zyrtare dhe pas pëlqimit të palëve në procedurë, ka vendosur që procedura të zhvillohet e bashkuar si një çështje e vetme, pra lënda penale PS.nr.100/16 t'i bashkohet lëndës penale PS.nr.5/2020 dhe kjo çështje penalo-juridike të evidentohet me një numër të vetëm të lëndës PS.nr.5/2020 deri në nxjerrjen e aktgjykimit meritator në shkallë të parë dhe, për këtë me datë 05.11.2021 ka nxjerrë aktvendim të veçantë për bashkim të lëndëve.

Meqenëse për lëndën penale PS.nr.5/20 gjykata ka kaluar fazën e shqyrtimit të parë dhe vlerësimit të kundërshtimit përkatësisht të ligjshmërisë së provave, ndërsa lënda penale PS.nr.100/16 veç është në fazë të rigjykimit, atëherë gjykata me përbërje të re të trupit gjykues ka ri filluar shqyrtimin gjyqësor me datë 24.03.2022 si një proces i vetëm gjyqësor duke filluar nga e para, përshtatshmërisht me dispozitat përkatëse ligjore të procedurës penale. Ashtu që, pas leximit të aktakuzave nga prokurorja e çështjes, gjykata duke i vënë të akuzuarit në dijeni për përparësitë dhe pasojat e pranimit të fajësis, mori deklaratimet e të akuzuarve të cilët në prani të mbrojtësve pas konsultimit të mjaftueshëm, në mënyrë të

---

<sup>6</sup> Në aktakuzën PPS.nr.105/13 (lënda penale PS.nr.100/16) ishin të përfshirë edhe të akuzuarit **Sh H dhe F H**, mirëpo sipas konstatimeve zyrtare të policisë gjykata nuk arriti të sigurojë praninë e të njëjtëve në procedurë, për të akuzuarin **Sh H** ka siguruar njoftim joformal se është i vdekur, por nuk ka arritur të sigurojë dëshminë për vdekjen e të njëjtit, ndërsa e akuzuara **F H** sipas konstatimit të policisë, ishte e parritshme, andaj gjykata bazuar në nenin 5 dhe 36 të KPP me pajtimin e palëve në procedurë për shkaqe të arsyeshme ka Veçuar procedurën ndaj të njëjtëve, poashtu duke patur parasysh edhe efikasitetin e procedurës dhe me qëllim të respektimit të drejtës së 15 të akuzuarve të tjerë të përfshirë në këtë çështje penale për gjykim në kohë të arsyeshme pa zvarritje të procedurës, ka nxjerrë Aktvendim të veçantë të dt.24.03.2022 për Veçimin e procedurës penale për **Sh e F Hn** si lëndë e veçantë.

vullnetshme u deklaruan se nuk ndihen fajtorë për veprën penale e cila u vihet në barrë, andaj gjykata vazhdoi me rradhën e paraqitjes së provave, paraqitjen e fjalëve hyrëse të palëve, për të vazhduar me dëgjimin e dëshmitarëve, pastaj administrimin e provave materiale të prezantuara dhe të elaboruara gojarisht nga prokurorja të cilat u janë dorëzuar me kohë mbrojtësve të t'akuzuarve, derisa prova të reja për plotësimin e procedurës së provave të

propozuara nga palët nuk ka patur, mëpas disa nga të akuzuarit kanë paraqitur mbrojtjen e tyre disa të tjerë kanë shfrytëzuar të drejtën e mbrojtjes në heshtje dhe në fund ka pasuar paraqitja e fjalës përfundimtare të palëve.

Prokurorja nga PSRK në fjalën përfundimtare ka bërë precizim të aktakuzës duke i përshkruar veprimet e të akuzuarve si një akuzë me dy pika të dispozitivit, ndaras për periudha kohore për periudhën 01.07.2013 deri më 23.11.2013 dhe 2018 deri më 24.07.2019, mirëpo ka mbetur pranë veprës penale Pjesëmarrja dhe organizimi i grupit kriminal të organizuar nga neni 277 par.1 të KPRK lidhur me veprën penale Importi, eksporti, furnizimi, transportimi, prodhimi, këmbimi, ndërmjetësimi ose shitje e paautorizuar e armëve apo materieve plasëse nga neni 364 par.2 të KPRK (06/L-074) duke i propozuar gjykatës që të akuzuarit të shpallen fajtor dhe të dënohen sipas ligjit, ndërsa për të akuzuarit P F dhe G F ka heqë dorë vetëm nga pika 1.2 e aktakuzës duke mbetur pranë pikës 1.1, ndërsa për të akuzuarin P M është tërhjekur nga aktakuza<sup>7</sup>.

Pas precizimit të aktakuzës së paraqitur nga prokurorja e çështjes në fjalën përfundimtare, gjykata pas konfirmimit dhe pajtimit edhe nga të akuzuarit dhe mbrojtësit e tyre, konstatoi se nuk ka ndonjë ndryshim substancial të veprimeve të t'akuzuarve për të cilat do duhej të deklarohen sërish të akuzuarit.

Ndërsa mbrojtësit e të akuzuarve në fjalën përfundimtare kanë paraqitur secili pretendimet e tyre, por si pretendim i përbashkët i gjithë mbrojtësve dhe esencial, ishte pretendimi për kundërshtimin e ekzistimit të cilësimit të veprës penale si Krim i Organizuar nga neni 277 par.1 të KPRK siç akuzohen të mbrojturit e tyre. Mbrojtësit veq e veq pohuan se nuk janë plotësuar kushtet ligjore që karakterizojnë veprën e tillë penale, qofshin ato obligative apo alternative, duke precizuar se, në rastin konkret nuk ka grup të formuar e të strukturuar me ndarje të roleve, që ka ekzistuar për një periudhë të caktuar kohore nëse struktura

---

<sup>7</sup> I akuzuari Petrit Morina ka qenë i akuzuar vetëm sipas pikës 1.2 të aktakuzës

organizative nuk ka mbështetje në ndonjë strukturë shtetërore ose partiake etj e që në rastin konkret nuk ekzistojnë, pastaj të akuzuarit as që njihen mes vete, të njëjtit nuk kanë patur tendencë për formim të grupit, nuk kanë patur kontakte dhe as nuk kanë patur dijeni se me çka merret secili, së këndejmi nuk kanë patur përfitim të përbashkët material, apo si e kanë ndarë atë përfitim, kush ka qenë udhëheqësi i grupit, sa vepra penale ka kryer grupi, cila ka qenë hierarkia etj. Poashtu mbrojtësit potencojnë edhe faktin se për veprën penale që përfshihet në grupin e veprave penale të krimit të organizuar nga neni 277 par.1 të KPRK parashihet dënimi së paku 4 vjet, ndërsa në rastin konkret vepra penale nga neni 364 par.2 të KPRK parasheh dënimin prej 1-10 vjet. Si përfundim, mbrojtësit kryesisht, propozojnë gjykatës që në kuptim të nenit 364 par.1 nënpar.1.3 të KPP për të mbrojturit e tyre të nxjerrë aktgjykim lirues për veprën penale që u vihet në barrë sipas pikave të akuzës, duke vlerësuar se gjatë shqyrtimit gjyqësor nuk është vërtetuar teza e akuzës.<sup>8</sup>

## **2. Paraqitja e provave në shqyrtim gjyqësor**

Andaj, meqenëse të akuzuarit nuk pranuan fajsinë për veprën penale sipas akuzës **Pjesëmarrja** dhe organizimi i grupit kriminal të organizuar nga neni 277 par.1 të KPRK lidhur me veprën penale **Importi**, eksporti, furnizimi, transportimi, prodhimi, këmbimi, ndërmjetësimi ose shitje e paautorizuar e armëve apo materieve plasëse nga neni 364 par.2 të KPRK (06/L-074), gjykata për të vërtetuar gjendjen e plotë dhe të drejtë faktike vazhdoi me procedimin e çështjes dhe shtjellimin e provave të paraqitura në shqyrtim gjyqësor.

### **Dëshmitë e dëshmitarëve**

**2.1. Dëshmitari G.P**- në seancën e shqyrtimit gjyqësor të dt. 07.10.2021<sup>9</sup> ka deklaruar se e njeh vetëm të akuzuarin *N.Mn për të cilin deklaron shkurtimisht*, ndërsa dëshmitarët tjerë nuk i njeh.

**2.2. Dëshmitari S.A**- në seancën e shqyrtimit gjyqësor të dt.07.10.2021<sup>10</sup> pohon të ketë dhënë deklaratë në polici me dt. 04.10.2019, e konfirmon se të njëjtën e ka nënshkruar

<sup>8</sup> Më poshtë janë të elaboruara fjalët përfundimtare të secilit mbrojtës

<sup>9</sup> Dëshmia e dëshmitarit G.P, me pajtimin e palëve është Lexuar në seancën e shqyrtimit gjyqësor të dt.24.03.2022

<sup>10</sup>Dëshmia e dëshmitarit S.A, me pajtimin e palëve është Lexuar në seancën e shqyrtimit gjyqësor të dt. 24.03.2022.

në të tri faqet. Pastaj deklaroi se nga të akuzuarit i njeh M.shn dhe M Fn, ndoshta që prej dhjetë vjetësh, por mohon të ketë biseduar me telefon me të njëjtit. Pastaj shpjegoi se i akuzuari M ka qenë një herë në shtëpi të tij në fshatin Gumnasellë, Komuna Lipjan, bashkë kanë shkuar në kafene në F te lokali i të akuzuarit Mim, por mohon t'a ketë pyetur Mn për revole, mohon edhe çmën që ia kishte ofruar për revole prej 180 euro, mohon fjalët se “*M i ka thënë nëse Mt ia shet revolen për 180 euro, ty ti jap 20 euro*”, por pas ballafaqimit me deklaratën e dhënë në polici dëshmitari thekson se nuk i kujtohet.

*Në deklaratën e dhënë në polici me datë 04.10.2019 dëshmitari S.A ka deklaruar se te M ka hyrë vet për ti ofruar armën për shitje, por M nuk ka dashtë me e ble, i ka thënë se është duke pritur disa armë me gas, edhe dëshmitari thotë se armën nuk e ka pa, por M i ka thënë nëse ia shet Mt për 180 euro atëherë 20 euro do t'ia jep dëshmitarit S.*

**2.3. Dëshmitarja D F** - në seancën e shqyrtimit gjyqësor të dt. 24.03.2022 pohon të ketë dhënë dy herë deklarata në PSRK me dt. 10.01.2014 dhe 20.01.2014 të njëjtat i ka nënshkruar dhe, është mundu ta thotë të vërtetën, thekson se fillimisht ka shkuar pa ftesë në prokurori për të kërkuar ndihmë ngase i kishte gjashtë vëllezër të arrestuar dhe kishte patur presion të situatës, por edhe nga prokurori i cili sipas të njëjtës i kishte bërë titur, por pastaj sqaron se i njëjti e kishte udhëzuar të thotë të vërtetën dhe e kishte ftuar edhe dy herë të tjera për deklaram. Në vazhdim bisedat telefonike me vëllaun M Fn të zhvilluara me dt. 22.09.2013 nuk i kujtohen, sikur që nuk i kujtohet të ketë thënë se ky vëlla e ka nofkën “Drazhe”, ndërsa e pohon se vëllau Ai e ka patur nofkën “F”. Pastaj dëshmitarja deklaroi se nuk i kujtohen pjesë nga deklarimi i saj sa i përket faktit se në shtëpinë e tyre kanë qenë Sh H dhe F H, se i ka kryer ndonjë shërbim Fs në QKUK, pastaj fakti se çfarë është gjetur në shtëpinë e tyre me rastin e bastisjes. Dëshmitarja më pastaj thekson se tani jeton me Ain dhe Pin, kurse atëherë kanë qenë bashkë, veç vëllau i madh Gi ka qenë i ndarë dhe ka punu si moler, Ai punon me kerre, ndërsa Ai dhe Pi i ndihmojnë Ait me kerre, Pi thotë se ka punu edhe si kamarier, pra të hyrat familjare i kanë patur nga autoservisi për kerre dhe nga rroga e saj meqë ajo punon, për vëllaun Mn thotë se kujdeset krejt shtëpia meqë i njëjti herë është mirë e herë është keq me shëndet, bën telashe në familje, ka nevojë me qetësu, i njëjti poashtu i ndihmon Ait me kerre. Sa i përket objekteve në pronën e familjes në vitin 2013, dëshmitarja thekson se kanë qenë tri shtëpia, njëra shtëpi ku ajo jetonte me Ain dhe Pin, autoservisi ka qenë nën atë shtëpi, Ai ka qenë mjeshtri kryesor, si dhe dy shtëpia tjera, për të akuzuarin D F thekson se e kanë djalë të axhës dhe se shtëpia e



tij është më larg se shtëpitë e tyre, i njëjti ka patur raporte të mira me vëllezërit e saj dhe nuk i kujtohet fakti nëse kanë shkuar në Shkup vëllezërit e saj dhe se nuk ka vërejtur lëvizje të gjësendeve të dyshimta nga vëllezërit e saj në oborrin e tyre.

*Në deklaratën e dhënë në PSRK me datë 10.01.2014 dëshmitarja D F ka deklaruar se përveç D Ft të cilin e ka djalë axhe, gjithë të tjerët me mbiemër F i ka vëllezër. Pastaj ka theksuar se i njeh personat me emrin Sh H dhe F I në bazë të asaj se njëri nga vëllezërit i ka kërkuar asaj që t'a ndihmojë Fn rreth terapisë së saj në Klinikën e Gjinekologjisë ku dëshmitarja punonte dhe, të dy këta persona i ka parë në shtëpinë e saj me dt.23.11.2013 ditën kur janë arrestu vëllezërit e saj. Pi thekson se është student, Ai e udhëheq autoservisin, atij i ndihmon Pi, Gi është i papunë, për Ain thekson se për herë të parë me punë të shitblerjes së armëve merret nga muaji shtator kur ka thënë se po shkon në Shkup me Din, mirëpo pastaj dëshmitarja e ka kuptuar se Ai e ka thirre në telefon Pin e Pin kinse me ia rregullu veturën dhe të dy janë nisur tek Ai, pastaj siç e ka kuptuar dëshmitarja, Ai me veturën "Golf 2" është nisur në drejtim të Ps kurse Pi, Pi e Di janë nisur në drejtim të Ps me veturën "Golf 5" dhe nga atëherë kur i janë zënë një sasi e armëve në afërsi të Lipjanit, Ai e ka ndërprerë këtë aktivitet, këtë e ka kuptuar nga vëllau Gi, për këtë të fundit siç është në dijeni asnjëherë nuk është marrë me këtë aktivitet. Dëshmitarja në fund sqaron se Ai, M dhe Gi jetojnë në një shtëpi, kurse Ai, Pi dhe Pi jetojnë në shtëpinë tjetër.*

*Dëshmitarja D F poashtu në deklaratën e dhënë në PSRK me datë 20.01.2014 përveç bisedës që ndërldhet me vëllaun M F, deklaron se nofka "F" është e vëllaut A F.*

### 3. Mbrojtja e të akuzuarve

**3.1. I akuzuari A F** në shqyrtimin gjyqësor me datë 04.07.2022 ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë deklaratës së dhënë në polici dhe prokurori me datë 03.09.2019 dhe deklaratës së dhënë në polici me datë 29.01.2014 si dhe në shqyrtimin e mëparshëm, që ka të bëjë me lëndën e vitit 2013. Në vazhdim i njëjti thekson se janë gjashtë vëllezër, Pi dhe Ai punojnë si mekanik të veturave në auto-servisin e tyre dhe i akuzuari iu ndihmon, Gi merret me fasada, ndërsa M është i sëmurë, sa i përket personave tani të akuzuar M.sh, N.M, R.M, P M, A S, Xh.Sdhe I.R, të njëjtit thekson se nuk i njeh dhe kurrë nuk i ka parë e as numrat e tyre të telefonit nuk ua dinë dhe nuk ka bërë telefonata me të njëjtit. Sa i përket vitit 2019 i akuzuari deklaron se tek Rrethi i Flamurit në P një person me emrin Luli

të cilin e ka takuar rastësisht dhe i ka treguar për ca armë që i ka, me të njëjtin është takuar edhe dy-tri herë të tjera, pas dy dite me datë 16.04.2019 ia ka sjellur 25 armë me gaz një person me një veturë Golf IV të cilin më parë nuk e ka njohur të cilat edhe i ka pranuar pa dijeninë e vëllezërve. Ky person nuk më ka treguar prej nga i ka marrë këto armë por i duheshin paratë andaj i akuzuari i ka marrë dhe i ka futur në tokë, në oborr të shtëpisë, në një bure të kuqe dhe ato armë policia i ka gjetur gjatë bastisjes. Këto armë i akuzuari thekson se i ka marrë për t'i shitur edhe pse nuk ka arritur t'i shes. ***I akuzuari pohon se është marrë me shit-blerje të armëve, pohon se ka gabuar***, ditën e bastisjes sqaron se janë arrestuar bashkë me të Ai, Pi dhe M. Pastaj, i akuzuari thekson se nuk e njef personin me emrin K.i, ndërsa gjatë arrestimit në vitin 2013 i kujtohet se atë ditë Sh H ka qenë në shtëpinë e tyre me veturën në të cilën janë gjetur armë. Pastaj, deklaron se nuk i kujtohet që me datë 18.04.2019 ka qenë në shtëpinë e R.Mt, mohon se ka qenë tek P M me veturën Golf VI, ngjyrë kaltër e mbylltë, duke sqaruar se ka qenë në Drenas, por jo tek P M. Në vitin 2013 pohon se në veturën Golf i janë zënë 60-70 copa armë, mohon të ketë bërë kthimin e armëve me gaz në armë të vërteta, mohon t'i ketë shitur armë ndonjë personi, ndërsa pohon t'i ketë blerë armët në vitin 2013 dhe vitin 2019, armët i ka blerë 1,800 euro, ndërsa për një copë ka paguar 25 euro. I akuzuari sa i përket periudhës 2013-2018 thekson se ka punuar si taksist për në F.K dhe punë rreth izolimit me keramika, ndërsa mjeshtrë kryesor në auto-servis kanë qenë Pi dhe Ai të cilëve iu kanë ndihmuar edhe vëllezërve tjerë në auto-servisin i cili gjendet përfundi shtëpisë së Ait dhe Pit. Mohon të ketë punuar me D Fn me armë, nuk i njeh as M B n. I akuzuari nuk i mohon se ditën e arrestimit me datë 04.07.2019 në auto-servisin e tyre janë gjetur fishek të kalibrave të ndryshëm, tyta të modifikuara, burgija, mjete për shenjzimin e numrave serik të armëve dhe gjësende tjera që janë gjetë në servisin e tyre, thekson se i ka marrë para 7-8 viteve nga një person që nuk e njeh të cilat ia ka dhënë dikush në pazar të kerreve dhe kanë mbetur aty nëpër blloka të auto-servisit ku i ka mbajtur të fshehura, si dhe 25 pistoleta të groposura,

*I akuzuari A F në deklaratën e dhënë me datë 27.01.2014 në PSRK është mbrojtë në heshtje, ndërsa në deklarimin e dhënë me datën 30.01.2014 në PSRK në praninë e mbrojtësit deklaron se nga numrat e telefonit të precizuara në transkriptet e bisedave të ofruara /// (me nr.të IMEI-it 352////) nuk janë zhvilluar nga numrat që i ka patur në posedim, punon taksist me rreth 400 euro të ardhura mujore, familja e tij posedon gjashtë automjete, Golf V me targa 01-////është vetura e G Ft, Pi është student, Gi është fasader, Ai dhe Pi janë automekanik, Din të cilin e ka djalë axhe punon në “Kujtesë”, Sh dhe Fn nuk i njeh, po*

ashtu nuk i njeh M B , Xh.Sdhe nuk ka patur kontakte me të njëjtin, pohon se ka bërë transportimin e armëve, ndërsa M, Gi, Ai dhe Pi nuk kanë qenë të përfshirë në grup, Pi ia ka sjellur veturën, po ashtu edhe Di nuk ka qenë në dijeni për sendet që kanë qenë në veturë. Në ditën kritike me datë 21.09.2013 aktiviteti i grupit ka qenë vetëm me armë me gaz dhe municion për këto armë, me datë 23.11.2013 gjatë bastisjes në shtëpinë e tij në rr. “Kadri Zeka” në P, por ky personalisht nuk ka qenë prezent dhe nuk ka lidhje me armët e konfiskuara në veturën “Jeep Suzuki” në shfrytëzim të Sh dhe F It të cilët kanë ardhur në shtëpinë e tij për t’ua sjellur këto armë, nuk është në dijeni se kush do të duhej t’ia bënte pagesën, se nga cili vend janë sjellur këto armë, pohon se ka qenë në vizitë në Maqedoni por jo me qëllim të sigurimit të armëve. Sa i përket datës 21.09.2013 kur i janë zënë armët në afërsi të Lipjanit në veturën “Golf II”, sqaron se atë ditë ka qenë me Din në Shkup të Maqedonisë ku janë takuar me Haxhi Becin i cili i ka kërkuar t’ia transportoj një sasi të municionit të armëve me gaz për në Kosovë-Drenicë për shumën prej 200 euro, Di nuk ka qenë fare në dijeni meqenëse ishte duke ngrënë bukë në një qebaptore, janë dakorduar që Haxhi Beci do ta dërgojë municionin deri në Kosovë e pastaj i akuzuari e ka thirrë vëllaun Pin i cili ka ardhur i shoqëruar me P Fn me veturën “Golf II”, pastaj Pi, Pi dhe Di me “Golf V” me të cilin i akuzuari është kthyer nga Maqedonia, janë nisur në drejtim të Ps, kurse vet i akuzuari me veturën “Golf II” pasi është takuar me Haxhi Becin ka futur sasinë e municionit në veturë me qëllim që t’a dërgojë në Drenicë, mirëpo në afërsi të Lipjanit është ndaluar nga policia, por ai ka ikë nga vendi i ngjarjes, ndërsa Pi, Pi dhe Di atë ditë nuk kanë qenë në dijeni për punën që ai e ka bërë.

**3.2 I akuzuari A S** në shqyrtimin gjyqësor me datë 04.07.2022 ka shfrytëzuar të drejtën e tij për mbrojtje në heshtje ndërsa mbetet pranë deklaratës së dhënë më herët.

*I akuzuari A S në deklaratën e dhënë me datë 17.06.2019* në PTH në F në prani të mbrojtësit, ka deklaruar se njihet me personin Kemial Ibishi (që është i pandehuri K.i) një kohë të gjatë dhe me të njëjtin kanë patur kontakte me telefon por edhe kontakte fizike, është takuar në muajin maj në restorant “Liburnia“, ndërsa me datë 30.05.2019 në mbrëmje Kemaili e ka thirrë në telefon dhe janë takuar në kafiterinë “Llagon” në Kaçanik, i njëjti e ka njoftuar se i ka dhjetë revole me gas të cilat dëshmitari duhej t’i dërgojë në Mitrovicë tek një person i nacionalitetit serb, e që si shpërblim për këtë shërbim i ka thënë se do t’ia jep 50 euro.

**3.3. I akuzuari P F** në shqyrtimin gjyqësor të datës 04.07.2022 ka shfrytëzuar të drejtën e tij për mbrojtje në heshtje ndërsa mbetet pranë deklaratës së dhënë në polici.

*I akuzuari P F në PSRK me datë 29.01.2014*, pas leximit të transkripteve të bisedave telefonike thekson se nuk i kujtohen bisedat, gjatë bastisjes në pronën e tyre dhe në veturën “Xhip Suzuki” thekson thotë se nuk ka njohuri, atij i është konfiskuar vetëm një telefon Iphone 4, pohon se ka qenë në Maqedoni me vëllezërit Ain dhe Mn, disa herë edhe Di ka qenë me ta, kanë shkuar për garderojë, por jo lidhur me armët, pranon se kanë shkuar me Pin në Han të Elezit me veturë “Golf 2” të cilën ia kishin lënë Ait dhe bashkë me Pin dhe Din ishin kthyer me Golf 5”.

**3.4. I akuzuari A F** në shqyrtimin gjyqësor të datës 04.07.2022 ka shfrytëzuar të drejtën e tij për mbrojtje në heshtje ndërsa mbetet pranë deklaratës së dhënë paraprakisht.

*I akuzuari A F në deklaratën e dhënë në PSRK me datë 28.01.2014* ka deklaruar se edhe pas leximit të transkriptave të komunikimeve telefonike të bëra në telefonin e tij me persona të tjerë sipas raporteve të policisë të njëjtat nuk i kujtohen, në vazhdim thekson se profesioni i tij është automekanik dhe të ardhurat mujore janë rreth 700 euro përfshirë edhe të bashkëshortes së tij, jetojnë në dy shtëpi në njërën jeton me Pin dhe Pin, kurse në tjetrin janë Gi, M dhe Ai, posedon automjetin “Opel” dhe “WV” kombi ndërsa si familje kanë 6 automjete. Për Mn pohon se punon në auto-servis bashkë edhe me Pin. Nuk i njeh personat Sh dhe F I, M B e as XhSumën. Në vazhdim thekson se sipas dijenisë së tij me aktivitet të armëve është marrë Ai. Për Mn pohon se është tip nervoz dhe nuk flet me të dhe nuk ka njohuri se kush bën marrëveshje për shitblerjen e armëve.

**3.5. I akuzuari P F** në shqyrtimin gjyqësor të datës 04.07.2022 në shqyrtimin gjyqësor me datë 04.07.2022 ka shfrytëzuar të drejtën e tij për mbrojtje në heshtje ndërsa mbetet pranë deklaratës së dhënë paraprakisht.

*I akuzuari P F në deklaratën e dhënë në PSRK me datë 28.01.2014* pas leximit të transkripteve të bisedave telefonike të zhvilluara mes tij dhe personave të tjerë deklaron se është e vërtetë se bisedat janë zhvilluar mes tij dhe personave të tjerë e që kanë të bëjnë me aktivitet me armë me gaz dhe municion dhe këtë aktivitet e kanë filluar nga koha kur është zënë vëllau Ai nga policia në shtator të vitit 2013 dhe garanton se përveç atij, Ait, Pit dhe

Dit vëllezërit e tjerë nuk kanë qenë të përfshirë në këtë aktivitet. Për veten i akuzuari P thekson se ka pasur obligim t'ia dërgoj Ait automjetin Golf II deri në kufi bashkë me Pin. Ndërsa lidhur me bastisjen dhe gjetjen e armëve në shtëpinë e tyre dhe në veturën e Sh Ht me datë 23.11.2013 është njoftuar pas bastisjes. Mohon të jetë bërë modifikimi i armëve meqë armët gjithmonë kanë ardhë të hapura, ndërsa për vete thotë se është automekanik.

**3.6. I akuzuari G F** në shqyrtimin gjyqësor të datës 04.07.2022 në shqyrtimin gjyqësor me datë 04.07.2022 ka shfrytëzuar të drejtën e tij për mbrojtje në heshtje ndërsa mbetet pranë deklaratës së dhënë paraprakisht.

*I akuzuari G F në deklaratën e dhënë në PSRK me datë 27.01.2014* deklaron në prani të mbrojtësit se edhe përkundër ndëgjimit të transkripteve, të komunikimeve telefonike nga numri i telefonit 045/////me persona të ndryshëm, bazuar në raportet e policisë, se nuk i kujtohen bisedat, në vazhdim deklaron se punon si moler dhe të ardhurat mujore të tij janë rreth 700 euro në muaj. Pohon se familja e tij e përbërë nga 6 vëllezërit posedon 5 vetura, M punon në auto-servis si dhe Ai e Pi. Për herë të parë për aktivitet me armë me gaz të vëllaut të tij Ait, Pit, Pit dhe djalit të axhës Dit, ka kuptuar në muajin Shtator mirëpo i njëjti thekson se nuk ka qenë pjesëmarrës në këtë aktivitet, thekson se nuk i njeh personat me emrin Sh dhe F I e as Xh.Se M B . Pohon se në bastisjen e datës 23.11.2013 në familjen e tyre janë gjetur disa telefonë, para dhe disa sende-armë në shtëpinë e vëllezërve si dhe në automjetin Jeep, por nuk i kujtohet sasia e këtyre armëve. Qëllimi i aktivitetit të vëllezërve me armë me gaz ka qenë përfitimi material. Nuk e din saktë se kush ka qenë përgjegjës për të lidhur marrëveshje lidhur me blerjen e armëve Ai apo M, dhe në fund deklaron se ndihet vetëm viktimë meqë nuk është i përfshirë fare në aktivitetin e armëve.

**3.7. I akuzuari I.R** në shqyrtimin gjyqësor të datës 04.07.2022 deklaron se mbetet në tërësi pranë deklaratës së dhënë në polici të datës 23.09.2019 sa i përket të bashkëakuzuarve thekson se asnjërin nuk e njeh përvec M.sht me të cilin jetojnë në të njëjtën lagje në F. Pastaj, thekson se në shtëpinë e tij janë gjetur 119 fishek të moqëm të kalibrave të ndryshëm të cilët i ka pasur që prej kohësh nga viti 2011 të vendosura në shupë dhe të cilat i ka harruar, ndërsa për fishek të tjerë është dënuar një herë me dënim burgimi, pastaj sqaron se të njëjtat i ka nga koha e luftës në Maqedoni kur sic thotë djemtë kanë shkuar ushtar dhe kur janë kthyer i kanë lënë aty. Në vazhdim i akuzuari thekson se ka patur një lokal-kafiteri “Taksi” në F të cilin e ka edhe sot dhe aty ka mund t'i njef Bajram Azizin dhe B.an asgjë

më shumë, pastaj sqaron se në vitin 2019 i ka shfrytëzuar dy telefona me numra të ndryshëm, për A Fn thotë se ka mund të vijë në lokal të tij por nuk e ka njohur dhe për Mn thekson se nuk ka pasur asnjë lloj bashkëpunimi me të.

**3.8. I akuzuari R.M** në shqyrtimin gjyqësor të datës 04.07.2022 ka shfrytëzuar të drejtën e tij për mbrojtje në heshtje ndërsa mbetet pranë deklaratës së dhënë në polici me datën 18.09.2019, ndërsa sa i përket të akuzuarve thekson se të tjerët nuk i njih përvec të akuzuarit P M ngase me babain e të njëjtit-Shaq Morinën ka punuar 13 vite, para lufte në Feronikel në Drenas, me të cilin ka pas raporte të afërta, po ashtu e njëj edhe vëllaun e Pit, Bajramin i cili ka servis të veturave kurse vet i akuzuari ka servis të gomave dhe prej Bajramit merr goma etj., ndërsa djemtë e të akuzuarit bëjnë mirëmbajtjen e veturave të Bajramit tek “Li Vullkanizer”, në S, sqaron se aty janë tri lokale, njëra është vullkanizer tjetra është e “Birra Peja” dhe tjetra është për ngjyrosje të veturave. Ditën e bastisjes me dt.23.07.2019 thekson se i ka treguar policisë se janë afër 10-15 fishekë të gasit prapa lokalit të fshehur të prindit të tij, përndryshe nuk i don armët ngase edhe është plagosur në luftë. Në vazhdim thekson se Ain nuk e njih, mohon të ketë shkuar Ai tek shtëpia e tij edhe pas ballafaqimit se me datë 22.05.2019 në ora 22:00 për herë të dytë një muaj pas herës së parë Ai shkon në shtëpi të tij. Pohon se numri i tij i telefonit është i njëjti numër që e ka pasë përpara edhe të vendosur në reklamë bashkë me dy numrat e dejmeve të tij. Ndërsa për Pin thotë se ka biseduar në telefon dhe vazhdon të bisedojë ngase janë miq dhe punojnë bashkë. Ndërsa numrin e tel. 044///// mohon t’ a ketë përdorur përveç ndoshta siç thotë djemt e kanë lënë në lokal, ndërsa fjalës Gip që ndëgjohet në biseda telefonike thotë se vetëm ai është “Gipa”.

**3.9. I akuzuari M.sh** në shqyrtimin gjyqësor të datës 14.07.2022 ka deklaruar se qëndron pranë dy deklaratave të dhëna në polici me datë 24.07.2019 dhe 27.09.2019, sa i përket të bashkë akuzuarve thekson se përvec të akuzuarit I.R të cilin e njih si fqinjë tek shtëpia dhe e njih që 15 vite, e din se ka një kafene me emrin “Taksi” në F, të tjerët nuk i ka njohur derisa i ka parë në gjykatë. Në vazhdim deklaron se posedon lokalin-kafiterinë “K”, në F, e përshkruan vendndodhjen e kafiterisë, thotës se ndodhet në udhëkryqin “Kemajl Hetemi”, në afërsi të të cilit janë dy parkingje të licensuara si dhe një auto-larje me të cilat vetëm rruga i ndanë, njëri është katër metra distancë, tjetri është ngjitur me parkingun e parë. Për të akuzuarit A, P F, A S dhe K.i thekson se të njëjtit nuk i njih dhe nuk ka pasur kurrfarë kontakte, nuk është në dijeni të jetë ndalur A S me veturë afër shtëpisë së tij. I akuzuari

nuk pranon se dikush i ka ofruar revole për t'ia shitur. Për A Fn thotë se për herë të parë e ka parë në gjykatë, nuk pranon se me të akuzuarin I.R të ketë patur ndonjë biznes, ka blerë apo shitur ndonjë armë, me të njëjtin nuk ka pas kurrfarë biznesi, pastaj tregon se numrin e telefonit në vitin 2019 e ka patur 044//// të cilin e mban në lokal dhe 045//// i cili është numri personal i tij dhe e ka ende, mohon të ketë komunikuar me personin A S me datën 09.04.2019 në ora 07:52 minuta, me numër të telefonit 045//// dhe të jetë përmendur biseda e tij me K.i dhe takimi i tyre në rr. “2 Korriku”, në F, kjo për arsye se numri i telefonit 044////ka qëndruar në lokal dhe aty ka patur 3 punëtorë. Në vazhdim i akuzuari deklaron se shtëpia është larg lokalit rreth një km dhe se lokali gjithmonë ka qenë në adresën “Kemajl Hetemi”, ndërsa adresa e shtëpisë është rr. “Kruja”, në F, mohon faktin që A S të ketë ardhur në shtëpinë e tij, i akuzuari po ashtu mohon të ketë njohur S.An të ketë ardhur në lokalit e tij me qëllim që t'ia shes një armë, mohon të ketë njohur personin me emrin K.i dhe faktin të ketë shkuar në Maqedoni ndonjëherë, mohon konstatimin sipas vëzhgimit në teren të datës 19.04.2019 dhe përcjelljes së A Ft i cili me veturën e tij Golf VI nga P ka shkuar në F tek lokali i M.sht dhe në fund thekson se e ndjen vetën të pafajshëm.

*I akuzuari M.sh në deklarimin e dhënë në Polici në F me datë 24.07.2019 ka deklaruar se të vetmin numër telefoni që e përdorë për rreth 10 vite është 044 /// dhe asnjëherë nuk e ka ndërruar.*

**3.10.** *I akuzuari D F në shqyrtimin gjyqësor të datës 14.07.2022 ka shfrytëzuar të drejtën e tij për mbrojtje në heshtje ndërsa mbetet pranë deklaratës së dhënë në polici.*

*I akuzuari D F në PSRK me datë 29.01.2015 pas leximit të transkripteve të bisedave telefonike sipas raportit të policisë, ka deklaruar se nuk janë të zhvilluara nga ai, punon në Kujtesë, realizon të ardhura mujore në shumë prej 390 euro, ka një veturë “Opel Vectra”, të akuzuarit tjerë i ka djem të axhës të cilët merren me kerre në autoservis, mohon të ketë patur kontakt me të njëjtit lidhur me armë, të tjerët të akuzuar nuk i njeh, lidhur me bastisjen e datës 23.11.2014 në pronën e familjes së Ait thekson se nga motra e tyre D ka kuptuar se armë ishin gjetur edhe në automjetin me të cilin kishin ardhur personat Sh e F H, pohon se me datë 21.09.2013 ka qenë në Shkup me Ain për shopping me veturën “Golf 5”, në Shkup thotë se kanë shkuar shpesh me Ain dhe Mn veq për qef, i kujtohet që Ai i ka thirrë në telefon vëllezërit e tij Pin dhe Pin pasi që kishin kaluar kufirin në Kosovë, thotë se nuk janë kontrolluar as nga policia e as nga doganierët, vëllezërve u ka kërkuar t'ia sjellin veturën “Golf 2” në kufi, ndërsa për faktin se Ait iu kanë zënë armët në “Golf 2” ka kuptuar pasi është kthyer në P. Ai i ka kërkuar Dit që të kthehet me “Golf 2” nga kufiri i Hanit të Elezit*

në P me Pin e Pin, në parkingun e një restorani kanë ndërruar veturat, ndërsa numri i tij i tel është 045////.

**3.11.** *I akuzuari Xh.Snë* shqyrtimin gjyqësor të datës 14.07.2022 ka shfrytëzuar të drejtën e tij për mbrojtje në heshtje ndërsa mbetet pranë deklaratës së dhënë paraprakisht.

*I akuzuari Xh.Snë deklaratën e dhënë në Polici me datë 16.04.2014* në prani të mbrojtësit deklaroi se është i papunë, se nuk i njeh vëllezërit F, ndërsa e njeh M B n që nga vogjësia si shok të babait, thekson se numri i telefonit të Mt është 044////, pasi i lexohet transkripti i bisedës me datë 20.09.2013 në ora 18:58:50 pranon se nga M ka kërkuar me ble një armë për vete për 400 euro, pohon se paratë ia ka dhanë Mt kurse armën M nuk ia ka sjellë. Për transkriptin e datës 21.09.2013 në ora 16:54:33 kur i akuzuari Xhe ka thirrë Mn në telefon, M i ka thënë “kur të nisësh ma bon një telefon” ndërsa Xh ballafaqohet me faktin se është dëgjuar duke ecur këmbë dhe duke marrë frymë thellë”, i akuzuari thekson se ka dalë në gjah.Ndërsa për bisedën në vazhdim sërish me datë 21.09.2013 në ora 17:04:30 kur M e thërret Xhn dhe i thotë ” *veç vazhdo kah unë se e ke të lirë*”, i akuzuari Xh thekson se nuk i kujtohet. Në vazhdim për bisedën vijuese kur M e thërret Xhn në ora 17:27:09 dhe i thotë “*ndërroje drejtimin e rrugës*” i akuzuari Xh thotë se e ka patur qenin në dorë. Lidhur me bisedën telefonike me Mn të datës 21.09.2013 në ora 21:46:28 kur M e ka thirrë dhe i ka kërku mu taku tek “Raiffaisen Bank”, në parking me ia dërgu veturën “Golf 2” te Alba Oil”, kësajsoji edhe ka vepru dhe aty në parking thotë se veturën e ka marrë menjëherë një djalosh të cilin nuk e njeh. Për bisedën telefonike të datës 23.09.2013 në ora 19:09:14 kur M e ka thirrë Xehvahirin dhe Xh e ka pyet Mn “a ke fol me Plit” M i ka thënë “*nuk kam fol por me ra kanë ra sigurisht*”, i akuzuari Xh thotë se i kujtohet ngase M i kish pas thënë se “*kur të vij në ata të Ps ta sjellin një revole për 400 euro,qfarë dush ta sjellin*” dhe e din se kanë pas me ia pru revole të kalibrit 7mm të bardhë origjinale e jo me gaz, se Xh siç thotë e ka shit kalin dhe ia kish pas dhanë Mt 400 euro. Poashtu pohon se M i ka treguar se e ka thirrë vëllau i Ait nga P dhe e ka kërcënuar, ndërsa i akuzuari Xhi ka thënë Mt se shkojmë kur dush në P, dhe në fund pranon se me datë 01.10.2013 në ora 16:52:02 e ka thirrë Mn dhe i ka treguar se ua kishin marrë kerrin atyne “Plive” ata kishin qenë civil, për çka thotë se ka ndëgju prej shoqërisë në Elez Han .

**3.12.** *I akuzuari K.S* në shqyrtimin gjyqësor të datës 14.07.2022 ka shfrytëzuar të drejtën e tij për mbrojtje në heshtje ndërsa mbetet pranë deklaratës së dhënë paraprakisht.



*I akuzuari K.S në Polici me datë 11.03.2014* në prani të mbrojtësit ka deklaruar se është këngëtar me profesion, pranon se e njeh A Fn me të cilin ka komunikuar, të cilin e ka njohur gjatë këndimit në restorantin ish “Internacional” në F para një viti, ku dhe i kanë ndërruar numrat e telefonit, vet e ka patur numrin 045/274-225 ndërsa Ai e ka patur numrin 049 të Ipkos por saktë nuk i është kujtuar, poashtu me Ain ka kontaktuar edhe me një numër tjetër privat ndoshta ka qenë i valës, herën e parë janë takuar te QMI me qëllim me ia beje një armë të cal.7mm me gaz, por Ai ia ka sejtill të cal.9 mm me 15 fishekë ngjyrë e bardhë-krom për çmim prej 90 euro pa fishekë ndërsa me një kuti fishekë 9mm me 50 copa e ka ble për çmim prej 15 euro, arma është në polici ngase ia kanë zënë në restorant Montana në fshatin Prelez ku edhe ka shkrepur dhe për këtë zhvillohet procedurë gjyqësore, e kjo ka ndodhë diku në muajin qershor. Pas dhjetë dite sërish e ka thirrur Ain në tel dhe i ka kërkuar armë të njëjtë me gaz 9mm me 15 fishekë për çmim të njëjtë të cilën Ai ia sjell afër pompës së derivateve Pofix në magjistralen P-Prizren, por këtë armë ia kanë vjedhur nga vetura Mercedes në tregun e automjeteve në Lipjan, por rastin nuk e ka lajmëruar në polici. Menjëherë pas dy ore ka kontaktuar me tel me Ain sërish i ka kërkuar armë, sërish pas një muaji janë takuar në fshatin Konjuh, Komuna Lipjan në vendstacionin e autobusit, arma ka qenë e njëjtë plus dy kutia fishekë.9 mm me gas dhe këtë armë e ka gjuajtur afër fshatit Babush kur e ka parë patrollën e policisë duke bërë kontrollë të automjeteve. Pastaj thekson se ka patur edhe takim tjetër me Ain për blerje të armës së njëjtë 9mm, ngase i duhej për dasëm si dhe 200 fishekë (katër kutia) të cilën armë e ka në polici ngase ka shkrepur në restorant Blinaja diku në muajin korrik ose gusht ku ka qenë musafir bashkë me familje në fshatin Torinë, dhe për këtë zhvillohet procedurë e rregullt penale. Në vazhdim thekson se me Ain është taku pas orës 3 (tre) pasdite ka ble armë tjetër me 9mm ngjyrë e zeë me 50 fishekë, e pohon bisedën e datës 27.07.2013 në ora 19:05:25 kur i thotë Ait se vjen një person nga Shkupi me beje armë, e pohon edhe bisedën telefonike me Ain me dt.29.07.2013 në ora 23:19:23 për ndërrim të armës për ngjyrë, armët thotë se i ka kërkuar për vete e jo për biznes, ndërsa sa i përket të tjerëve nga familja F thotë se nuk i njef.

*I akuzuari K.S në polici me datë 17.03.2014* në prani të mbrojtësit ka deklaruar lidhur me vjedhjen e armës nga vetura, me ç’rast ka sqaruar se armën e ka ble nga Ai ditën e shtunë, e ka fut në veturën e vet Mercedes S 500, në dollapin afër ndërruesit të shpejtësisë, është nis menjëherë në drejtim të tregut të veturave në Lipjan në pronësi të vëllezërve Buja me qëllim me e shit veturën, e ka parkuar veturën dhe është larguar për të shiquar vetura të

tjera, ka ndodhë që veturën e tij siç thotë e kanë vozitë për me e provu persona të tjerë vetëm vëllaun e pronarit e njeh të tjerët jo, arma ka qenë me gaz 9mm e bardhë dhe pasi ia kthye djaloshi pas 5 min e ka parë që nuk është arma në veturë.

#### **4. Fjala Përfundimtare e palëve**

**4.1 Prokurorja nga Prokuroria Speciale** në fjalën përfundimtare të prezantuar në formë të shkruar dhe të elaboruar gojarisht deklaroi se, edhe një herë jep shpjegimin se në precizimin e dorëzuar për mbrojtësit është bërë vetëm ndarja e veprimeve të t'akuzuarve dhe qëllimi i veprimtarisë me të cilën janë marrë të njëjtit dhe atë në dy dispozitivët, ashtu që dispozitivi i parë përfshinë periudhën kohore nga korriku 2013 deri në nëntor 2013, ndërsa dispozitivi i dytë përfshinë periudhën kohore prej 2018 deri në Korrik 2019, që dmth se nuk ka asnjë asnjë ndryshim substancial të veprës penale apo tejkalim eventual të akuzës. Përkundrazi, nga **dispozitivi i dytë janë larguar P F dhe G F** për të cilët prokuroria konsideron se nuk është vërtetuar se kanë marrë pjesë në veprimtarinë e këtij grupi në këtë periudhë kohore pra gjatë 2018-2019. Në vazhdim thekson se, vepra penale e Krimin të organizuar është një vepër penale e cila kryhet në kontinuitet, disa prej të akuzuarve janë të përfshirë në të dy periudhat ndërsa disa të tjerë vetëm në njërin prej tyre, mirëpo kualifikimi penal mbetet i njëjtë sepse vepra penale e Krimin të organizuar konsiderohet e konsumuar edhe në raste kur kryersi e kryen vetëm një veprim me të cilin ka dhënë kontribut substancial për kryerjen e veprës penale bazë. Prokuroria konsideron se sa i përket të akuzuarit P M pas administrimit të provave nuk është dëshmuar se i njëjti e ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet ashtu që ndaj të akuzuarit **P M është tërhequr nga ndjekja e mëtejme penale**, ndërsa për të gjithë të akuzuarit tjerë nga provat e administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor është dëshmuar se i kanë kryer veprat penale për të cilat akuzohen, shumica e provave janë të siguruara me rastin e kontrollit policor apo si rezultat i masave të fshehta dhe nga kjo arsye kanë fuqi provuese maksimale, është dëshmuar se ky grup ka vepruar me qëllim të përfitimit të dobisë financiare si grup i organizuar kriminal në periudhën kohore prej gjashtë vitesh edhe pse me intensitet të ndryshëm. Duke marrë parasysh këtë interval kohor të gjatë në të cilin anëtarët kanë mbetë të njëjtë është e qartë se grupi nuk është formuar rastësisht përpos kësaj shumica e anëtarëve të grupit kanë lidhje familjare me njëri tjetrin ashtu që edhe ky fakt dëshmon për stabilitetin e grupit dhe veprimtarinë e tyre, trafikimi me armë gjithashtu ka mbetë i njëjtë, përkundër faktit se në vitin 2014 kundër tyre është ngritur aktakuza për vepra të njëjta penale. Sipas

definicionit të grupit kriminal të organizuar një grupi i tillë sipas nenit 113 par.13 të KPRK duhet të ekzistoj si bashkim i strukturuar, sipas par.14 grupi i strukturuar e parasheh bashkimin cili nuk është formuar rastësisht për kryerjen e menjëhershme të veprës penale por nuk është e nevojshme që anëtarët e këtij bashkimi të kenë role formalisht të përcaktuara në vazhdimësi të anëtarësisë apo strukturë të ndërtuar. Andaj, siç thekson prokurorja ky grup kriminal i ka të gjitha tiparet e grupit të organizuar, të strukturuar kriminal, përpos elementeve esenciale të veprës penale të Krimin të organizuar nga neni 277 par.1 të KPRK i ka edhe të gjitha karakteristikat jo obligative siç është ndarja e detyrave e cila është e përshkruar në dispozitivin e precizuar apo elementi ndërkombëtar i veprimtarisë kriminale dhe, i propozon gjykatës që të akuzuarit t'i shpall fajtor dhe t'i dënojë sipas ligjit, gjithashtu mbetet propozimit për konfiskimin e aseteve të cilat kanë qenë të konfiskuara përkohësisht.

**4.2. Mbrojtësi i të akuzuarit A F, av.Imer Beka në fjalën përfundimtare** deklaron se, kundërshton pretendimet e organit të akuzës sipas të cilave të mbrojturit të tij i vihet në barrë vepra penale e krimin të organizuar nga neni 277 par.1 lidhur me nenin 3 të KPRK lidhur me veprën penale nga neni 364 par.2 të KPRK, si të paqëndrueshme, për faktin se kanë munguar prova reale dhe të besueshme. Në vazhdim mbrojtësi deklaron se aktakuza mbështetet kryesisht në përgjime dhe vëzhgime pa ndonjë rezultat konkret me sekuestrim të disa revoleve me gaz të cilat shërbejnë vetëm për të krijuar zhurmë e të cilat asnjëherë nuk janë modifikuar në armë. Ndërsa, gjatë përgjimeve të bisedave telefonike asnjëherë nuk është përmendur tregtimi me armë, ndërsa video-incizimet mbeten vetëm supozim i pabazuar në prova bindëse të cilat vërtetojnë ndonjë provë faktike, sa i përket armëve me gaz të gjetura në oborrin e të mbrojturit të tij, mbrojtësi thekson se të njëjtat nuk janë modifikuar e as nuk janë shitur, të njëjtat janë lënë nga një person në emër të një borxhi. Andaj, konsideron se konform dispozitës së nenit 3 të KPP-së mëdyshjet duhet interpretuar në favor të të pandehurit në mbështetje të parimit In Dubio Pro Reo meqë prokuroria nuk ka vërtetuar në mënyrë të plotë dhe të saktë faktet e rëndësishme për marrjen e vendimit nga gjykata. Andaj, kërkon nga gjykata në bazë të dispozitës së nenit 361 të KPP-së që të merr vendim vetëm në bazë të provave të administruara në shqyrtim gjyqësor. Në fund, propozon gjykatës të nxjerrë Aktgjykim Lirues për të mbrojturin e tij meqë nuk është provuar se i njëjti ka kryer veprën penale që i vihet në barrë.

**I akuzuari A F** në fjalën përfundimtare deklaron se e mbështet fjalën përfundimtare të mbrojtësit dhe shton se, vëllezërit e tij nuk kanë të bëjnë me këtë vepër penale. Armët nuk ia kam shitë askujt, armët e groposura i ka futë në dhe edhe aty kanë mbetë të njëjtat thuajse

i ka harru, sa i përket tytave të armëve ato kanë qenë në punëtori që para 7-8 viteve, të akuzuarit tjerë nuk i ka njohur më parë, vëllau G ia kanë marrë veturën edhe pse nuk është gjetur asgjë në të dhe i njëjti cdo herë ka vështirësi me e dërgu djalin e sëmure te mjeku.

**4.3. Mbrojtësi i të akuzuarit A S, av.Valdrin Behrami në fjalën përfundimtare** deklaron se: i mbrojturi i tij ka pranuar veprën penale të armëmbajtjes pa leje dhe tanimë është penduar, por nuk e ka pranuar veprën penale që i vihet në barrë sipas akuzës. Përndryshe, i njëjti nuk ka pasur asnjë lidhshmëri apo raport me të bashkëpandehurit tjerë, nuk ka të kaluar kriminale, andaj i propozon gjykatës që fillimisht të bëjë ndryshimin e kualifikimit ligjor të veprës penale të propozuar nga ana e organit të akuzës e pastaj t'ia shqiptoj një dënim minimal sa i përket veprës penale të mbajtjes në kontroll apo posedim të armëve pa leje.

**I akuzuari A S** në fjalën përfundimtare deklaron se e mbështet fjalën përfundimtare të mbrojtësit të tij dhe nuk ka çfarë të shtojë më tepër.

**4.4. Mbrojtësi i të akuzuarit P F, av.Ali Beka në fjalën përfundimtare** të prezantuar në formë të shkruar dhe të elaboruar gojarisht deklaron se, vepra penale e krimit të organizuar është e paqëndrueshme, pastaj mbrojtësi thekson se nuk ka individualizim të veprimeve të secilit të akuzuar, dhe poashtu nuk ka prova të cilat vërtetojnë kryerjen e veprës penale që i vihet në barrë të mbrojturit të tij. Në përgjime, biseda telefonike të të mbrojturit të tij siç thekson mbrojtësi, nuk përmendet asnjë fjalë lidhur me importimin, eksportimin e armëve apo modifikimin e tyre, andaj përgjimet e inqizimet nuk kalojnë pragun e supozimit, andaj nuk ka mund të akuzohet bazuar në supozime duke imagjinuar edhe qëllimin, përderisa ato përgjime nuk kanë mbështetje edhe në ndonjë provë tjetër, andaj meqë ka mëdyshje për faktet vendimtare se i mbrojturi i tij ka kryer vepër penale siç pretendon prokuroria, konform nenit 3 të KPP mëdyshjet duhet të interpretohen në favor të akuzuarit e që korrespondon edhe me parimin in dubio pro reo, sepse sipas nenit 7 të KPP çdo pjesmarrës në procedurë penale detyrohet që saktësisht dhe tërësisht të vërtetojë faktet që janë të rëndësishme për marrjen e vendimit të ligjshëm, andaj meqë nuk është provuar se i mbrojturi i tij ka kryer vepra penale si në aktakuzën propozon që në pajtim me nenin 364 par.1 nënpar. 3 të KPP t'a lirojë nga akuza.

**I akuzuari P F** në fjalën përfundimtare deklaron se e mbështet fjalën përfundimtare të mbrojtësit të tij dhe nuk ka çfarë të shtojë më tepër.

**4.5. Mbrojtësi i të akuzuarit A F, Av.Osman Havolli në fjalën përfundimtare** të prezantuar në formë të shkruar dhe të elaboruar gojarisht deklaron se, fillimisht kundërshton ekzistimin e veprës penale të Krimit të organizuar, ngase vepra kryhen me anë

të kërcënimeve, shantazheve, dhunës fizike e psiqike, korrupsionit, me shfrytëzim të lidhjeve me policinë dhe gjykatat apo administratën dhe aktiviteti kriminal karakterizohet me shtrirje regjionale apo ndërkombëtare me qëllim të fitimeve të mëdha duke krijuar kapital të madh, kryesit e krimit të organizuar janë profesionist dhe gjatë kryerjes së veprimeve të tyre inkriminuese, planifikojnë dhe i koordinojnë punët dhe detyrat të cilat detyrimisht duhet të zbatohen duke përdorur dhunën, shtrëngime, vrasje terror e frikësime me qëllim që ti realizojnë qëllimet e tyre. Poashtu kundërshton konstatimin e prokurores të paraqitur në fjalën përfundimtare, se “vetëm me një veprim të ndërmarrë konsiderohet se ka dhënë kontribut substancial në kryerjen e veprës penale të krimit të organizuar”. Në vazhdim i njëjti deklaron se i mbrojturi i tij ngarkohet për kryerjen e veprës penale bazë gjatë dy periudhave, mirëpo i njëjti jeton ndaras nga vëllezërit e tij, bashkë me Pin dhe Peteritin merret me servisimin dhe meremetimin e veturave, konkretisht është i specializuar për koka të timonëve të veturave ndërsa vëllau Ai merret me shitblerje të automjeteve, mirëpo në aktakuzë është përgjegjësia kolektive meqë siç përshkruhet për veprën penale sipas dispozitivit të parë rrjedh se të gjithë të akuzuarit i kanë sjellur armët, që nënkupton se prokuroria nuk i ka individualizuar veprimet inkriminuese të secilit. Sa i përket veprës penale nga dispozitivi i dytë nuk është arritur të provohet se kush i kishte vendosur armët e groposura, meqë shtëpia e të mbrojturit të tij është 110 m në distancë nga armët e gjetura, pastaj nuk është e precizuar sa armë u gjetën në proqes pune, sa pjesë të armëve të modifikuara, sa burgia, sa brusha etj, të gjetura në punëtorinë e tij, edhe pse nuk është provuar të kujt janë, nuk është bërë ekspertizë balistike për t'i krahasuar me armë që janë modifikuar. Në vazhdim mbrojtësi thekson se cilësimi juridik i veprës penale me krim të organizuar është i paqëndrueshëm duke pas parasysh shkallën e rrezikshmërisë meqë bëhet fjalë për pistoleta me gas të cilat mund të gjenden kudo në tregjet e Kosovës dhe mund të blihen prej 30-50 euro, Mbrojtësi në fund shpjegon se i mbrojturi i tij jeton me vëllaun Pin, të dy kanë nga dy fëmijë, kanë edhe nënën dhe motrën e tyre, në fund kërkon nga gjykata që faktet e paprovuar t'i interpretojë në favor të të mbrojturit të tij dhe të njëjtin t'a lirojë nga të dy pikat e akuzës.

***I akuzuari A F*** në fjalën përfundimtare deklaron se e mbështet fjalën përfundimtare të mbrojtësit të tij dhe nuk ka çfarë të shtojë më tepër.

**4.6. Mbrojtësi i të akuzuarit P F, av.Osman M në fjalën përfundimtare** deklaron se, nuk është vërtetuar se i mbrojturi i tij ka kryer vepra penale e Krimit të Organizuar që i vihet në barrë dhe se përshkrimi i të njëjtës si në akuzë nuk është i saktë. Sa i përket provave materiale të njëjtat nuk vërtetojnë ndonjë veprim inkriminues që do të thotë se edhe provat

që janë të siguruara janë thellësisht të pambështetshme, të bazuara në disa masa të fshehta, të pavërtetuara. Në dispozitiv të aktakuzës nuk përmendet emri i të mbrojturit të tij gjatë kontrollimit të shtëpisë apo punëtorisë si dhe gjatë konfiskimit të armëve, i njëjti nuk është gjendur fare në shtëpi. Andaj, kërkon nga gjykata që i mbrojturi i tij të lirohet nga aktakuza. **I akuzuari P F** në fjalën përfundimtare deklaron se e mbështet fjalën përfundimtare të mbrotjtësit të tij dhe nuk ka çfarë të shtojë më tepër.

**4.7. Mbrojtësja e të akuzuarit G F, av.Fortesa M në fjalën përfundimtare** të prezantuar në formë të shkruar dhe të elaboruar gojarisht deklaron se, në tërësi i kundërshton pretendimet e prokurorisë për veprën penale që i vihet në barrë, ngase akuza nuk saktëson kryerjen e kësaj vepre penale me atributet që dalin nga neni 277 paragrafi 1 i KPRK-së, i njëjti të gjitha kontributet e fituara materiale i ka nga përvoja e tij 20 vjeçare “si moler” i shtëpiave, ka një fëmijë të sëmurë dhe maksimalisht është i angazhuar në përkujdesjen e tij, andaj kërkon nga gjykata të ketë parasysh gjitha këto rrethana gjatë matjes së dënimit. **I akuzuari G F** në fjalën përfundimtare deklaron se e mbështet fjalën përfundimtare të mbrotjtëses së saj dhe nuk ka çfarë të shtojë më tepër.

**4.8. Mbrojtësja e të akuzuarit M.sh, av.Kosovare Kelmendi në fjalën përfundimtare** të dorëzuar në formë të shkruar dhe të elaboruar gojarisht deklaron se, prokuroria nuk ka ofruar prova direkte madje as rrethanore që argumentojnë se tek i mbrojturi i saj janë konstatuar veprime inkriminuese në të cilat do të përmbusheshin elementet e veprave penale që i vihen në barrë. Sipas dispozitivit të dytë të aktkuzës i mbrojturi i saj M.sh ka porositur armë nga i pandehuri K.i mirëpo nuk ka përshkrim tjetër të veprimeve të tij e as ndonjë provë me të cilën është vërtetuar një pretendim i tillë, se i njëjti ka porositur armë. Pra nuk ka prova e as përshkrim të veprimeve të tij as komunikime telefonike siç i precizon prokuroria në arsyetim të akuzës, mirëpo nuk ka të tilla komunikime me përmbajtje për porosi të armëve, blerje apo transport të armëve me cilindo të pandehur. Ndërsa sa i përket fotografive të të pandehurve të tjerë të nxjerra me aplikimin e masave të fshehta në parkingun afër lokalit të të mbrojturit të saj te “K” në F, sipas mbrojtjes në ato fotografi nuk shihet as lokali, as vet M.sh, e as ndonjë i pandehur duke hyrë në lokal të tij, rrjedhimisht i mbrojturi i saj nuk ka pas njohuri e as kontakte me ndonjërin të bashkëpandehur. Mbrojtja e konteston lokacionin e lokalit dhe shtëpisë së të mbrojturit të saj duke thënë se lokali gjendet në udhëkryqin “Kemajl Hetemi” dhe se në të dy anët ka parkingje, ndërsa shtëpia gjendet në rrugën “Kruja” në F, derisa nga skica e zyrtarit policor dy fotografi të nxjerra nga CD e prokurorisë e shënuar me GPS Follideri II ind.22 shihet rruga “2 Korriku” ndërsa shigjeta i referohet një rrugëtimi në rr. “Nikë Prela” e “Qamil

Ilazi” dhe në shenjën stop te rr. “Kemajl Hetemi”. Nga bisedat telefonike janë përmendur fjalët “te M apo te lokali i Milës”, mirëpo sipas logjikës së analizës së provës më tepër len të kuptohet se bisedat e të pandehurve të tjerë lokalin e M.sht e kanë përmendur si pikë orientuese e jo si vendtakim për veprimtari ilegale. Pastaj edhe pse me masa të fshehta me vendosjen e GPS në makina te dy të bashkëpandehurve, hetuesit kanë konstatuar në raportet e tyre se makina e A Ft është ndalur afër shtëpisë së M.sht, nuk ka fotografi të tij, andaj nuk mund të dënohet sipas interpretimeve të gabueshme të hetuesve policor, apo sipas logjikës nëse është parkuar afër shtëpisë së Mt edhe M ka porositur armë. Në vazhdim mbrojtësja thekson se i mbrojturi i saj gjatë deklarimit në gjykatë ka pohuar se ka përdorur numrin e telefonit 044////-/// të cilin e ka lënë çdo herë në lokal,se lokalin e hap zakonisht në ora 10 të ditës, mohon të ketë kontaktuar me të akuzuarin A S nga numri i tel 045/////me dt. 09.04.2019 në ora 07:52 apo me K.i,duke thënë se në lokal i ka tre puntorë dhe ka pas mundsi ata kanë folë. Ndërsa prokuroria konstaton se K.i me këtë datë dhe në këtë kohë bisedon me Mn dhe i thotë se duhet të takohen menjëherë tek vendi, kurse M i thotë se “po është herët ende nuk është qel aty”, pastaj K.i i thotë po vij pra tek ti, M i thotë “hajde veç të bëhem gati se kesh duke fjetë”, i akuzuari Mim në gjykatë ka pohuar se ka patur dy numra telefonik. Në fund mbrojtësja deklaron se nga provat e prokuroris rezulton se në raport me të akuzuarin M.sh nuk mund të bëhet fjalë për kontrabandim me armë apo veprim tjetër inkriminues nga neni 364 par.2 të KPRK e absolutisht jo për krim të organizuar, i njëjti vetëm se është joshur dhe provokuar për t’u implikuar në vepër penale të kontrabandimit të armëve, andaj konsideron se nuk mund të shpallet fajtor për shkak të interpretimeve të gabuara të hetuesve policor apo interpretimit se nëse dikush është parkuar afër shtëpisë së Mt se vërtetë M ka porositur armë. Andaj konsideron se i mbrojturi i saj ka të drejtën e plotë që ky gjykim ndaj tij të përfundojë me aktgjykim lirues.

I akuzuari **M.sh** në fjalën përfundimtare deklaron se e mbështet fjalën përfundimtare të mbrojtjes së saj dhe nuk ka çfarë të shtojë më tepër.

**4.9. Mbrojtësja e të akuzuarit I.R, av.Labinota Qosa-Ilazi në fjalën përfundimtare** të prezantuar në formë të shkruar dhe të elaboruar gojarisht dekalron se, prokuroria ka dështuar të paraqes provat relevante të argumentuara të cilat vërtetojnë se i mbrojturi i saj ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet, përkatësisht nuk është paraqitur ndonjë rrethanë konkrete nga e cila do të kuptohej se i njëjti ka marrë pjesë në mënyrë aktive në veprimtari kriminale të grupit të organizuar, nuk ka të përshkruar ndonjë aktivitet kriminal të kryer me dashje apo me dijeni se do të përfitoj grupi kriminal i përshkruar si në aktakuzë.

Në vazhdim, mbrojtësja përshkruan karakteristikat obligative dhe ato alternative të cilat duhet të ekzistojnë si elemente që formësojnë figurën e veprës penale të Krimit të Organizuar të cilat bazuar në provat e administruara nuk janë plotësuar në rastin konkret, nuk dihet struktura udhëheqëse, kush është lideri i grupit, kush jep urdhëra, kush është zbatuesi i urdhërave, cilat janë detyrat për secilin anëtar të grupit, nuk ka ekzistuar ndonjë disiplinë apo kontroll brenda grupit, nuk ka përshkrim të pasojës në rast të moszbatimit të urdhërit nga udhëheqësi i grupit etj., që janë karakteristika të grupit kriminal të organizuar e që këtë e dëshmojnë edhe vet të akuzuarit, shumica e tyre nuk janë njohur mes vete, përveç atyre që janë anëtarë të familjes. Andaj, propozon gjykatës se të mbrojturin e tij t'a shpallë të pafajshëm dhe t'a liroi për veprën penale që i vihet në barrë.

**I akuzuari I.R** në fjalën përfundimtare deklaron se e mbështet fjalën përfundimtare të mbrojtësit të tij dhe nuk ka çfarë të shtojë më tepër.

**4.10. Mbrojtësi i të akuzuarit R.M, av.Hasan Jashari në fjalën përfundimtare** të prezantuar në formë të shkruar dhe të elaboruar gojarisht deklaron se, nga provat në shkresat e lëndës është vërtetuar se i mbrojturi i tij nuk ka pasur asnjë lidhje me të akuzuarit e tjerë me përjashtim të P Morinës të cilin e ka pas mik shtëpie, i cili në shqyrtim gjyqësor ka deklaruar se rregullisht ka marrë goma dhe i ka dhënë pjesë të veturave R.Mt, andaj kundërshton ekzistimin e veprës penale të Krimit të Organizuar e cila i vihet në barrë të mbrojturit të tij, për të njëjtin nuk ka asnjë provë se ka shitë armë meqë nuk precizohet se kujt i ka shitë armë. Të njëjtit nuk i janë gjetur armë në shtëpinë e tij, përveç municionit me gaz e që konsideron se kjo nuk është vepër penale, por mund llogaritet vetëm si një kundërvajtje. Në fund, mbrojtësi i propozon gjykatës që ndaj të njëjtit pasiqë nuk është vërtetuar se ka kryer veprën penale të merr Aktgjykim Lirues.

**I akuzuari R.M** në fjalën përfundimtare deklaron se e mbështet fjalën përfundimtare të mbrojtësit të tij dhe nuk ka çfarë të shtojë më tepër.

**4.11. Mbrojtësja e të akuzuarit D F, Av.Shemsije Sheholli** në fjalën përfundimtare deklaron se: në veprimet e të mbrojturit të saj nuk përmbushen elementet e veprës penale nga neni 277 paragrafi 1 lidhur me nenin 364 paragrafi 2 të KPRK-së. Ndërsa, në rastin konkret mbrojtësja ka deklaruar se i mbrojturi i saj është akuzuar vetëm se është anëtar i familjes F, mirëpo përgjegjësia penale duhet të jetë individuale, përndryshe i njëjti me datën 21.09.2013 ka shkuar në Shkup “për të blerë patika”, ka udhëtuar me automjetin Golf 5 me targa 01-///-ET, ka qenë vetëm pasagjer, gjatë kthimit me automjetin e tij ndonëse është ndaluar nga Policia në fshatin Llugagji të Komunës së Lipjanit nuk janë gjetur armë, e as në shtëpi të tij nuk i është gjetur asnjë armë. Në vazhdim mbrojtësja deklaron se në



aktakuzë nuk janë të përshkruara veprimet inkriminuese të të mbrojturit të saj dhe as nuk ka paraqitur prova për t'a mbështetur dyshimin e bazuar mirë se i mbrojturi i saj ka kryer veprën penale që i vihet në barrë, sa i përket përgjimit të telekomunikimit të palëve deklaron se është i ndaluar me nenin 8.2 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut sepse cenohet e drejta themelore e njerëzve në privatësi dhe këtë e ka konstatuar Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut se shtetet mund të shërbejnë në përgjimet e telekomunikimeve vetëm në rastet kur kanë të bëjnë me siguri nacionale. Andaj, sipas mbrojtëses nuk është e lejuar që Aktgjykimi ndëshkues të mbështetet në përgjimet e bisedave telefonike. Në fund, mbrojtësja deklaron se i mbrojturi i saj ka qenë i moshës së re, afërsisht 20 vjecare, nuk ka pasur dashje direkte e as dijeni për kryerjen e veprës penale. Andaj, i propozon gjykatës të njëjtën t'a liroi nga akuza.

**I akuzuari DF** në fjalën përfundimtare deklaron se e mbështet fjalën përfundimtare të mbrojtësit të tij dhe nuk ka çfarë të shtojë më tepër.

**4.12. Mbrojtësi i të akuzuarit Xh.Sav.M N., në fjalën përfundimtare** të prezantuar në formë të shkruar dhe të elaboruar shkurtimisht deklaron se, nuk qëndrojnë pretendimet e përshkruara si në aktakuzë për gjendjen faktike e as për cilësimin ligjor të veprës penale e cila i vihet në barrë të mbrojturit të tij, sipas aktakuzës janë tri veprime inkriminuese që i përshkruhen të mbrojturit të tij, sa i përket veprimit që ka të bëjë me pranimin e armëve nga të akuzuarit A dhe D F në Maqedoninë Veriore, transportimin e tyre nga Maqedonia Veriore për në Kosovë dhe dorëzimi i tyre në Kosovë, për të cilat veprime nuk ka përgjime telefonike, as mesazhe të shkëmbyera midis tyre apo dëshmi të ndonjë dëshmitari, ndonjë veprim inkriminues të të mbrojturit të tij, prokuroria ka përshkruar se i akuzuari Xh.Si ka dorëzuar armët të akuzuarve A dhe D F tek restorant "Alba" në Han të Elezit, mirëpo pa precizuar mënyrën apo mjetin se si i ka bartur deri tek vendi i dorëzimit, Pra, i njëjti akuzohet vetëm për një veprim që ka të bëjë me datë 21.09.2013 kinse ka transportuar armë prej Maqedonisë Veriore për në Kosovë përmes rrugëve ilegale dhe nuk dihet çfarë është përfitimi material nëse ka realizuar qoftë për transport apo për shitje armësh, që dmth se këto rrethana të pavërtetuara mbesin vetëm supozime. Poashtu nuk ka prova se i akuzuari Xhi ka njohur të akuzuarit tjerë, apo të ketë patur çfarëdo kontakti qoftë me telefon apo takime fizike. Andaj sipas mbrojtjes poqese gjykata konsideron se i mbrojturi i tij ka ndërmarrë veprimet që i përshkruhen në aktakuzë, nga i njëjti të kërkohet përgjegjësia për veprën penale bazë nga neni 364 par.2 të KPRK, meqë nga provat materiale e personale nuk është vërtetuar se i njëjti ka kryer vepër penale siç e ngarkon akuza. Në fund mbrojtësi poashtu deklaron se i mbrojturi i tij është i moshës së re, nuk dyshohet për vepra tjera

penale, nuk ka të dëmtuar e as dëmtim material apo jomaterial dhe, kërkon nga gjykata që në aplikim të dispozitave ligjore të zbutjes së dënimit, gjatë matjes së dënimit të ketë parasysh rrethanat lehtësuese që do të jetë në përpjesëtim me pasojën dhe shkallën e përgjegjësisë së të akuzuarit Xh,S.

*I akuzuari Xh.S* në fjalën përfundimtare deklaron se e mbështet fjalën përfundimtare të mbrotjësit të tij dhe nuk ka çfarë të shtojë më tepër.

**4.13. Mbrojtësi i të akuzuarit K.S av. Qëndrim Reçica në fjalën përfundimtare** të prezantuar gjykatës në formë të shkruar dhe të elaboruar gojarisht deklaron se nuk ekzistojnë elementet e veprës penale të krimit të organizuar, poashtu ndaj të mbrojturit të tij nuk ka prova se i njëjti ka shitur armë, gjatë fazës së hetimeve i mbrojturi i tij kishte deklaruar se 2-3 herë ka blerë armë me gas për nevoja të tija personale, pasi që ka qenë i angazhuar në lokale të natës si këngëtar, mirëpo në fakt me ekspertiza shkencore ato nuk paraqesin armë zjarri, por janë vetëm imitim i armëve të vërteta, përndryshe asnjëherë nuk ka vepruar në interes të ndonjë të bashkëakuzuari e as nuk ka shitur armë dikujt, nuk ka patur kontakte me të njëjtit, ndërsa manovrimet në biseda telefonike me A Fn kanë qenë të natyrës për ulje qm të armës për vete e jo për shitje. Në fund propozon gjykatës të bëjë ricilësimin e veprës penale në vepër penale të mbajtjes në pronësi, kontroll, ose posedim të paautorizuar të tarmës siaps ennit 374 të KPRK dhe për këtë t'i shqiptojë një dënim sa më të butë duke marrë parasysh gjitha rrethanat lehtësuese të parapar në nenin 74 të KPRK. *I akuzuari K.S* në fjalën përfundimtare deklaron se e mbështet fjalën përfundimtare të mbrotjësit të tij dhe nuk ka çfarë të shtojë më tepër.

## **5. Provat materiale të paraqitura në shqyrtim gjyqësor**

**5.1. Provat materiale të ndërlidhura me aktakuzën PPS.nr.105/2013**, që përfshinë periudhën inkriminuese 01.07.2013 deri 23.11.2013 dhe, që kanë të bëjnë me të akuzuarit A F, A F, P F, P F, D F, si dhe Xh.Se K.S, janë si në vijim:

1. Raportet e Policisë për masën e fshehtë të regjistrimit të bisedave telefonike - Përgjim 049 /// 053 të cilin e kanë shfrytëzuar të akuzuarit **A, P, e P F**<sup>11</sup>,

---

<sup>11</sup> Shih folld.1 indeksi 22

- Raporti i parë nga data 10.09.2013 deri më 24.09.2013 që përfshinë kryesisht bisedat telefonike me rëndësi për shitblerje dhe furnizim të armëve dhe municionit midis të akuzuarit A dhe vëllezërve të tij,
  - Raporti i dytë nga data 25.09.2013 deri me datë 09.10.2013, janë kryesisht biseda telefonike të zhvilluara në lidhje me shitblerjen e armëve,
  - Raporti i tretë nga data 10.10.2013 deri me datë 24.10.2013, janë kryesisht biseda telefonike të zhvilluara në lidhje me shitblerjen e armëve,
2. Raportet e vëzhgimit të nxjerra në bazë të urdhëresës për monitorim të fshehtë dhe vëzhgim të datës 23.11.2013<sup>12</sup>,
3. Raporti për ekzaminimin e armëve me nr. AFK/2014/1234-996, i datës 04.04.2014<sup>13</sup>,
4. Raporti i vendit të ngjarjes dhe Fotoalbumi dhe proqesverbali i sekuestrimit i datës 21.09.2013,
- Raporti i Drejtorisë së Teknikës Kriminalistike me nr. 2013-DKKO-021 i datës 21.09.2013<sup>14</sup>, në veturë të t'akuzuarit A F,
  - Fotoalbumi i vendit të ngjarjes i Njësisë së Forenzikës së Drejtorisë së Teknikës Kriminalistike, me nr. 2013 –DKKO-021, i datës 21.09.2013,
  - Bastisja e datës 21.09.2013 e veturës së të akuzuarit A F,
5. Vërtetimi mbi konfiskimin e gjësendeve me nr. 2013 DKKO-021 nga vetura e të akuzuarit A F e datës 21.09.2013,
6. Raporti i bastisjes së shtëpive të familjes F në K e T. në P, rruga “Kadri Zeka” nr.8, i datës **23.11.2013**,

---

<sup>12</sup> Shih folld.1 indeksi 7

<sup>13</sup> Shih folld.1 indeksi 10

<sup>14</sup> Shih folld.1 indeksi 9

➤ Raporti i Bastisjes i Drejtorisë së Teknikës Kriminalistike me nr. 2013-DKKO-021 i datës 23.11.2013<sup>15</sup>,

➤ Fotoalbumi i vendit të ngjarjes i Njësisë Forenzike të Drejtorisë së Teknikës Kriminalistike me nr. 2013-DKKO-021, i datës 23.11.2013,

7. Procesverbali mbi kontrollin e personit dhe banesës e të nënshkruar nga i akuzuari G F i datës 23.11.2013<sup>16</sup>

8. Raport kontrolli-bastisje, bastisje, procesverbal kontrolli i datës 23.11.2013 për të akuzuarin P F<sup>17</sup>,

➤ Raport mbi kontrollin e shtëpisë së të akuzuarit P F, i datës 23.11.2013(që mban datën 24.11.2013)

➤ Proesverbali mbi kontrollin e personit dhe banesësë prë të akuzuarin P F, i datës 22.11.2013,

➤ Proqesverbali bastisjes dhe gjetja e katër Radiolidhjeve

**9. Raporte Përgjimi për numrin tel. 049 /// të t'akuzuarit A F**

➤ Raporti i parë për periudhën 25.07.2013- 08.08.2013,

➤ Raporti i dytë për periudhën 09.08.2013- 23.08.2013,

➤ Raporti i tretë për periudhën 24.08.2013- 07.09.2013,

**10. Raporte Përgjimi për numrin tel. /// të t'akuzuarit A F,**

➤ Raporti i parë për periudhën 01.07.2013- 15.07.2013,

➤ Raporti i dytë për periudhën 16.07.2013- 30.07.2013,

➤ Raporti i tretë për periudhën 31.07.2013- 14.08.2013,

**11. Raporte Pergjimi për IMEI 352/// telefoni i të akuzuarit A F,**

---

<sup>15</sup> Shih folld1 indeksi 9

<sup>16</sup> Shih foll.1 indeksi 4

<sup>17</sup> Shih folld.4

- Raporti i katërt për periudhën 08.09.2013- 22.09.2013,
12. Raporte Përgjimi për numrin tel.**044** ///, shfrytëzus **D F**,
- Raporti i dytë për periudhë 25.09.2013- 09.10.2013,
13. Raporte përgjimi për numrin e telefonit **049** ///, shfrytëzues **A F**,
- Raporti i parë për periudhën 24.09.2013- 08.10.2013,
  - Raporti i dytë për periudhën 16.07.2013- 30.07.2013,
  - Raporti i dytë për periudhën 09.10.2013- 23.10.2013,

**5.2. Provat e prezantuara materiale të ndërlidhura me aktakuzën PPS.nr.42/2019,** që përfshinë periudhën inkriminuese nga fillimi i vitit 2018 deri më 24.07.2019 dhe që kanë të bëjnë me të akuzuarit A,A dhe P F, si dhe të akuzuarit A S dhe M.sh, janë si në vijim:

1. Raporti i Ekspertimit nga Agjencia e Kosovës për Forenzik mbi ekzaminimin e armëve dhe municionit dhe veglave tjera të gjetura tek të akuzuarit me numër referues AKF/2019-2196/2019-1943 i datës 12.11.2019<sup>18</sup>,
2. Raporti i Ekspertizës nga Drejtoria e Teknikes Kriminalistike nga Sektori për Fotografi, Video Analizë dhe ekzaminime të TI-së, Njësia për ekzaminimin e pajisjeve të teknologjisë së informacionit i datës 31.10.2019 dhe Raporti mbi analizimin e materialit nga ekzaminimi i telefonave nga Policia e Kosovës me nr. të referencës 2018 – DHKO/1169 i datës 22.11.2019<sup>19</sup>,
3. Raporti i këqyrjes së vendit të ngjarjes, Lista e dëshmive si dhe Foto Albumi 2019-DTK-027 VN2 që mban datën 24.07.2019 lidhur me armët dhe municioni të gjetura në punëtorinë e të akuzuarit A F,

---

<sup>18</sup> Shih foll.7 indeksi B

<sup>19</sup> Shih foll.5 indeksi 21

4. Raporti i këqyrjes se vendit te ngjarjes, Lista e dëshmimeve si dhe Foto Albumi 2019-DTK-027 VNI qe mban datën 24.07.2019 lidhur me armët dhe municionin te gjetura ne shtëpinë e të akuzuarit A F,<sup>20</sup>
5. Raporti i këqyrjes së vendit të ngjarjes 2019 EK 070 që mban datën 31.05.2019 bashkë me dëshmitë e gjetura në veturën Golf 5 me targë regjistrimi , ngjyrë hiri, pronë e të akuzuarit A S, lista e dëshmimeve si dhe foto albumi<sup>21</sup>.
6. Vërtetim mbi sekuestrimin e sendeve (telefonave) nga A S me datë 31.05.2019<sup>22</sup>,
7. Raportet e dorëzuara Raportet 15 ditore mbi zbatimin e Masave te Fshehta teknike te hetimit dhe vëzhgimit te dorëzuara ne prokurori dhe gjykatë nga Policia e Kosovës DHKO, sipas urdhëresave të gjyqtarit te procedurës paraprake ne Gjykatën Themelore në F (*fotografim të fshehte ose vëzhgim me video ne vendet publike; monitorim te fshehte të bisedave në vendet publike; përgjim të telekomunikimeve përfshirë tekstet e mesazheve ose mesazhet tjera elektronike*), për të akuzuarin A S.
  - Raporti i parë i përgjimit ligjor të telekomunikimeve për të akuzuarin A S për numrin tel 045 /// për peridhën 28.02.2019 -14.03.2019<sup>23</sup>,
  - Raporti i parë i përgjimit përfshinë periudhën kohore 28.02.2019-14.03.2019 për të akuzuarin A S<sup>24</sup>
8. Raport nga BMS për A S<sup>25</sup>,
9. Raporti i Vëzhgimit –GPS për datën 30.04.2019, vetura e A Sopes në shtëpinë e A Ft<sup>26</sup>,
10. Raporti i përgjimit të telekomunikimeve për periudhën 28.02.2019 – 28.04.2019 për të akuzuarin A S <sup>27</sup>

---

<sup>20</sup> Shih foll.5 indeksi 22

<sup>21</sup> Shih foll.1 indeksi 17

<sup>22</sup> Shih folld.1 indeksi 17

<sup>23</sup> Shih foll 1 indeksi 6

<sup>24</sup> Shih foll.1 indeksi 7

<sup>25</sup> Shih folld.1 indeksi 7

<sup>26</sup> Shih folld.1 indeksi 24+CD

<sup>27</sup> Shih foll.1 indeksi 26

11. Raport i përgjimit te telekomunikimeve për periudhën 03.05.2019-31.05.2019 për të akuzuarin A S<sup>28</sup>,
12. Raport (vëzhgimi i fshehtë fotografik ose me video në vende publike” për periudhën kohore 03.05.2019-31.05.2019, për të akuzuarin A S<sup>29</sup>,
13. Raporti i përgjimit ligjor të telekomunikimeve për numrin 045///// (për të dyshuarin Adil Bruti) për periudhën kohore 14.05.2018-28.05.2018<sup>30</sup>
14. Raporti informues mbi masat e fshehta Shfrytëzim i mjeteve për përcjelljen e vendndodhjes-GPS kundër të pandehurit A S me veturën Golf V, ngjyrë hiri, me targa //-KS-///<sup>31</sup>,
15. Raport për hyrje-dalje dhe hartografi nga numri 044////-/// të cilin e përdor i dyshuari M.sh<sup>32</sup>,
16. Raport i vëzhgimit për A Fn<sup>33</sup>,
17. Raporti informues mbi masat e fshehta, shfrytëzimi i mjeteve për përcjelljen e vendndodhjes-GPS me zë lidhur me të akuzuarin A F në veturën Golf V<sup>34</sup>,
18. Raporti informues mbi masat e fshehta, shfrytëzimi i mjeteve për përcjelljen e vendndodhjes-GPS, lidhur me të pandehurin A F me veturën Golf VI ngjyrë e kaltër me targë regjistrim 01-///-MM<sup>35</sup>,
19. Raport i përgjimit ndaj numrit **049/////** të cilin e përdor i akuzuari P F për periudhën kohore 20.02.2019-21.04.2019<sup>36</sup>,
20. Raport për masa të fshehta-fotografim i fshehtë ose vëzhgim me video në vendet publike ndaj të akuzuarve M.sh, P F dhe A F, për periudhën kohore 08.02.2019-10.04.2019<sup>37</sup>.
21. Raport për masa të fshehta GPS, lidhur me të akuzuarin A F<sup>38</sup>,

---

<sup>28</sup> Shih foll.1 indeksi 26

<sup>29</sup> Shih folld.1 indeksi 27

<sup>30</sup> Shih folld.1 indeksi 29

<sup>31</sup> Shih folld.1 indeksi 37

<sup>32</sup> Shih folld.2 indeksi 19

<sup>33</sup> Shih folld.2 indeksi 20

<sup>34</sup> Shih folld.3 indeksi 2

<sup>35</sup> Shih folld.3 indeksi 3

<sup>36</sup> Shih folld.3 indeksi 10

<sup>37</sup> Shif folld.3 indeksi 24

<sup>38</sup> Shih folld.3 indeksi 54

22. Raport për hyrje-dalje dhe hartografi për të akuzuarin A F<sup>39</sup>,
23. Raport për masa të fshehta teknike të vëzhgimit ndaj të akuzuarve M.sh, P, P, dhe A F, për periudhën kohore 10.12.2018 - 08.01.2019<sup>40</sup>,
24. Raport i përgjimit ndaj numrit 045//// të cilin e përdor A F, për periudhën kohore 18.12.2018 -16.01.2019<sup>41</sup>,
25. Raportet dhe procesverbalet mbi kontrollin e banesës dhe personave tek të akuzuarit:
  - M.sh me datë 24.07.2019<sup>42</sup>
  - A F me datë 24.07.2019<sup>43</sup>
  - A F me datë 24.07.2019<sup>44</sup>

**5.3** *Ndërsa Dëshmitë shitesë* të prezantuara nga prokurorja për të akuzuarit e përfshirë në pikën II, janë si në vijim:

1. Dëshmitë lidhur më të akuzuarin **P F**,
  - Raportet e Policisë për masën e fshehtë të regjistrimit të bisedave telefonike, tregojnë se i akuzuari P F nga numri i tij i telefonit **044 ///** dhe nga numra tjerë, ka zhvilluar komunikime me të akuzuarit.
  
2. Dëshmitë lidhur më të akuzuarin **P F**,
  - Raportet e Policisë për masën e fshehtë të regjistrimit të bisedave telefonike, tregojnë se i akuzuari P F nga numri i tij i telefonit **049 //-053**, ka zhvilluar komunikime me të akuzuarit.
  
3. Dëshmitë lidhur më të akuzuarin **A F**,
  - Raportet e Policisë për masën e fshehtë të regjistrimit të bisedave telefonike,

---

<sup>39</sup> Shih folld 3 indeksi 57

<sup>40</sup> Shih folld.3 indeksi 70

<sup>41</sup> Shih folld.3 indeksi 80

<sup>42</sup> Shih folld.4 indeksi 6

<sup>43</sup> Shih folld.4 indeksi 11

<sup>44</sup> Shih folld.4 indeksi 11



tregojnë se i akuzuari A F nga numrat e tij tel. **049 ////, 049 ////**, ka zhvilluar komunikime me të akuzuarit.

4. Dëshmitë lidhur më të akuzuarin **G F**,

➤ Raportet e Policisë për masën e fshehtë të regjistrimit të bisedave telefonike, tregojnë se i akuzuari G F nga telefoni i tij, ka zhvilluar komunikime me të akuzuarit.

5. Dëshmitë lidhur me të akuzuarin **K.S**,

➤ Raportet e Policisë për masën e fshehtë të regjistrimit të bisedave telefonike, tregojnë se i akuzuari K.S nga numri i tij i telefonit ///, ka zhvilluar komunikime me të akuzuarit.

6. Dëshmitë lidhur më të akuzuarin **Xh,S**,

➤ Raportet e Policisë për masën e fshehtë të regjistrimit të bisedave telefonike, tregojnë se i akuzuari Xh.S nga numri i tij i telefonit ///, ka zhvilluar komunikime me të akuzuarit.

**6. Vlerësimi i përgjithshëm i provave**

6.1. Pasi që gjykata bëri administrimin e provave të paraqitura në shqyrtim gjyqësor, të njëjtat i analizoi dhe vlerësoi me kujdes e me ndërgjegje, secilën veç e veç dhe në ndërlidhje reciproke me njëra tjetrën në kuptim të dispozitës së nenit 361 të KPP, vërtetoi gjendjen faktike të precizuar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, ashtu që bëri ricilësimin e veprës penale nga ajo sipas aktakuzës Pjesëmarrja dhe organizimi i grupit kriminal të organizuar nga neni 277 par.1 të KPRK-së lidhur me veprën penale Importi, eksporti, furnizimi, transportimi, prodhimi, këmbimi, ndërmjetësimi ose shitje e paautorizuar e armëve apo materieve plasëse nga neni 364 par.2 të KPRK, në veprën penale në bashkëkryerje dhe vazhdimësi **Importi**, eksporti, furnizimi, transportimi, prodhimi, këmbimi, ndërmjetësimi ose shitje e paautorizuar e armëve apo materieve plasëse nga neni 364 par.2 lidhur me nenin 31 dhe 77 të KPRK të cilën u vërtetua se e kanë kryer të akuzuarit e përcaktuar, në formë

të bashkëkryerjes, në vazhdimësi gjatë periudhave të përcaktuara si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**Faktet e pakontestuara** - Nga provat e administruara të lartshënuara, gjykata vërtetoi disa fakte si fare të pakontestuara, fillimisht sa i përket sasisë dhe llojit të armëve e municionit të gjetura dhe të sekuestruara në vendet e ngjarjes në vitin 2013 (në veturë Golf 2 të t'akuzaurit A F dhe në pronën të familjes F në P) apo në vitin 2019 (në veturë të t'akuzaurit A S dhe në pronë të familjes F). Këto fakte as që ishin kontestuar meqë ishin të dokumentuara me raporte përkatëse e proqesverbale të përpiluara nga zyrtarët policor nga vendi i ngjarjes pa vërejtje, me vërtetime për marrjen e sendeve dhe të dokumentuara me fotografi. Ndërsa sa i përket funksionalitetit të të njëjtave ekziston prova shkencore e përshkruar për secilën armë apo municion pas ekzaminimit në Laboratorin e AKF dhe, këto prova konsiderohen si prova materiale të ligjshme, të cilave si të tilla gjykata ia fali besimin e plotë.

Rrjedhimisht nuk mbeti kontestues as kryerja e veprës penale Importi, eksporti, furnizimi, transportimi, prodhimi, këmbimi, ndërmjetësimi ose shitje e paautorizuar e armëve apo materieve plasëse nga neni 364 par.2 të KPRK nga i akuzuari A F meqenëse i njëjti pohon se është marrë me shitblerje të armëve për çka shpreh pendim, përkatësisht i njëjti pranoi veprimet e tija inkriminuese meqë edhe në vitin 2013 edhe në vitin 2019 i janë zënë armë e municione, qoftë në veturë qoftë në pronë të tij dhe vëllezërve të tij, por mohon përfshirjen e vëllezërve në këtë aktivitet. Rrjedhimisht gjykata nuk ka patur pranim fajësie nga i akuzuari A F në tërësi për pikat e akuzës, andaj nuk ka mundur t'a aprovojë si pranim fajësie, por, gjithsesi ky fakt mbetet të merret parasysh si rrethanë lehtësuese për matjen e dënimit.

Poashtu nuk mbeti kontestues as përshirja e të akuzuarit A S në kryerjen e veprës penale si në dispozitiv të aktgjykimit, i njëjti është kapur në hyrje të qytetit të Fit duke transportuar armë me datë 31.05.2018, përkatësisht në veturë të tij të tipit "Golf 5" me targë regjistrimi ///dhe të njëjtat i janë sekuestruar.

Përveç provave relevante që vërtetojnë faktet e larshënuara e që janë të mjaftueshme për gjykatën për të konstatuar fajsinë e të akuzuarve A F dhe A S, ekzistojnë edhe prova të tjera të cilat vërtetojnë faktin se të njëjtit kanë kryer veprën penale secili në periudha të

caktuara, në mënyrë dhe formë siç është përshkruar në këtë aktgjykim, në bashkëkryerje dhe në vazhdimësi me të akuzuarit të tjerë.

Meqenëse sipas aktakuzës së precizuar në dy dispozitiv të prezantuar në fjalën përfundimtare nga prokurorja e shtetit për gjykatën dhe palët e akuzuara, cilësimi ligjor është një, dhe atë, vepra penale Pjesëmarrja dhe organizimi i grupit kriminal të organizuar nga neni 277 par.1 të KPRK-së lidhur me veprën penale Importi, eksporti, furnizimi, transportimi, prodhimi, këmbimi, ndërmjetësimi ose shitje e paautorizuar e armëve apo materieve plasëse nga neni 364 par.2 të KPRK, gjykata, gjatë nxjerrjes së vendimit meritore ka bërë ricalësim të veprës penale nga ajo e krimit të organizuar në vepër penale bashkëkryerje dhe vazhdimësi Importi, eksporti, furnizimi, transportimi, prodhimi, këmbimi, ndërmjetësimi ose shitje e paautorizuar e armëve apo materieve plasëse nga neni 364 par.2 lidhur me nenin 31 dhe 77 të KPRK, pra cilësimi i veprës penale bazë mbetet i njëjtë.

Në këtë kontest vlenë të theksohet se, ndonëse veprimet e të akuzuarve të përshkruara në pikën I të dispozitivit të aktgjykimit kanë të bëjnë me periudhën kohore gjatë vitit 2013 dhe në atë kohë ka qenë në fuqi KPRK 04/L-082 dhe vepra penale me të cilën ngarkoheshin të akuzuarit ishte neni 372 par.2 të KPRK, mirëpo duke patur parasysh se bëhet fjalë për vepër të njëjtë penale me përshkrim të paragrafëve dhe dënueshmëri bukalisht të njëjta sikur në nenin 364 par.2 të KPRK 06/L-074 të vitit 2019, që nënkupton se në asnjë mënyrë nuk dëmtohet interesi i të akuzuarve, gjykata për shkak të uniformitetit të aplikimit të ligjit material gjatë ricalësimit të veprës penale nga krimi i organizuar në vepër penale bazë, ka aplikuar saktësisht veprën penale bazë, të cilës iu ka referuar edhe prokuroria në aktakuzën e precizuar, pra nenin 364 par.2 të KPRK 06/L-074 të vitit 2019.

Gjykata bazuar në provat e ndërlidhura me njëra tjetrën, vërtetoi formën e bashkëpunimit të t'akuzuarve në kryerjen e veprës penale, siç përshkruhet në dispozitiv të këtij aktgjykimi, e që është bashkëkryerja (*siç do të elaborohet më poshtë*). Ndërsa nuk vërtetoi ekzistimin e veprës penale të Krimit të organizuar për arsyet e saktësuara (*siç do të elaborohen më poshtë*)

**Faktet e kontestuara** - Përveç formës së bashkëpunimit të t'akuzuarve në kryerjen e veprës penale, për gjykatën mbetet të shqyrtohen, vlerësohen dhe vërtetohen edhe faktet tjera kontestuese të cilat u potencuan gjatë shqyrtimit gjyqësor qoftë edhe nga mbrojtësit e të

akuzuarve, si në vijim: nëse në veprimtarinë kriminale për import, furnizim, transportim apo shitblerje të armëve dhe municionit kanë qenë të përfshirë edhe vëllezërit e të akuzuarit A F, apo edhe të akuzuarit tjerë sipas aktakuzës.

Në vazhdim të aktgjykimit, gjykata jep vlerësime të qarta lidhur me arsyet për çfarë i konsideron faktet e lartshënuara të vërtetuara dhe me cilat prova vërtetohen veprimet inkriminuese të secilit të akuzuar, apo cilat janë faktet e mbetura të pavërtetuara, si dhe jep shpjegime për arsyet në të cilat është bazuar me rastin e vërtetimit të ekzistimit të veprës penale të t'akuzuarve të cilët janë shpallur fajtor.

## **6.2. Vlerësimi i Dëshmime**

- ***Nga dëshmia e dëshmitares D F*** e cila ishte dëshmitare e vetme e propozuar lidhur me periudhën inkriminuese të vitit 2013 dhe e cila është motra e të akuzuarve F, gjykata ka vërtetuar pak fakte meqë e njëjta mundohet qartazi të zvogëlojë përgjegjësin e vëllezërve të saj, dhe kjo rrjedhë natyrshëm dhe dukshëm duke u përgjigjur se nuk i kujtohet çfarë është gjetur në shtëpinë e tyre me rastin e bastisjes, se çfarë ka biseduar në telefon me vëllezërit etj. Nga e njëjta vërtetohet se në pronën e tyre kanë patur tri shtëpia, në to kanë jetuar së bashku gjithë vëllezërit dhe të hyrat familjare i kanë patur nga autoservisi për kerre dhe nga rroga e saj meqë ajo punon, se Ai ka nofkën “F” dhe ka punuar me kerre si mjeshtër kryesor në punëtorinë nën shtëpi ku edhe ka jetuar, se Ai, Pi dhe Pi i kanë ndihmuar, ndërsa për vëllaun Gin siç thotë asnjëherë nuk është marrë me këtë aktivitet, poashtu edhe faktin se vëllaun Ai ka shkuar në Shkup me djalin e axhës Din dhe se gjatë kthimit Ait me veturë “Golf 2” i janë zënë armët.

- ***Nga dëshmia e dëshmitarit S.A*** gjykata vërtetoi se i njëjti i njeh mirë të akuzuarit M F dhe M.sh që prej dhjetë vitesh, se bashkë me veturë të Mt kishin shkuar saktë dhe drejt në kafenenë e të akuzuarit Mim në F me qëllim për t'ia shitur një armë, dhe atë në mënyrë që ai vet të përfitojë 20 euro siç i kishte premtuar i akuzuari M poqese ia shet armën. Poashtu është vërtetuar fakti se i akuzuari Mim nuk ka dashtë me e ble, sepse siç i ka thënë “*është duke pritur disa armë me gas*”.

Gjykata vlerëson se nëse dëshmitari S do të dëshironte të shes armën e të akuzuarit M për të përfituar nga ky ndërmjetësim, atëherë i njëjti nuk ka patur nevojë të shkojë drejtë e në

kafenën e të akuzuarit Mim sikur ky i fundit të mos kishte të bëjë asgjë me armët, sigurisht se kjo nuk ka ndodhë rastësisht, pastaj i akuzuari Mim nuk ka patur nevojë t'i thotë se është duke i prit disa armë me gas nëse i njëjti nuk ka lidhje me armë. Kjo provë është në përputhje edhe me prova të tjera që dëshmojnë se vërtetë i akuzuari Mim ishte duke i pritur armët me gas, për të cilat kishte biseduar me telefon me të akuzuarin A nga i cili telefon kishte biseduar edhe me të pandehurin K.i.

- **Nga mbrojtja e të akuzuarit A F**, përkatësisht gjykata ka vërtetuar se, meqë i njëjti mbetet pranë deklaramit të tij sa i përket veprës penale për periudhën 2013, gjatë të cilit deklaram ka pranuar të gjitha faktet e përshkruara në dispozitiv, nga shkuarja në Shkup siç thotë me kushëririn D F me veturë "Golf 5", e deri në momentin e ndaljes së veturës "Golf 2" të cilën e drejtonte vet gjatë kthimit në Prishtinë, me ç'rast edhe iu ka ikur policëve nga vendi i ndalimit në fshatin Llugaxhi Komuna Lipjan, ndërsa në veturë iu kanë gjetur armë e municion. Nga kjo deklaratë njëherësh gjykata ka vërtetuar dashjen dhe dijenin edhe të t'akuzuarve D, P dhe P F për kryerjen e veprës penale, andaj vlerësohet se pjesës së deklaramit të t'akuzuarit A kur i njëjti mundohet të përjashtojë pjesmarrjen e vëllezërve në kryerje të veprës penale si dhe të t'akuzuarit D, gjykata nuk ia fali besimin, për faktin se i akuzuari A nuk ka asnjë arsytim përse i ka thirrë vëllezërit P dhe P për të shkuar në kufi dhe për t'ia dërguar veturën "Golf 2". Ndërsa faktin se Di nuk e ka dëgjuar bisedën që e ka zhvilluar i akuzuari A me personin me emrin Haxhi Beci në Shkup për transportin e fishekëve, gjykata e kosideroi të kotë, meqë ata kanë qenë bashkë, kanë shkuar dhe janë kthyer deri këndeje kufirit bashkë, janë kordinuar bashkë edhe me të akuzuarin Xhe M B për vendosjen e armëve në veturë, këtë fakt edhe i akuzuari Xhe kshihte pranuar dhe, janë marrë vesh që Di të kthehet me dy vëllezërit Pin dhe Pin të cilët në mbrëmje në ora 21:35 i ka thirrë Ai në telefon dhe të cilët kishin shkuar me veturë "Golf 2", ishin takuar të gjithë në parkingun e restorantit "Alba" në Han të Elezitet, dhe ishin kthyer për në P, kurse vet Ai ka qëndruar derisa e ka mbushur veturën "Golf 2" me armë e fishekë dhe pas vëllezërve është nisur për në P duke e drejtuar veturën, gjatë rrugës rreth mesante është ndaluar nga policia por ai vet ka ikur nga vendi i ngjarjes. Deklaramit të t'akuzuarit A se vet është marrë me armët e jo edhe vëllezërit e tij, gjykata nuk ia fali besimin ngase shihet qartazi tendenca e të njëjtit për të lehtësuar pozitën e vëllezërve të tij meqë akuzat i rëndonte për krim të organizuar, prandaj përveç vëllezërve poashtu mohonte edhe njohjen me të bashkë akuzuarit tjerë, qofshin si shitës apo blerës të armëve, ndërsa bisedat për këto qëllime ishin të shumta. Mirëpo përfshirja e tij si i vetëm në këtë veprimtari jo që ishte e pamundur por

ishite edhe abstrakte, për më tepër ky fakt vërtetohet edhe me prova të shumta materiale të nxjerra nga urdhëresat e ligjshme të gjykatës, përfshirë transkriptet e bisedave telefonike që kishte zhvilluar i njëjti me vëllezërit dhe me personat e ndryshëm anembanë Kosovës për furnizim me armë e municion, inqizimet me zë të bisedave në veturë të tij, lëvizjet e veturave të tij dhe vëllezërve të tij, vëzhgimet me fotografi, përcjelljet nga hetuesit policor deri tek gjetjet e armëve në veturë të tij dhe në pronën familjare të tij në P.Fjalët e përdorura nga i akuzuari A por edhe nga vëllezërit e tij për armë dhe municion, për lloje, kalibra, sasi e çmime, para kapjes së veturës së tij “Golf 2” me armë, ishin të shumta dhe shumë direkte, mirëpo pas kësaj date i akuzuari A për shkak të frikës se do ta kapin policia nuk kthehet në shtëpi një kohë, i njëjti me vëllezër vazhdon veprimtarinë e furnizimit e shitblerjes së armëve por bisedat i kufizojnë dhe mundohen të flasin me kode duke iu shmangur përdorimit të fjalëve për dhe lidhur me armët. Se i akuzuari A vazhdon veprimtarinë për furnizim me armë edhe pas kapjes së armatimit në veturën “Golf 2” dhe atë bashkë me vëllezërit e tij, vërtetohet edhe me faktin se, pas komunikimeve telefonike i akuzuari A realizon furnizimin me armë e municion dhe ditën e bastisjes në pronën të familjes së tij me 23.11.2011 të akuzuarit Sh e FH me veturë “Xhip Suzuki” i sjellin armë e fishekë hyjnë në oborr dhe, priten nga vëllezërit e Ait dhe të gjithë pas ndërhyrjes së policisë kapen, derisa vet i akuzuari A nuk ndodhej në shtëpi.

Ndërsa vazhdimin e veprimtarisë së furnizimit me armë dhe shitblerjes së armëve edhe në periudhën e vitit 2018 -2019 (deri në kapje) gjykata e vërtetoi me prova të shumta relevante, poashtu edhe me prova që kanë të bëjnë me modifikimin e armëve nga ato me gas në armë të vërteta, pa përjashtuar edhe armë të tjera të zjarrit apo të gjuetisë të siguruara për shitje me qëllime përfitimi.

I akuzuari A dhe gjithë të tjerët kanë qenë mjaftueshëm të arsimuar se janë duke vepruar në mënyrë të kundërligjshme, por të njëjtit për qëllime përfitimi me dashje kanë ndërmarr veprime konkrete sa herë që ka patur nevojë të furnizohen me armë e municion, kanë blerë, kanë modifikuar, kanë transportuar në destinacione të caktuara me qëllim që t’i shesin.

- ***Nga mbrojtja të akuzuarve P, P, A dhe D F***, ndonëse të njëjtit në shqyrtim gjyqësor janë mbrojtur në heshtje, mirëpo gjatë fazës së hetimeve ishin deklaruar, andaj bazuar në të njëjtat e posaqërisht dhe kryesisht bazuar në prova materiale, gjykata ka kuptuar dhe ka vërtetuar përfshirjen e të njëjtëve në veprimtarinë kriminale qoftë të furnizimit, transportimit apo shitblerjes së armëve nga Maqedonia deri tek blerësit e ndryshëm në Kosovë, poashtu edhe në modifikimin e armëve nga armë me gas në armë të vërteta. Të

akuzuarit P dhe P kishin pohuar se vëllau Ai me datë 21.09.2013 kishte shkuar në Shkup me Din me veturën “Golf 5” dhe kur ishin kthyer në mbrëmje, në Han të Elezit i kishte thirrë të njëjtit që t’ia dërgojnë veturën “Golf 2”, të dy kishin ditur qëllimin dhe kishin shkuar, ishin takuar dhe aty i kishin ndërruar veturat, bashkë edhe me Din ishin nisur për në P me veturën “Golf 5” kishin monitoruar rrugën ndërsa pas tyre pas pak ishte nisur Ai me veturën “Golf 2”. Fakti se e kanë monitoruar rrugën konstatohet nga komunikimi telefonik midis të akuzuarit A dhe vëllaut të tij M po atë natë pas arratisë së Ait, kur ky i fundit i thotë se Pi i kishte thënë se rrugën e ka të lirë. Faktin se i akuzuari A ishte mjeshtri kryesor në punëtorinë e tij nën shtëpi të vet, gjykata e gjeti të pa kontestuar nga askush dhe nga kjo nuk ka asgjë të keqe, mirëpo faktin se i njëjti nuk ishte në dijeni për vegla e pajisje të ndryshme për modifikimin e armëve të gjetura në punëtorinë e tij, gjykata nuk e besoi aspak dhe nuk e arsyetoi aspak, i akuzuari A e dinte se ato ekzistonin në punëtori, e që është më e rëndësishme ato nuk kishin të bënin asgjë me rregullimin e veturave, siç konstatohet edhe nga ekspertiza laboratorike ato ishin pajisje për modifikim të armëve, të cilat ishin gjetur të përdorura, disa edhe të thyera. Faktin se të akuzuarit A në punëtori i kanë ndihmuar edhe vëllezërit Pi, Pi e Ai e dëshmon edhe motra e tyre.

- ***Nga mbrojtja të akuzuarve K.S e Xh.*** Stë cilët poashtu janë mbrojtur në heshtje gjatë shqyrtimit gjyqësor, mirëpo gjatë fazës së hetimeve ishin deklaruar, andaj duke u bazuar në të njëjtat e posaqërisht në prova materiale gjykata ka kuptuar gjithashtu përfshirjen e të njëjtëve në veprimtarinë kriminale të transportimit apo shitblerjes së armëve. I akuzuari K.S pothuajse i kishte pranuar disa blerje të armëve nga i akuzuari A dhe kjo nuk ishte kontestuese përkundër faktit se i njëjti mendohej të arsyetohej se i blente për vete, se njëra i kishte humbur etj, kurse i akuzuari Xh. Skishte pranuar se kufirin Maqedoni-Kosovë e kishte kaluar edhe me kali, ndërsa për sa për t’u arsyetuar thotë se ka bartur drunjë meqë zabelin e kishte në kufi në pjesën e Maqedonisë, poashtu kishte pohuar se, derisa ecte nëpër mal i pandehuri M me datë 21.09.2013 në ora 17:27:09 në telefon i kishte thënë me ndërru drejtimin, por i akuzuari nuk jep asnjë arsyetim pse me ndërru drejtimin, pastaj pohon se të pandehurit M B ia kishte dhënë 400 euro për blerjen e një arme dhe ky i kishte premtuar që kur të vijnë “ata të Ps “ do t’ia sjellin armën, poashtu ka pranuar se M B i kishte kërkuar atij t’ia dërgojë veturën “Golf 2” deri te “Alba”oil, në fund kishte shprehur pendimin për kryerjen e veprës penale, e që nënkupton se i njëjti ka qenë fare mirë në dijeni për gjithë aktivitetin kriminal rreth armëve. Faktin se i akuzuari Xhka siguruan kalimin ilegal të armëve nga Maqedonia në Kosovë, gjykata e bazoi në transkriptin e bisedave të të njëjtit

me të pandehurin M B , ndërsa mënyrën e vendosjes së armëve në veturën “Golf 2” të t’akuzuarit A tashmë i njëjti veç e kishte pranuar dhe kjo ka rezultuar si e saktë me vet kapjen e armëve në veturën “golf 2” të t’akuzuarit A.

Nga mbrojtja e të akuzuarit M.sh gjykata vërtetoi se i njëjti është pronar i kafenesë “K”, se kishte patur në shfrytëzim numrin e telefonit 044////-/// dhe këtë fakt e kishte pohuar edhe në polici (me dt.14.07.2019) duke thënë se të vetmin numër për 10 vitet e fundit e ka këtë numër. Ndërsa në shqyrtim gjyqësor i njëjti mundohet t’i ik përgjegjësisë duke thënë se nga viti 2019 e përdor një numër tjetër personal, që është tërësisht normale që pas intervistimit në polici të merr numër të ri, ndërsa arsyetimin se telefonin me numër 044//// e linte në kafene dhe nga ky telefon mund të ketë folë dikush tjetër, gjykata nuk e pa aspak të bazuar kjo për arsye se në mëngjesin e datës 09.04.2019 derisa ishte siç thotë “*duke fjetë*” nuk ka mund të flasë me telefonin të cilin e kishte lënë në kafene, derisa kafeneja as që ka qenë e hapur ngase fillonte punën siç e thotë vet i akuzuari nga ora 10:00, andaj kësaj pjese të deklaramit të tij me të drejtë gjykata nuk ia fali besimin. Sa i përket vendndodhjes, përkatësisht adresës së kafenesë apo shtëpisë së tij, gjykata nuk gjeti ndonjë dilemë, kafeneja ka qenë çdo herë në të njëjtin vend është quajtur “K” dhe adresa është e njëjta siç e përshkruan edhe zyrtari policor në hartë në udhëkryqin “Kemajl Hetemi...” Ndërsa faktin e potencuar nga i akuzuari se janë dy parkingje afër kafenesë dhe një auto larje, gjykata i konsideroi si arsyetime të pa vendeda, ngase është normale që vetura të parkohet në parking e pastaj udhëtarët të orientohen aty ku pretendojnë të shkojnë si në këtë rast në kafene dhe, nuk ka asgjë të gabuar nëse konstatohet se vetura është ndalur afër kafenesë së të akuzuarit Mim, sepse dëshmohet se udhëtari si dëshmitari S.A ka hyrë te i akuzuari Mim në kafene. Poashtu gjykata nuk ia fali besimin edhe pjesës së deklaratës së të akuzuarit se nuk i njeh e as nuk ka patur kontakte me të pandehurin K.i, e as të akuzuarit A S, A F e vëllezërit tjerë, apo me dëshmitarin S.A ngase ky i fundit soç thotë e njeh Mn qe 10 vite, dhe askush personin që e njeh për 10 vite nuk e gabon, pastaj me këta persona ekzistojnë transkripte të bisedva telefonike të cituara në këtë aktgjykim (me A S me datë 09.04.2019 në ora 07:52 është thirr nga numri i tel të At 045/689-982, pastaj është raporti i vëzhgimit në teren i datës 19.04.2019 dhe përcjelljes së A Ft i cili me veturën e tij “Golf 6” nga P ka shkuar në F tek lokali i M.sht, pastaj biseda e drejtpërdrejtë e të akuzuarit Mim me dëshmitarin S.A, i mbështetur në transkriptin e bisedës telefonike midis të akuzuarit M F dhe dëshmitarit S.A për të shkuar te lokali i Mt, etj



Sa i përket të akuzuarve I.R dhe R.M gjykata të njëjtit nuk i liroi për faktin se nuk gjeti prova, mirëpo për faktin se provat në bazë të të cilave të njëjtit akuzoheshin sipas aktvendimit të formës së prerë të kësaj gjykate PS.nr.5/2020 të datës 05.10.20120 gjatë fazës së vendosjes për kundërshtimet e të akuzuarve ndaj aktakuzës, provat e theksuara në aktakuzë të siguruara me aplikim të masave të fshehta teknike të vëzhgimit dhe hetimit nga data **14.01.2019 deri më 25.07.2019** në raport me këta të akuzuar shpallen prova të papranueshme<sup>45</sup>, ndërsa prova të tjera të pranueshme mbi bazën e të cilave gjykata do mund të bazonte aktgjykimin nuk ka gjetur, andaj në mungesë të provave të njëjtit janë liruar nga akuza.

Sa i përket të akuzuarit **G F**, gjykata nuk gjeti se në veprimet e tija ekziston ndonjë element inkriminues i veprës penale që i vihet në barrë sipas pikës I.1 të akuzës, ndërsa sa i përket pikës I.2 prokurorja ka heqë dorë nga kjo pikë ngase nuk ka gjetur asnjë veprim të ndërmarrë nga i njëjti në kryerje të veprës penale, mirëpo gjykata të njëjtin e liroi në tërësi nga akuza.

Sa i përket veprës penale nga pika I.1 e akuzës në vitin 2013 që ka të bëjë me G Fn, konstatohen tri komunikime telefonike, biseda e parë kur i akuzuari A e ka thirrë vëllaun Gin, dhe i ka kërkuar për të shkuar tek një person me emrin “Z...” për t’i kërkuar para siç thotë “*me nxjerrë kerrin*”, tjetra bisedë kur i akuzuari A i thotë të akuzuarit M “*a i ke tregu Gazit ku janë senet*” si dhe një SMS kur një person i shkruan të akuzuarit M “*vëllau yt më kryejti punë ish kan me një Peugeot kurr se kisha pa atë vlla*”. Gjukata vlerëson se biseda e parë nuk ka asgjë inkriminuese, asnjë veprim i të akuzuarit G nuk e kalon pragun e besueshmërisë se i njëjti është marrë me veprimtarinë kriminale të armëve, ka të bëjë vetëm me gjetjen e parave, biseda e dytë është më tepër shfajësuese që tregon se Gi nuk ka patur dijeni as ku janë armët, poashtu edhe SMS vërteton se Gi nuk është marrë me këtë veprimtari prandaj edhe dërguesi i SMS nuk e kishte parë asnjëherë, dhe këtë konstatim gjykata e ndërlihd edhe me thëniet e të akuzuarit P dhe motrës së tyre D, kur thonë se Gi asnjëherë nuk është marrë me veprimtarinë e armëve. Edhe nëse në bisedën e dytë kur Gi i ka dërguar dikujt diçka me veturë Peugeot ndoshta duket se ka të bëjë me armët, mirëpo ajo ose duhet mbetur vetëm supozim ose është aq minore saqë gjykata në të vetmin komunikim nuk mund të bazojë një aktgjykim fajësues. *Shih komunikimet*<sup>46</sup>

<sup>45</sup> Në aktvendimin PS.nr.5/2020 të datës 05.10.2020, e vërtetuar nga Gjukata e Apelit me datë 14.12.2020 jepen arsyet e hollësishme për shpalljen e provave si të papranueshme.

<sup>46</sup> Me datë 02.10.2013 ne ora 13:07:46, Ai therret Gn dhe i thotë që të shkojë te „Z///” dhe ti mer ato per me nxjerr

Duke qenë se aktakuza përfshinë veprimet inkriminuese të t'akuzuarve në dy periudha kohore të ndryshme dhe atë, në periudhën 01.07.2013 deri më 23.11.2013 si dhe në periudhën nga fillimi i vitit 2018 deri 24.07.2019, gjykata arsyeshmërinë e fakteve kontestuese, përkatësisht të provave materiale do t'a përkufizojë ndaras për periudhat e lartshënuara.

**Për periudhën 01.07.2013 deri më 23.11.2013** do të bëhet vlerësimi i provave me të cilat konstatohet nëse vëllezërit F dhe i akuzuari D djali i axhës së të akuzuarit A, si dhe të akuzuarit tjerë si Xh.Se K.S kanë qenë në dijeni dhe me dashje kanë kontribuar në kryerjen e veprës penale.

**Gjithashtu edhe për periudhën 2018 -24.07.2019** do të bëhet vlerësimi i provave me të cilat konstatohet nëse të akuzuarit A F me vëllezërit P dhe A Fn bashkë me të akuzuarit A S dhe M.sh kanë qenë në dijeni dhe me dashje kanë kontribuar në kryerjen e veprës penale

### **6.3. Vlerësimi i provave materiale që i përkasin aktakuzës PPS.nr.105/2013**

Paraprakisht vlenë të theksohet se gjatë periudhës së përgjimit nga data 10.07.2013 – 18.11.2013 i akuzuari M F për të cilin tashmë është veçuar procedura, nga numri tel 049 894-350 ka zhvilluar biseda të shumta e të rëndësishme për dhe lidhur me shitblerjen e armëve, por e rëndësishme është të përmenden komunikimet që i ka bërë me të pandehurin M B me datë **20.07.2013** me të cilin flet për “me ia qit këndeje kufirit”, për çmime për copë, për 100 kutia, flasin për vonesat për kalimin e kufirit, nga Maqedonia në Kosovë, për takimin në Elez Han etj.

Nga këto komunikime dëshmohet fakti se i pandehuri M ka qenë person i njohur me vëllezërit F dhe i njëjti ka komunikuar me të akuzuarit M dhe A F në vazhdimësi gjatë transportimit të armëve në mënyrë ilegale nga Maqedonia në Kosovë.

**Nga prova nr.1** dëshmohet se nga numri tel **049-///-053** të përgjuar të cilin numër e kanë

---

*kerrin. Me datë 19.11.2013 ne ora 11:58:12 Ai e therret Gn dhe i tregon rreth transportit të armëve dhe municionit (behet fjale për transportin e armeve te dt, 23.11.2013 kur edhe eshte bere kontrolla e shtepis se te dyshuarve), kurse G i tregon Ait, se ka bisedu me nje person tjetër, i cili i ka thene te shtunen. Me datë 02.09.2013 ne ora 18:46:30 PPM i dërgon SMS Mit ku i shkruan se vëllai yt me kryti pune ish kane me një kerr peugeote (G ka qenë me peugote), kurr se kisha pa atë, e thirra 351815 kallxom mos u bo naj sen.*

shfrytëzuar të akuzuarit **A, P dhe P F**, gjatë periudhës 10.09.2013 -24.09.2013 sipas raporti të parë, të njëjtit kanë bërë biseda të shumta lidhur me shitblerje të armëve, ashtu që:

Me datë 14.09.2013 në ora 17:42:17, Ai pranon telefonatë nga Ai i cili e udhëzon që të shkoj tek “Gipa” me ja dergu dy asi qorra (*është fjala për armë me gaz*), e po ashtu në ora 18:08:59 Ai e thërret Ain në numrin e tel. 049///// nëdrlidhet e bisedën paraprake kur Ai e dërgon Ain te Gipa me ia dhanë dy qorra (armë ), kurse Ai i thotë Ait thirre Gipen në telefon që të vjen më poshtë se ai nuk mundet me shku më nalt se janë siç shprehet “ata mutat” (policia).

Me datë 18.09.2013 në ora 13:49:00, Ai e thirrë Ain nga numri i tel. 049///// dhe i thotë që ta thirre në telefon F nga Gjilani dhe t’ia dërgojë një të zezë (bëhet fjal për armë), ku në ora 13:49:59 Ai e thirre F nga Gjilani, dhe F i thotë 1 të vogël me 3 – 4 copa dhe e lënë të takohen te Restoran Evropa.

**Me datë 21.09.2013 në ora 22:33:27** Ai zhvillon disa biseda telefonike me vëllezërit e thërret vëllaun Mn në numrin tel.049/////të cilit i thotë: *gutu largojë senet nga shtëpia sepse është zënë Ai. Pastaj në ora 22:39:48 Ai flet me vëllaun tjetër në numrin e tel: 049////-193 i cili ia konfirmon Ait se i kanë larguar prej tavanit, kah baliqt cevat në bodrume. Edhe Pi vazhdon bisedën dhe i thotë “F shpejto se Ai ka ik krejt, kerri i ka ra, ndërsa neve na i morën letërnjoftimat edhe na thanë mu lajmëru në Stacion Policor në Lipjan, kurse F i thotë mos shkoni njëherë kthelhuni në shtëpi. Në ora 22:54:27 Ai pranon thirrje nga Ai nga numri i tel. 049///// , Ai i udhëzon vëllezërit e tij që në gjithë shtëpinë ta pastrojnë terenin dhe ti largojnë armët dhe municionin që janë aty, sepse frikësohet se do të shkojnë policia në kontroll të shtëpive. Në ora 23:14:46 Ai pranon sërish thirrje prej vëllaut Mt nga numri i tel. 049/////i cili i thotë Ait që ti largojnë edhe veturat nga oborri sidomos Golf V të Ait me e dërgu sonte dikund që mos të duken shumë vetura në oborr. Në ora 23:31 nga numri i tel me 049 Ai e thërret vëllaun Mn i drejtohet me nofkën “Drazhe” duke i thënë t’i largoj të gjitha edhe atë të mirën nalt. Sërish në ora 23:36:31 Ai e thërret Ain në numrin e tel.049///// ku Ai i thotë Ait të shkojë edhe në shup edhe nalt, kurse Ai i thotë u kry. Në ora 23:41:15 Ai pranon një thirrje nga dikush me numër telefoni 049/////i cili e udhëzon Ain të pastrojë telefonin, të fshijë të gjitha numrat e telefonit me fjalën “dillite”.*

*Nga komunikimet e lartshënuara gjykata vërteton se me datë 21.09.2013 Ai zhvillon disa biseda telefonike me vëllezërit dhe të tjerët, me të cilët flasin për zënien e armëve dhe municionit në veturën “Golf 2” të Ait, rreth pastrimit të shtëpive nga armët dhe sendet tjera, si dhe zhdukjen e të gjitha dëshmive si numrat e telefonave etj. Nga këto komunikime dijenia e të akuzuarit A për veprimtarinë e armëve, për vendndodhjen dhe fshehjen e tyre është shumë e dukshme.*

- Raporti i dytë nga data 25.09.2013 deri me datë 09.10.2013, poashtu përfshinë kryesisht biseda telefonike të zhvilluara në lidhje me shitblerjen e armëve, të poshtëshënuara:

Me datë 01.10.2013 ora 13:14:13, **Pi** komunikon me NN personin e panjohur i cili kërkon nga Pi që t’ia dërgojë 3 kompleta fishek 6 mm dhe 1 armë të kalibrit 6 mm. Në ora 14.29:52 NN personi e thërret sërish dhe kërkon të takohen tek Evropa.

Me datë 09.10.2013 në ora 14:13:41, **Pi** komunikon me F në numrin e tel 049 850-946 ku bëhet fjalë për 100 dhe 9 të gjatë (fjala 100 ka të bëjë me çmën siç përcaktohet sipas çmimit të shitjes dhe fishek cal.9mm).

- Raporti i tretë nga data 10.10.2013 deri me datë 24.10.2013, poashtu përfshinë biseda telefonike të zhvilluara në lidhje me shitblerjen e armëve, të poshtëshënuara:

Me datë 11.10.2013 në ora 13:43:05 i akuzuari **Pi** e thërret vëllaun Mn në numrin tel. 049/894-350 “veç ngjyrë krom” dhe M i thotë “po ka”( që do të thotë se flasin për ngjyrë të armës).

Me datë 13.10.2013 në ora 10:48:22, **Pi** komunikon me personin me emrin Florim të cilët bisedojnë për 1 komplet fishek prej 50 copa ma gazë të cal.9 mm dhe 25 fishek të cal.7 mm, po ashtu e lënë të takohen te Evropa, kurse Pi në ora 11:23:59 ia cingirron telefonin Ft në numrin e tel. 044 ////.

Me datë 17.10.2013 në ora 19:25:49, **Pi** komunikon sërish me F në numrin e tel.049 850 - 946 , ky i fundit i thotë se është duke u kthyer nga Mramori dhe kërkon prej tij t’ia sigurojë një armë të madhe të kalibrit 7 mm ngjyrë të zezë dhe 2 a 3 copa fishek në të.

Me datë 20.10.2013 në ora 12:59:57, **Pi** komunikon me F numrin e tel.049 850 -946, ku F

i kërkon 2 komple ta fishek të cal.9mm, pasi që Pi nuk është në shtëpi, F e pyet a është vëllau i vogël në shtëpi, Pi i thotë “është me mua”, F interesohet se kur do t’iu vijë malli, kurse Pi i thotë “nëse marrim këto ditë të lajmëroj”. Ndërsa paraprakisht në ora 12:44:39 Pi e thërret Mn në numrin 049//// dhe i tregon se është me Pin.

Me datë 22.10.2013 në ora 14:12.05 **Pi** e thërret personin me emrin Florim dhe i thotë eja kur të duash (ngase paraprakisht i kishte ehtënë se të lajmërojë kur të malli.

Me datë 23.10.2013 në ora 19:07.13 **Pi** e thërret NN personin e panjohur në numrin e tel. 044 /// ku flasin për armë dhe fishkeë, mirëpo përdorin fjalët “kantë të zezë” “dy të mdhaja dy të vogla, dhe një asi komplet për to”, ndërsa Pi i thotë “hazër nuk kemi “

*Fjalët “hazër nuk kemi” nënkuptojnë se nuk kanë të gatshme që dmth se është fjala për modifikim të armëve.*

Me datë 24.10.2013 në ora 11:20:30, **Pi** pranon telefonatë nga NN personi i panjohur me numër tel 377 45 493 873 i cili ia kërkon Dy kompleta, e që dyshohet se janë fishekë, ngase Ai më parë personit me këtë numër –Gipës i ka dërguar armë dhe fishekë

Me datë 24.10.2013 në ora 13:45:56, Ai nga numri i te.049 /// e thërret NN personin e panjohur (Liridonin) në numër tel 049 ///ky i fundit i kërkon Ait se dëshiron ti blej tri copa, një 60-she dhe dy 100 –she . Liridoni është blerës i rregullt i armëve nga Ai.

*Nga bisedat e lartshënuara telefonike, gjykata vërteton se të akuzuarit përdorin edhe numra të tjerë të telefonit dhe janë shumë më të kujdesshëm në biseda telefonike pas datës 21.09.2013 kur i janë zënë të akuzuarit A armët në veturën “Golf 2” kur është ndaluar në fshatin Llugaxhi, ngase kjo vërehet dukshëm gjatë komunikimeve, mirëpo poashtu vërehet aktiviteti i shtuarkriminal i vëllezërve të tjerë si Pit, meqë tani i akuzuari A është në arrati, kurse i akuzuari P ka komunikime të shumta dhe bënë shitjen e armëve personave të ndryshëm.*

**Nga Prova nr.2** Raporti i vëzhgimit i nxjerrë në bazë të urdhëresës për monitorim të fshehtë dhe vëzhgim të datës 23.11.2013

Dëshmohet se ekipet e vëzhgimit përcjellin të gjitha lëvizjet e të akuzuarit M F nga ora 04:40 tek shtëpia, e në ora 9:33 afër shtëpisë së Mt vjen vetura “ Xhip Suzuki” dhe dalin

dy persona një mashkull 50 vjet dhe femer 40 vjet, të cilët hyjnë në oborr të Mt, në ora 09:35 vozitesi i veturës “Xhip Suzuki” e merr veturën dhe e shtinë në oborr dhe pas pak ndalet vëzhgimi sepse intervenon ROSU me datë 23.11.2013 në ora 09:47.

*Vlenë të theksohet se kjo provë ndonëse ka të bëjë me të akuzuarit që nuk janë pjesë të këtij aktgjykimi ( M F, Sh dhe F H edhe pse kanë qenë pjesë e aktakuzës PPS.nr.105/2013) mirëpo është e rëndësishme të vlerësohet se, derisa gjendej i akuzuari A ende në arrati, ai komunikonte me këta persona me qëllim që të furnizohej me armë ngase ai me vëllezërit F veprimtarinë asnjë moment nuk e kishin ndërprerë, pritja dhe ardhja e këtij qifti nga Maqedonia me veturën “Xhip Suzuki” tek shtëpia e të akuzuarve F ishte e planifikuar, ashtu që gjatë bastisjes së policisë u gjetën armët në këtë veturë, e kjo qartazi tregon se këta dy persona njiheshin mirë me të akuzuarit F, komunikonin, e dinin saktë vendbanimin e tyre dhe kishin qëllimin e tyre të përbashkët për furnizim dhe shitblerje të armëve.*

**Nga Prova nr.3** dëshmohet se me armët dhe pjesët tjera të sekuestruara nga të akuzuarit F janë examnuar dhe janë evidentuar si dëshmia **X#1** deri **X#9** të poshtëshënuara:

**Dëshmia X#1**, janë dy pistoleta automatike Ekol Jackal Dual, cal.9mm gas, pas testimit ka rezultuar se jane funksionale, si dhe 2 karikator me kapacitet secili prej 15 fishekëve të kalibrit 9 mm gas, të dizajnuar për këto lloj arme; *(këto armë sipas Ligjit për Armët 03/L-143 i takojnë kategorisë A -10 si armë të zjarrit të ndaluara)*

**Dëshmia X#2**, është pistolet automatike Ekol të kalibrit 9 mm gas dhe pas testimit, ka rezultuar se është funksionale; dhe 1 karikator me kapacitet prej 15 fishekëve të kalibrit 9 mm gas,

**Dëshmia X#3**, është pistoletë automatike Zoraki 917-B të cal. 9mm gas, dhe pas testimit, ka rezultuar se është funksionale;dhe një karikator i zbrazur me kapacitet prej 14 fishekë të cal.9 mm gas, të dizajnuara për këto lloj pistoleta

**Dëshmia X#4**, janë 100 pistoleta gjysëm automatike Ekol Special 99, të kalibrit 9mm gas, të cilat pas testimit, ka rezultuar se jane funksionale dhe 100 karikator të zbrazur me kapacitet prej 8 fishekëve të cal.9mm gas;

**Dësmite X 5** janë 20 kutia me nga 50 fishekë të cal.9mm gas gjithsejt 1000 fishekë të cal.9mm gas, si dhe 70 kutia tjera me nga 50 fishekë 9mm gas gjithësejt 3.500 fishekë

**Dëshmia X#6**, janë 750 pistoleta gjysëm automatike Ekol Tuna të cal.8mm gas, pas testimit, ka rezultuar se jane funksionale, si dhe 50 karikator të zbrazur me kapacitet prej 6 fishekëve të cal.8mm gas, dhe;

**Dëshmia X#7**, janë 25 pistoleta automatike Zoraki 917-B të cal.9mm gas, dhe pas testimit, ka rezultuar se jane funksionale; dhe 25 karikatorë të zbrazur me kapacitet prej 14 fishekëve të cal. 9mm gas

**Dëshmia X8 janë 500 fishekë të cal.8mm gas**

**Dëshmia X#9**, është pushkë gjuetije TOZ-63 dhe pas testimit, ka rezultuar se është funksionale;

**Dëshmitë X#5 dhe X#8**, janë rreth 5000 fishek të llojeve dhe kalibarave të ndryshëm, dhe një pjesë e tyre janë përdorur për testim të armëve të sekuestruara dhe kane qenë funksionale

**Dëshmia X#2**, është pistolet Ekol dhe pas testimit, ka rezultuar se është funksionale;

**Dëshmia X#3**, është pistoletë automatike Zoraki dhe pas testimit, ka rezultuar se është funksionale;

**Dëshmia X#4**, janë 100 pistoleta Ekol dhe pas testimit, ka rezultuar se jane funksionale;

**Dëshmia X#6**, janë 50 pistoleta Ekol dhe pas testimit, ka rezultuar se jane funksionale;

**Dëshmia X#7**, janë 25 pistoleta Zoraki dhe pas testimit, ka rezultuar se jane funksionale;

**Dëshmia X#9**, është pushkë gjuetije TOZ-63 dhe pas testimit, ka rezultuar se është funksionale;

**Dëshmitë X#5 dhe X#8**, janë rreth 5000 fishek të llojeve dhe kalibarave të ndryshëm, dhe një pjesë e tyre janë përdorur për testim të armëve të sekuestruara dhe kane qenë funksional.

**Nga Prova nr.4** dëshmohe për mënyrën e bastisjes, kohën dhe vendin ku janë gjetur armët dhe sendet tjera të sekuestruara në veturën e të akuzuarit A F “Golf 2” ngjyrë metalike me targa regjistrimi 01-////të ndaluar në fshatin Llugaxhi Komuna Lipjan, ku janë gjetur dhe sekuestruar vetura dhe 66 pistoleta, 30 kutia me nga 50 fishek, etj.

Raportohet se në veturën e ndaluar në fshatin Llugaxhi të Komunës së Lipjanit, afër pompës së derivateve “Standard” me datë 21.11.2013 rreth orës 22:30 nga patrulla policore është ndaluar vetura Golf ngjyrë metalike me targa regjistrimi ////, me të ndalur shoferi i veturës tani i akuzuari A F ka arritur të ik nga vendi i ngjarjes, me atë rast janë fotografuar dhe evidentuar këto sende: 1 veturë, kuleta me para dhe dokumente në emër të A Ft, 33 pistoleta me gas Ecol Special 99, cal.9mm, 1 paketë me municion me 20 kutia me nga 50 fishekë, cal.9mm, 10 kutia me nga 50 fishekë cal.8 mm, 26 pistoleta Ekol Tuna cal.8mm,

6 pistoleta Ekol Special cal.9mm, 7 pistoleta Ekol Special 9mm.

Bastisja e datës 21.09.2013 kundër të akuzuarit A F, është dokumentuar me fotografi, e gjithë procedura e bastisjes, vendi i bastisjes, sendet e sekuestruara (armët etj) dhe çdo gjë tjetër.

**Nga Prova nr.5** dëshmohet për sendet që janë konfiskuar me datë 21.09.2013 në veturë të t'akuzuarit A F

**Nga Prova nr.6** dëshmohet se çfarë është gjetur dhe sekuestruar me rastin e bastisjes së pronës së të akuzuarve F në lagjen “Kodra e Trimave” në P, rruga “Kadri Zeka”nr.8.

Me datë 23.11.2019 bëhet bastisja e pronës, një pjesë e pronës është e trashëguar dhe ndodhet një shtëpi ku jetojnë vëllezërit Ai (F), Pi dhe P F, me familjet e tyre dhe pjesa tjetër është më e madhe të njëjtën e kanë blerë nga një serb pas lufte, ku ndodhet një shtëpi e pabanuar, në pjesën e sipërme ndodhen dy shtëpi, njëra është e përfunduar dhe e banuar nga tre vëllezërit Ai, M dhe Gi, të njëjti janë pronar të gjashtë veturave.

Sipas Raportit Operacioni i bastisjes i datës **23.11.2013** u mbështet nga Njësia Speciale,ka fillaur 11:00 në vendin e ngjarjes në lokacionin rruga “Kadri Zeka” nr.8 në P, ashtu që janë gjetur dhe konfiskuar në një thes 17 armë kryesisht pistoleta, 2 armë me gas Ekol Jackal Dual cal.9mm të mbështjellura me qese najloni, të gjetura në shtëpinë ndihmëse, në një thes edhe armë të tjetra të evidentaura nga nr.4 deri në nr.19 Ekol Special 99,9mm putian etj.

**Nga Prova nr.7** dëshmohet për sendet që janë konfiskuar me datë 23.11.2013 në oborrin e vëllezërve F, nga të cilat vetëm një telefon perosnal Smasung i zi i takonte të akuzuarit G, ndërsa të tjerat gjithnjë sipas proqesverbalit të të njëjtës datë janë konfiskuar armët e municioni në veturën “Xhip Suzuki” shoferi i të cilës Sh H sapo kishte hyrë në oborr<sup>47</sup>, pastaj edhe dy telefonë Nokia, para në vlerë prej 730 euro të gjetura në një kuletë në katin

---

<sup>47</sup> Në pronën e familjes F (në oborr) me datë 23.11.2013 janë sekuestruar Vetura “Xhip Suzuki” me targë regjistrimi 06-////-AG drejtuesi ishte Sh H ku dhe janë gjetur 39 revole të tipit Ecol Special 99,cl.9mm, 11 revole Ecol Tuna cal.8mm,të zeza, 13 revoel Ekol Tuna cal.8mm ngjyrë metalike, 1 Revole Ecol Jackal Dual cal.9mm, 1 tel i zi me sim kartelë të Maqedonisë, 1 thikë e zezë, të precizuara si në Vërtetimin për sekuestrim të të njëjtës datë.



e dytë të shtëpisë, në atë shtëpi Gi jetonte me të akuzuarin A F, në objektin përcjellës në shtëpinë ndihmëse ishin gjetur dhe sekuestruar 2 revole Ecol Jackal Dual cal 9mm dhe 15 revole Ecol Tuna cal.8mm.

*Nga kjo provë gjykata konstaton se Gi meqë jetonte në një shtëpi me të akuzuarin A i cili ndodhej në arrati është dashtë të nënshkruajë sekuestrimin meqë ka qëlluar në shtëpi, përndryshe nuk është vërtetuar se Gi ka qenë në dijeni për vendodhejn e atyre armëve në shtëpinë ndihmëse.*

**Nga Prova nr.8** dëshmohej për sendet e gjetura dhe të sekuestruara gjatë bastisjes në pronë të familjes F me datë 23.11.2013, nga i akuzuari **P F**,

- Raportohet se janë sekuestruar 1 tel Iphone, 1 tel Nokia, Një Q5+ dhe 4 Radiolidhje Putian, të gjetura në shtëpinë e të akuzuarit, sikur që janë të precizuara në proqesverbalin e kontrollit dhe vërtetimin mbi sekuestrimin e të njëjtës datë.

Gjithsejt nga prona e bastisur-kontrolluar në pronat në familjen F me datë 23.11.2013, pa asnjë vërejtje janë sekuestruar: një Q 5+, **81 armë** (lloje dhe kalibra të ndryshëm), para në vlerë prej 730 euro, telefona dhe katër radiolidhje.

Bastisja e datës 23.11.2013 në pronën e familjes F, është dokumentuar me fotografi, e gjithë procedura e bastisjes, vendi i bastisjes, sendet e sekuestruara (armët etj) dhe çdo gjë tjetër si dhe janë përpiluar proqesverbale e raporte përkatëse.

**Nga Prova nr.9** dëshmohej për bisedat nga Përgjimi për tel. **049 315 834** të t'akuzuarit A F.

- Raporti i parë për periudhën kohore nga 25.07.2013-08.08.2013 dëshmon se, janë zhvilluar 87 biseda të rëndësishme në mes t'akuzuarit A F dhe personave tjerë lidhur me shitblerjen e armëve dhe municionit, vërehet se Ai së bashku me Mn mbulojnë tregun e zi të shitjes së armëve dhe municionit (të llojeve dhe kalibrave të ndryshëm) në një pjesë të madhe të Republikës së Kosovës. Ata furnizohen kryesisht nga Maqedonia dhe pastaj e bëjnë shitjen nëpër Kosovë. Ka raste kur mbesin pa mall edhe për mos me dal keq me klientë Ai komunikon me njerëz të tjerë që shesin armë ilegalisht për të siguruar armën apo

municionin që ju kërkohet nga klientët.

- Raporti i dytë për periudhën kohore nga 09.08.2013-23.08.2013 dëshmon se, janë zhvilluar 95 biseda të rëndësishme në mes të t'akuzuarit A F dhe personave tjerë lidhur me shitblerjen e armëve dhe municionit. Ai ka vazhduar me shitblerjen e armëve dhe municionit, po ashtu ka edhe komunikime të ndryshme me vëllezërit e tij, si **Ain**, Mn lidhur me shitblerjen e armëve, ku gjatë bisedave përmenden edhe **Pi**, po ashtu Ai zhvillon edhe disa biseda me të pandehurin Mn dhe komunikojnë lidhur me sasinë e armëve dhe municionit, llojin dhe kalibrin e tyre, të cilat M duhet t'ia sjellë Ait dhe të tjerëve në Kosovë.

- Raporti i tretë për periudhën kohore nga 24.08.2013-07.09.2013 dëshmon se, janë zhvilluar 37 biseda të rëndësishme në mes të t'akuzuarit A F dhe personave tjerë lidhur me shitblerjen e armëve dhe municionit. Ai ka vazhduar me veprimtarin e tij, mirëpo në këtë periudhë të përgjimit ai komunikon edhe me ndërmjetësuesit tjerë përveç Mt, si me personin Aqifin etj. për t'u furnizuar me mall.

**Nga Prova nr.10** dëshmohet për bisedat nga Përgjimi për tel. **049** ////të t'akuzuarit A F.

- Raporti i parë për periudhën kohore nga 01.07.2013-15.07.2013 dëshmon se, janë zhvilluar disa biseda me rendesi, të poshtëshënuara:

Me datë 01.07.2013 në 16:45:48 biseda për fishekë,

Me datë 01.07.2013 në 22:16:21 pranon SMS nga Maqedonia – “A a do 99 i kam 100 copa 32 euro”

Me datë 02.07.2013 në 15:22:49 bisedë, Ai kërkon edhe 10 copa fishek të kalibrit 6 mm

Me datë 02.07.2013 në 19:26:38 biseda për fishekë të kalibrit 8 dhe 6 mm

Me datë 03.07.2013 në 18:29:19 dhe 18:38:03 bashkëbiseduesi ka shkuar për t'ua takuar në kufi me shitësin e armëve, mes tjerash Ai e pyet se a ka mes tyre Qorra (revolet me gaz)

Me datë 12.07.2013 në 17:30:35 bashkëbiseduesi i thotë: “ausllandera jan“ (*që dmth se blerësi jeton jashtë Kosovës dhe ka ardhë për pushime*)

- Raporti i dytë për periudhën kohore nga 16.07.2013-30.07.2013 dëshmon se, janë zhvilluar disa biseda me rendesi, të poshtëshënuara:

Me datë 16.07.2013 ne 23:04:06, **A** e pyet **A.**, se ku mundet me gjetë fishekë të revoles të tipit “desert eagle” (magnum), 100-200 copa,

Me datë 20.07.2013 ne 19:15:23 bisedon me të pandehurin **M** dhe presin të bëhet terr

Me datë 26.07.2013 ne ora 13:43, **Ai** ne kete thirrje bisedon me personin me emrin **K** i cili kërkon armë me fishek .

Me datë 26.07.2013 ne ora 15:02, edhe ne kete thirrje **Ai** dhe **K.**, bisedojne per nje arme me fishek, por pasi te holla per ta paguar nuk ka mendon t’ia lë nje telefon Nokia.

Me datë 27.07.2017 ne 15:2:43 merren vesh me u taku te restorani Montana, **Ai** i thot : “Qmn e din – ia merr paret atina dhe mua me thu – nisu” pastaj **Ai** shkon në **F** me ia dergu armën.

Me datë 28.07.2013 në 16:17:54 **K** i kërkon 5 complete, me qmn 17 euro (*behet fjale per fishek, kompleti kushton 17 euro*)

- Raporti i tretë për periudhën kohore nga 31.07.2013-14.08.2013 dëshmon se, janë zhvilluar disa biseda me rëndësi, të poshtëshënuara:

Me datë 04.08.2013 në 18:14:50, **NN** personi i panjohur kërkon nga **Ai** një armë **AK 47** të madhe të zezë.

Me datë 08.08.2013 në 14:38:06, personi me emrin **Qamil** kerkon nga **Ai** 200 fishek 6 mm dhe 200 fishek 9 mm, po të njëjtën ditë në ora 14:55:56 **QaMi.**, porosit tek **Ai** 225 fishek 9 mm dhe 100 fishek 7 dhe 6 mm.

Me datë 14.08.2013, ne ora 16:14 min **Ai** pranon thirrje prej **Mt** lidhur per armen me gaz per t’ia derguar personit me emrin **H...**

**Nga Prova nr.11** dëshmohet për bisedat nga Përgjimi i tel me IMEI 3////i të akuzuarit **A F**,

- Raporti i katërt për periudhën kohore nga 08.09.2013-22.09.2013 dëshmon se, janë zhvilluar disa biseda me rëndësi, të poshtëshënuara:

Me datë 14.09.2013 ne ora 17:42, **Ai** bisedon me vëllaun e vet **Ain** i thotë: “me ja dergu te **Gipa** dy qorra” (*flitet për armë me gaz*).

Me datë 14.09.12 ne ora 18:08, **Ai** pranon thirrje prej **Ait** duke i tregu se Policia janë para shitores se **Gipes**.

Me datë 18.09.2013 ne ora 13:47, ne këtë bisede NN personi panjohur kërkon nga Ai një arme te vogël.

Me datë 18.09.13 ne ora 14:38, Ai e thirre **Mn** per nje shkembim te armëve ne mes te vëllezerve F dhe personit me emrin Ilir.

Me datë 20.09.13 ne ora 18:52, Ai e thërret **Mn** dhe i kërkon edhe dy armë me qmim prej 80 eurove qe ti merr me vete per nje tjetër person.

Me datë 20.09.13 ne ora 19:41, Ai bisedon me Mn, ky i fundit i kerkon t'a bëj gati Ai nje arme te vogel cal.8 mm dhe 4-5 fishek sepse eshte duke e prit një person.

Me datë 21.09.13 ne ora 12:38, Ai bisedon me Mn duke kerkuar nga Ai ti dergoj S., 3 copa cal.9 mm, për kete dorezim te armes Ai e dergon **P (vëllau Pi)**.

Me datë 21.09.13 ne ora 14:04, Ai e thirre Mn duke kerkuar qe vetem nje me ia dergu qm 80 euro.

Me datë 21.09.13 ne ora 17:10, Ai bisedon me NN personin e panjohur dhe i thotë “shko te unë mere vete, thuj dikujt t'a jep, ndërsa NN personi i thotë se Ragipi i ka thanë 35 (*flet për çm e fishekeve*).

Me datë 21.09.13 ne ora 22:31, Ai pranon nje thirrje prej Mt dhe i tregon Mt se iu ka ik Policise dhe “duhet me i hjek krejt”, M i thot “u kry”.

Me datë 21.09.13 ne ora 22:36, ne kete thirrje M i thot Ait, “a nuk i ke pa hiq”, ndersa Ai thot “po Pi me tha shkun” dhe Ai i tregon Mt se kan qene “afer 60-70 copa” **gjithashtu Ai i thot shkoni te Di hjekni.**

Me datë 21.09.13 ne ora 22:43, Ai pranon thirrje prej Mt dhe i tregon Ait se nuk ka nevojë të brengoset se krejt me pare do e rregullon këtë punë.

Me datë 21.09.13 ne ora 22:50, Ai pranon thirrje prej personit me emrin Aqif, Ai i thotë se nuk bën me i lan telefonat se mu me kanë ndalë policia, duke i treguar se është ndal ne Kosovë.

Me datë 21.09.13 ne ora 22:51, Ai pranon thirrje nga M duke e pyetur Ain se me cfare veture ka qene (Golf II), pastaj Ai e pyet Mn se a i ka tregu Gazit me i hjek, ndersa M i thot Ait me “ju lajmru Ft se ku jane senet”.

Me datë 21.09.13 ne ora 22:54, Ai bisedon me **Ain** duke e udhëzuar që të “kqyri gjitha anët” (*është fjala qe te largohen nga shtëpia gjithë armët dhe municioni*)

Me datë 21.09.13 ne ora 23:03, Ai pranon thirrje prej personit me emrin Aqif i cili interesohet për veturë, Ai i tregon se e kanë marrë veturën.

Me datë 21.09.13 ne ora 23:36, Ai pranon thirrje prej **Ait** duke i treguar se “i ka largu senet” (*bëhet fjalë për armë e municion*).

Me datë 21.09.13 në ora 23:58, Ai e thirrë Mn kurse M premtion Ain se “as 5 min nuk do t’lë në burg”.

*Nga këto biseda telefonike gjykata vërteton se i akuzuari A deri para kapjes së veturës “Golf 2” ka qenë vazhdimisht i angazhuar bashkë me vëllezërit në veprimtarinë e armëve, ndërsa pas kapjes së armëve në veturën “Golf 2” fillon të brengoset se policia do t’ia gjejnë edhe armët tjera në shtëpi, andaj porosinë vëllezërit Mn e Ain që të pastrojnë shtëpinë, apo siç i thotë “shupën “ e që është shtëpia ndihmëse, por kërkon të pastrohet edhe shtëpia e **D Ft**.*

**Nga Prova nr.12** dëshmohe për bisedat nga Përgjimi për numrin e telefonit **044 ///**, shfrytëzues është i akuzuari **DF**

- Raporti i dytë për periudhën kohore 25.09.2013 - 09.10.2013 dëshmon se, janë zhvilluar disa biseda me rëndësi, të poshtëshënuara:

Me datë 26.09.2013 ne ora 20:27:05, Di komunikon me NN personin e panjohur dhe i thotë “është kry puna” dhe e thërret që të festojnë. *(kjo bisede është në lidhje me rastin e datës 21.09.2013 kur i janë zene Ait armët dhe municioni, sepse ka mundësi që ndokush ju ka premtuar se kjo pune do te kryhet).*

Me datë 30.09.2013 ne ora 15:17:33, **Di** pranon thirrje telefonike prej NN personit të panjohur i cili kërkon nga Di armë dhe fishek.

Me datë, 21.09.2013 ne ora 22:34:28 dhe ora 22:36:04, **Di** e thërret **nënë e tij** ne telefon dhe i thotë: “me i largu sendet që janë në shtëpi te ai, dhe i tregon vendin e çelësit të dhomës ku janë sendet”. Pastaj i tregon se “janë disa në regall tëe tij, një kuti e nje kесе, si dhe në Bodrum nje thes që të gjitha të largohen”, *sepse frikësohet se policia do të shkojnë në kontroll të shtëpisë dhe po ashtu i thotë nënës së tij: “hajde mame hajde veq farllaisi” dikun. (Këto biseda janë zhvilluar menjëherë pasi që është zënë vetura e Ait me armë dhe fishek nga policia e stacionit policor te Lipjanit).*

Me datë 21.09.2013 ne ora 22:38:17, **P(Pi)** nga numri i telefonit të **D** e thërret **Mn** dhe i thotë që ti largon nga **zalli (armët dhe municionin), i thotë ” edhe te Di shko merri do, nshup..”**.

**Me datë 21.09.2013 ne ora 23:18:27, Di** komunikon me **///n** (i cili gjendet ne studion e tij muzikore) dhe i thotë “**eja ne shtëpi sepse është zënë Ai**”. Po ashtu në ora 23:20:52, **///** e pyet Din se a i ka hjek senet prej shtëpis se tij, kurse Di i thotë: “**eja vlla sepse nuk di**

**ku me i qu unë, sepse ne çdo kohe munden me ardhë”. (është fjala për policinë në kontroll të shtëpive).**

Me datë 23.09.2013 ne ora 14:31:51, Di pranon thirrje prej D (motrës së vëllezërve F) e cila i thotë: gati u kry puna. Po ashtu i tregon se një femër me emrin E e ka kërkuar letërnjoftimin e Dit, që t’ia dergojnë, ndërsa Di i tregon se letërnjoftimin e ka Flori.

*Nga këto bisedat gjykata vërteton angazhimin e të akuzuarit D në veprimtarinë kriminale të armëve, i cili kishte vendosur armë edhe në shtëpi të vet, dhe pas kapjes së armëve në veturën e të akuzuarit A “Golf 2” ishte brengosur se si t’i largojë ato menjëherë nga shtëpia, angazhon edhe nënën e tij që siç thotë “t’i fërfëllisë dikah”. Poashtu vërtetohet edhe dijenia e të akuzuarit P për vendodhjen e armëve i cili i kërkon vëllaut Mt derisa bisedonte me telefon të t’akuzuarit D që t’i largojnë armët edhe nga siç thotë “shupa” edhe nga “zalli”.*

**Nga Prova nr.13** dëshmohe për bisedat nga Përgjimi për numrin e telefonit **049////**, shfrytëzues **A F**

- Raporti i dytë për periudhën kohore nga 09.10.2013-23.10.2013, dëshmon se, janë zhvilluar biseda me rëndësi, të poshtëshënuara:

Me datë 09.10.2013 ne ora 15:50:26, Ai pranon thirrje prej **Ait** i cili i tregon qe ka thirr nje person te cilin e quan me nofken Guma, e i cili ka kërkuar guma. Kurse Ai i thotë dergoja, mirëpo pasi që Ai heziton Ai i thotë tregoj qe pas nje ose dy ore takohemi kah Fushë Kosova.

**6.4. Vlerësimi i Dëshmive Shtesë** me të cilat dëshmohen poashtu bisedat që janë zhvilluar nga të akuzuarit e poshtëshënuar me numra që ata i kanë shfrytëzuar, bazuar në raportet policore përkatëse:

**Dëshmitë për të akuzuarin P F**

- Raportet e Policisë për masën e fshehtë të regjistrimit të bisedave telefonike, tregojnë se i akuzuari **P F** nga numri i tij i telefonit **044 ///** dhe nga numra tjerë, ka zhvilluar komunikime me të akuzuarit tjerë, si në vijim: .

Me datë 02.11.2013 ne ora 15:27:24 M thërret **Pin** të cilit i tregon ne lidhje me një porosi dhe pastaj nuk ka dashte dikush me pagu dhe i thotë se duhet me shku deri te Skenda, kurse Pi i thotë hajt shtyja edhe pak. Po ashtu në ora 15:44:54 M thërret Pin dhe e porosinë

kësisoj: “një gjysmë kompleti, një 100-she, një komplet qorra edhe një asi me kanë crni a po e din zi, që ti dërgoj tek një klient”.

Me datë 20.09.2013 ne ora 15:53:37 M thërret **Pin** të cilit i thotë: “merri tre kompleta te 100-she, një 100-she, nja 50-she, dhe i thotë qe ti vendose “ne njërën dy, e ne tjetrën katër fishekë”.

Me datë 28.07.2013 ne ora 16:56:02 M thërret **Pin** dhe i thotë a po shkon deri te ai plaku – Salihi, qoja një asine, Pi e pyet a të zi, e M i thotë” po edhe do asine. *(fjala për armë dhe fishek).*

Me datë 12.08.2013 ne ora 10:16:39 dhe 10:21:11 M thërret NN personin e panjohur ne numrin 049///059 te cilin e pyet “a e ki Pin aty, pastaj i kërkon prej **Pit** qe ti dërgoj një qasi qe ke e zeze te stanica e vozit”(që edhe ma herët ja kishte dërguar një). Pastaj thërret prap dhe i thotë bire edhe një kuti për te”. *(është fjala për dy armë dhe një kuti fishekë).*

Me datë 18.09.2013 ne ora 20:19:16 M bisedon me Ain te cilit i thotë “qoma **Pin** ose ti nuk o problem dhe e porositë për disa pistoleta dhe municion me marre me vete”, Ai i thotë “për te Magjupi a po”, M i thotë “po”.

*Nga këto biseda gjykata vërteton kontributin e të akuzuarit P në kryerjen e veprës penale, i njëjti në të gjitha rastet kishte aprovuar kërkesat e vëllezërve A e M për transportim dhe shitje të armëve tek personat e ndryshëm.*

### **Dëshmitë për të akuzuarin P F**

Raportet e Policisë për masën e fshehtë të regjistrimit të bisedave telefonike, tregojnë se i akuzuari P F nga numri i telefonit **049** //// dhe nga numra tjerë, ka zhvilluar komunikime me të akuzuarit tjerë.

Me datë 24.07.2013 ne ora 15:36:26 **Pi** nga numri i telefonit të Mt e thërret një NN person të panjohur me numrin tel 045517246 i thotë: “O haxhi Piti jam se M ka shku deri ne Shkup, NN i porosite 4 kutia fishek me gaz edhe 2 me numer 7”.

Me datë 21.09.2013 ne ora 22:38:17, **Pi** nga numri i telefonit te **Dit** e thërret Mn dhe i thote qe ti largojë nga zalli, kurse “te Di shko merri do, nshup”.

Me datë 30.07.2013 ne ora 16:32:44 Ai e thërret Pin dhe i thotë, “ta dergoj me mesazh numrin e telefonit te atij te Rahovecit edhe takoheni dikun ne rrugë kah Fush Kosova, aj e ka njo te 110”. (*bëhet fjalë për armë*).

Me datë 18.09.2013 ne ora 14:38:51 bisedojnë M me vëllain e tij Ain rreth një pune qe ka M dhe ne përgjithësi rreth veprimtarisë se tyre, ndër tjera Ai i thotë Mt se “kqyr Piti (Pi) e ka një qasi”.

### **Dëshmitë për të akuzuarin A F**

Raportet e Policisë për masën e fshehtë të regjistrimit të bisedave telefonike, tregojnë se i akuzuari A F nga numrat e telefonit, **049 ////**, **049 ////** dhe nga numra tjerë, ka zhvilluar komunikime me të akuzuarit tjerë.

Me datë 14.09.2013 ne ora 17:42:17, Ai e thërret Ain dhe i thotë: “ti ose Gazi shkoni dej te Gipa me ja dergu dy qorra”. (*behet fjale per dy armë me gaz*). Pastaj në ora ne ora 18:08:59 Ai e thërret Ain dhe i tregon se janë policia para shitores së Gipës, dhe se duhet që Gipa te shkon te takohet me Ain.

Me datë 22.11.2013 ne ora 16:56:52, Ai e thërret Ain dhe i tregon se është tu e prit një person, nuk po din çka me bo, a me ja kthy paret a jo? (*Ai nuk ka mundur të gjejë saktësisht ndonjë lloj të kalibrit të fishekve apo armëve, ku i ka fsheh Ai*), pastaj Ai ia tregon vendin saktësisht se ku janë te fshehura dhe i thotë qe te kontrollon “**aty ku qet nena flija**”. Pak më vonë në ora 17:25:02 Ai e thirrë Ain dhe e pyet a i kanë gjetur dhe Ai ia pohon.

### **Dëshmitë për të akuzuarin G F**

Dëshmitë për G Fn janë vlerësuar nga gjykata në fq. 39 të këtij aktgjykimi dhe në të njëjtat nuk janë gjetur elemente inkriminuese.

### **Dëshmitë për të akuzuarin K.S**



Raportet e Policisë për masën e fshehtë të regjistrimit të bisedave telefonike, tregojnë se i akuzuari K.S nga numri i tij i telefonit **045** ////, ka zhvilluar komunikime me të akuzuarit tjerë si më poshtë:

Me datë 10.08.2013 ne ora 12:29:44, **Kreshiku** e thirre Ain dhe kërkon nga Ai nje komplet fishek (*fjalën fishek e zevendson me fjalën pasul*), Ai i thote: “per gjysm ore vi naton e ti sjelli”.

Me datë 05.07.2013 ne ora 15:59:48, **K** komunikon me Ain dhe i thotë “eja te une deri ne Lipjan, shkojm te nje vend e lojm diqka edhe i marem paret” kurse Ai i thotë “ te njejt a? Ku i thote “po, une e di qe edhe dy copa janë”, kurse Ai ia kthen: “nje e di qe eshte, e fundit”, pastaj ne ora 16:02:34, Ku i thotë Ait: “pasi qe e ke vetem nje te fundit shtine dikun ne bir te miut edhe mos ja jep askujt, sepse do ta nali për veti”. Ai i thote: “eshte ngjyra më e hint, por do ta mar edhe nje të zez, pastaj cilën dush e mer”, Ku i thote: “ une jam gati, deri sa tvjen aj, nje asine dhe 50 asine. (*bëhet fjal për armë dhe fishek*). Po ashtu ne ora 16:50:23, Ku nga Ai i kërkon “plus 50 copa”. (*bohët fjalë për fishek*)

Me datë 20.07.2013 ne ora 22:51:50, Ai dhe **Ku** zhvillojnë një bisedë behet fjale per nje arme me qmim 100 euro dhe 200 copa fishek.

Me datë 26.07.2013 ne ora 13:43:18, Ai dhe Ku zhvillojnë një bisedë ne lidhje me një pagesë të nje arme dhe te 100 copa fishekëve. Po ashtu në ora 15:02:44, kuptohet se Ku për pagesë te armës dhe fishkëve, ia len Ait nje sasi te hollave dhe nje telefon Nokia.

Me datë 27.07.2013 në ora 15:26:43, **K** i thote Ait “kah ora dhetë ma sjell te restorant Montana”, kurse Ai i thote “hajt, çmn e din, ia mer paret atina edhe mua me thu nisu”. (*Ne bazë te bisedes kuptohet se Ai do te shkojë në F me ja dergu armen*). Po ashtu ne ora 19:05:25, Ku i thotë “nje person vjen prej Shkupi me ble nje arme me 50 copa fishek dhe e lënë të takohen te restorant Montana”.

Me datë, 28.07.2013 në ora 16:17:54, **K** kërkon nga Ai 5 complete, çm 17 euro. (*behet fjale per 5 complete fishek nga 17 euro*).

Me datë 29.07.2013 në ora 23:19:23, **K** komunikon me Ain, dhe sipas bisedës kuptohet do të behet ndërrim i armëve për shkak të ngjyrave.

*Nga këto biseda gjykata vërteton kontributin poashtu edhe të t'kuzuarve A, P, K në kryerjen e veprës penale, të njëjtit kishin ndërmarrë veprime të ndryshme sipas marrëveshjes me vëllezërit Ain dhe Mn.*

### **Dëshmitë për të akuzuarin Xh,S**

Raportet e Policisë për masën e fshehtë të regjistrimit të bisedave telefonike, tregojnë se i akuzuari Xh.Snga numri i tij i telefonit **045 ///**, ka zhvilluar komunikime me të akuzuarit tjerë, si më poshtë:

Me datë 10.09.2013, në ora 19:14:29, Xh komunikon me një person të panjohur dhe porosinë 10 fishek të TT-së;

Me datë 20.09.2013, Xh.Sme M B n komunikojnë për armë me gaz, të cilën e kishte kërkuar më parë Xh, dhe M i thotë se “sot vinë ata të Ps edhe i binë dy, se ashtu ju ka thanë”, kurse Xh i thotë “le ti bjen se ja thaj paret”.

Me datë 21.09.2013, Xh komunikon me NN personin e panjohur i cili i thotë Xht “ ju ka lajmru ai shoku për ato me gaz” që ky e ka pyet më herët, kurse Xh e pyet për çmën, e ai i thotë se “ka 55 i kish 50 copa”.

Po të njëjtën datë nga ora 16:54:33 deri në ora 17:44:03, Xh dhe M zhvillojnë disa biseda telefonike rreth kalimit ilegal të kufirit nga fshati Dimce – Kosovë në fshatin Bllacë – Maqedoni (*gjate kësaj kohe e kanë bërë transportin e armëve nga Maqedonia*).

Po të njëjtën ditë në ora 21:46:28 Xh e thirre Mn dhe i tregon se “kerrin jav ka dhanë” (*bëhet fjalë për kerrin e ngarkuar me armë, me të cilin më vonë është ndalur A F dhe janë sekuestruar armët*).

Me datë 23.09.2013 në ora 19:09:14, Xh komunikon me Mn, ku gjatë bisedës e pyet se “a ka fol me ata Plit”, kurse M i thotë se “nuk kam fol”, por e din se ata kanë ra sigurt (*janë*

*ndal nga policia).*

Po ashtu në ora 20:41:56, M e thërret Xhn dhe i tregon se “e ka thirre vëllau i Ait dhe se e ka kërcënuar”, kurse Xh i thotë se “kur të duash i shkojna në shtëpi në P”. *(Fjala është për komunikimin e Mt me Mn, ku M ka dyshuar se këta e kanë lajmëruar policinë).*

*Nga bisedat e lartshënuara vërtetohet komunikimi i të akuzuarit Xhme të pandehurin M B për sigurimin e armëve për mënyrën e importimit përkatësisht të transportimit ilgal të atyre armëve, për të akuzuarit A e M, të cilët i njifnin mirë si “Pli”.*

#### **6.5. Vlerësimi i provave materiale që i përkasin aktakuzës PPS.nr.42/2019**

**Nga prova nr.1** dëshmohet se armët dhe pjesët tjera të armëve të sekuestruara nga të akuzuarit janë ekzaminuar dhe të njëjtat janë evidentuar nga **D#1** deri **D#79** si më poshtë:

**Provat nga D#1 deri në D#25 dhe D#70 deri në D#79 janë armë me gaz** dhe pas testimit ka rezultuar se të gjitha janë funksionale.

**Provat: D#26, 27, 28, 29, 30, 31, 32, 33, 34, 35, 37, 39, 40, 41, 42, 43, 45, 48, 50, 51, 52, 53, 56, 57, 58, 59, 60, 61 62 dhe 63 janë armë zjarri**, ku pas testimit ka rezultuar se të gjitha janë funksionale.

**Prova D#45** ka qenë armë e llojit Ekol me gaz e kalibrit 9 mm, e cila është **ridizajnuar dhe është kthyer në armë zjarri 7.65 x 17 mm**, e cila pasi është testuar ka qenë funksionale.

**Provat D#36, D#38, D#54, D#55 janë armë zjarri**, mirëpo nuk janë testuar ne mungese të municionit.

**Provat D#44, D#46, D#47 janë armë të llojit Ekol**, në të cilat është ndërhyrë në ridizajnimin e tyre për t’u shëndrruar në armë zjarri, mirëpo ridizajnimi nuk është kryer dhe janë jo funksionale.

**Provat nga D#68 e deri në D#69 janë:** disa tyta armësh të modifikuara, gypa në të cilët është punuar për ndërtimin e tytave të armëve, gypa dhe pajisje të punës si: Turjela (burgija dhe thika) të dimenzioneve të ndryshme, çekanë etj.

*Nga kjo dëshmi shkencore gjykata konstaton të vërtetuar faktin vendimtar se armët e konfiskuara disa ishin me gas dhe ishin funksionale, disa ishin të modifikuar në armë të*

*zjarrit, disa ishin në proqes të punës për modifikim dhe atë me vegla e pajisje të përshtatshme për modifikim apo prodhim të armëve të zjarrit<sup>48</sup>.*

**Nga prova nr.2** dëshmohet se për secilin nga telefonët e sekuestruar nga të akuzuarit e përfshinë në pikën 2 të dispozitivit të aktakuzës, pas examinit ishte konstatuar si në vijim:

**Prova D#1 – Telefon Iphone me nr. IMEI: 359////**i sekuestruar nga i akuzuari **A F**, është ekzaminuar dhe nuk është gjetur ndonjë material, dëshmi që ndërlidhet me rastin, përveq disa bisedave normale në rrjetet sociale ndërmjet të akuzuarit A dhe personave L M dhe Sh M, të cilët janë djemt e të akuzuarit R.M.

*Nga Prova D#1 gjykata vërteton se i akuzuari A padyshim është njohur jo vetëm me R.Mn (me të cilin komunikonte si “Gipa” apo edhe “Sllatina” ngase vinte nga ky vend), por edhe me djemët e tij, e që bie në kundërshtim me pretendimin e tij se nuk i njeh të akuzuarit tjerë pavarësisht se R.M është liruar nga akuza për çështje procedurale. Fakti se “Gipa” është R.M e kishte deklaruar vet R.M .*

**Prova D#2 – Telefon Iphone me nr. IMEI: 35206706429162** i sekuestruar nga i akuzuari **P F**, është ekzaminuar dhe në telefon kanë qenë të regjistruar numrat e telefonave të t’akuzuarve: **N.M** (Malisheva 049/323-649), **M.sh (Mi., 044////-///)** dhe **R.M** (Sllatina 044/146-922).

Janë gjetur dy fotografi të një fisheku të krijuara me datë 19.07.2019, ku në njërin nga fotot është mbishkrimi S&B 7x57.

Poashtu gjendet edhe një bisedë në aplikacionin Viber në mes **P Ft** (044 ///) dhe numrit 049//// me emrin F e datës 16.07.2019, ku ndër të tjera në ora 08:16:16 personi me emrin F e pyet Pin se “a mundesh një qasi” (dyshohet se është fjala për armë) dhe Pi i thot “po vijë kah shpija jote a je në shtëpi” dhe në ora 08:43:01 i thotë Fit “a po del se te shpija jote jam” dhe ai del dhe takohen (komplet biseda eshte ne CD e evidentuar si dëshmia me numër D#2).

---

<sup>48</sup> Neni 372 të KPRK - Importi, eksporti, furnizimi, transportimi, prodhimi, këmbimi, ndërmjetësimi ose shitja e paautorizuar e armëve apo materieve plasëse, në par.3 precizon: Për qëllime të këtij neni, shprehja “prodhim” i armëve përfshin shndërrimin apo modifikimin e ndonjë sendi në armë ose të një arme në një lloj tjetër të armës, apo deaktivizimin ose riaktivizimin e ndonjë arme.

*Nga Prova D#2 gjykata vërteton se në telefonin e të akuzuarit P F është numri i telefonit të t'akuzuarit M.sh me shkurtesën e emrit të tij "Mi., 044////-///, që dëshmon se këta dy të akuzuar njiheshin mirë, madje i akuzuari P e njipte edhe e ruante në telefon numrin e Mt me shkurtesë "Mi.,". Poashtu kjo dëshmi vërteton edhe të kundërtën e pretendimit të t'akuzuarit Mim i cili në seancë gjyqësore deklaroi se emrin e ka Mim, duke aluduar në atë se nuk din kush është Mi.,.*

*Poashtu nga Prova D#2 gjykata vërteton se i akuzuari P F i shet diçka të palejuar personit me emrin F dhe atë jo për herë të parë dhe ia dërgon në shtëpi, blerësi e din se Pi e kupton çfarë i kërkon, përndryshe blerësi do të sqaronte për çfarë është fjla, ky fakt konstatohet në ndërlidhje me veprimtarinë me të cilën merret i akuzuari P në këtë kohë.*

**Prova D#10 – Telefon Samsung me nr. IMEI 359/////**, i sekuestruar nga i akuzuari N.M është ekzaminuar dhe në të ka qenë i regjistruar numri i telefonit të t'akuzuarit P F (**Pt.pr.vllavi.vogel 044 693 990**), poashtu janë gjetur disa biseda me persona të ndryshëm që kanë të bëjnë me shitblerje të armëve.

*Nga Prova D#10 gjithashtu vërtetohet se i akuzuari P F njihej me N.Mn, ndërsa të njëjtit derisa ky i fundit u bë i paçasshëm për gjyktën, pretendonin se nuk njiheshin fare.*

**Nga prova nr.3** dëshmohej se nga bastisja në pronën e vëllezërve F me datë 24.07.2019 janë gjetur dhe sekuestruar në shtëpinë dhe punëtorinë e të akuzuarit A F 102 fishekë të kalibrave të ndryshëm, tre brusha për pastrim të armëve, 39 tyta të modifikuara me gjatësi prej 7.8mm, 10 tyta me gjatësi 11.8 cm, dy kutia me goditës për vuarje të numrave në metal, 5 pjesë metalike të armëve, 17 burgia të plota, dhe 10 burgia të thyera, pajisje pune etj

*Poashtu gjykata me këtë provë vërtetoi se pajisjet e sekuestruara të punës të gjetura në punëtorinë nën shtëpinë ku jetonte i akuzuari A ku i njëjti ishte mjeshtri kryesor, gjë që nuk kontestohet nga asnjëra palë, shërbenin për modifikimin e armëve, apo prodhimin e armëve siç precizohet në nenin 364 par.3 të KPRK (shprehja "prodhim" i armëve përfshin shndërrimin apo modifikimin e ndonjë sendi në armë ose të një arme në një lloj tjetër të armës, apo deaktivizimin ose riaktivizimin e ndonjë arme).*

**Nga prova nr.4** dëshmohet se nga bastisja e datës 24.07.2019 në pronën e të akuzuarit A F janë gjetur të groposura 25 armë me gas dhe armë zjarri.

**Nga prova nr.5** dëshmohet se me datë 31.05.2019 në rrugën Kaqanik-F, në hyrje të Ft është ndaluar automjeti “Golf 5”, ngjyrë hiri me targa regjistrimi ///të cilin e drejtonte i akuzuari A S, ku gjendeshin 10 (dhjetë) pistoleta të tipit Ecill-Special, 99 të cal.9mm, dhe 1 (një) thikë ngjyrë e zezë. Armët janë gjetur të mbështjellura ndaras në dy qese najloni, të gjitha këto janë të fotografuara në fotoalbumin e bashkangjitur në shkresa të lëndës dhe janë të precizuara në vërtetim për sekuestrim të sendeve të datës 31.05.2019.

**Nga prova nr.6** dëshmohet se nga i akuzuari A S me datë 31.05.2019, janë gjetur dhe sekuestruar edhe tre telefona (*Iphon, Samsung dhe Nokia*)

**Nga prova nr.7** dëshmohet se Raportet 15 ditore mbi zbatimin e Masave të Fshehta teknike të hetimit dhe vëzhgimit nga Policia e Kosovës DHKO, janë të lëshuara sipas urdhërësive të ligjshme të gjyqtarit të procedurës paraprake (*fotografim ifshehte ose vëzhgim me video në vendet publike; monitorim të fshehte të bisedave në vendet publike; përgjim të telekomunikimeve përfshirë tekstet e mesazheve ose mesazhet tjera elektronike*).

Nga Raporti i parë 15 ditor i përgjimit ligjor të telekomunikimeve për të akuzuarin A S për numrin tel. 045///// për periudhën kohore 28.02.2019-14.03.2019 dëshmohet se i akuzuari A S nga nr.tel të tij gjatë kësaj periudhe ka qenë shumë i kujdesshëm dhe nuk ka zhvilluar biseda të gjata në telefon, vetëm biseda të shkurtëra dhe ka lënë takime.

Nga Raporti vijues 15 ditor për masa të fshehta teknike të vëzhgimit (raporti i përgjimit përfshirë periudhën kohore 28.02.2019-14.03.2019) për të akuzuarin A S, dëshmohet se i akuzuari A S gjatë kësaj periudhe ka pasur shumë lëvizje deri tek pika kufitare në Merdar, po ashtu me veturën e tij Golf 5 shumë here ka kaluar kufirin me Maqedoninë, ai takohej me një person nga Shkupi me qëllim të kontrabandimit të armëve.

**Nga Prova nr.8** dëshmohet se i akuzuari A S ka kaluar disa herë kufirin me Maqedoninë brenda kësaj periudhe kohore.

**Nga Prova nr.9** dëshmohet se i akuzuari A S me datë 30.04.2019 në ora 11:24:00 ka ardhur në Prishtinë me veturën “Golf 5” me targa regjistrimi ///-KS-///, ka shkuar tek shtëpia e të

akuzuarit A Ft ne lagjen Kodra e Trimave. Gjithashtu edhe nga video incizimi i kamerave dhe GPS-i shihet se vetura e njëjtë Golf V ngjitet rrugës për tek shtëpia e A Ft, ne krye te rrugës kthehet dhe lëshohet përsëri te poshtë dhe parkohet në anën e djathtë të rrugës përballë dyerve të oborrit tek shtëpia e të akuzuarit A, shihet kur i akuzuari A zbret nga vetura dhe futet ne oborrin e shtëpisë së të akuzuarit A ne ora 11:25:10 ku aty takohet me Ain dhe disa nga vëllezërit e Ait, ku me Ain qëndron deri ne ora 11:42:20 koha kur shihet duke dalë nga oborri së bashku me të. Në ora 11:43:30 largohet i vetëm nga shtëpia e A Ft,

*Nga kjo provë gjykata vërtetoi se i akuzuari A S së paku nga muaji prill 2019 jo vetëm që njihej me të akuzuarin A F por ia dinte edhe vendbanimin dhe kishte biseda me të njëjtin dhe kjo ishte e pa diskutueshme, ngase përveç GPS dhe inqizimit me kamera poashtu është bërë vëzhgimi edhe nga hetuesit policor-hartues të raportit, andaj si e tillë ka fuqi provuese të pakontestuar.*

**Nga Prova nr.10** dëshmohej për kontaktet telefonike që kishte i akuzuari Adan Sopa me të akuzuarin M.sh,

I akuzuari A S ka përdorur numrin e tel **045////**

**Me datë 09.04.2019 në ora 07:52:59, nga telefoni i të akuzuarit A S, NN personi i panjohur<sup>49</sup> kontakton me tani të akuzuarin M.sh në numrin e tel.044 ///-/// me ç’rast merren vesh për takim dhe sipas bisedës janë takuar tek lokali-kafja e të akuzuarit Mim në rugën 2 Korriku në F. Transkripti: personi i panjohur nga telefoni i At i thotë Mt “Mirëmëngjesi.... a po pimë kafe dikun, M: o shoki jem, po more po gjithqysh, NN: se ba vakija aty se unë ktu jam, M:qysh, NN: ktu te ti se unë jam ngat, a aty ku pishëm kafe aty përpara, M: po ani ani po mos nuk e ka qel ai kaq heret, NN:aaa, NN: te ti ktu hajde te ti, M: ani de ani te unë tash po vij, NN:hajt, M: rat jam veq veshna saora, NN: hajt, hajt u ba u ba se të priti, hajt tung”**

**Me datë 10.04.2019 në ora 19:33:30** i akuzuari A zhvillon dy biseda me NN personin e panjohur në numrin e tel 044//// i cili i thotë At Transkripti “NN: ku je, hej Policia qaty nalt shkun përpjetë, A:kah kah, NN: qe qaty nalt shkun një patroll edhe njo shkojë përpjetë, A

<sup>49</sup> Personi me emrin K.I.nga Shkupi

eee, NN: qata të thirra unë hajt”.A përsëri flet me të njëjtin numër telefoni me datë të njëjtë në ora 19:36:46.

*Nga biseda paraprake gjykata vërteton se i akuzuari M.sh përdor numrin e telefonit 044 ///-/// dhe që në mëngjes herët komunikon me dikend nga telefoni i të akuzuarit A që dyshohet të jetë furnizues i armëve, kjo për faktin se një ditë më vonë pasi errësohet i akuzuari A me personin e panjohur flasin për patroll të policisë se si të ruhen prej tyre, me këtë vërtetohet se i akuzuari A është i implikuar në vepra penale përndryshe nuk do kishte arsye të ruhej nga policia, i njëjti në shumicën e rasteve len takime me persona të tjerë të dyshuar me të cilët përdorin shpesh edhe rrjete sociale-viber.*

**Nga Prova nr.11** dëshmohej se i akuzuari A S në periudhën 03.05.2019-31.05.2019 zhvillon biseda telefonike me NN personin e panjohur me numër të telefonit 043///-707

Me datë 25.05.2019 në ora 13:16:40, NN personi i panjohur (*personi me emrin K.i*) e njofton An se është në Han të Elezit dhe e fton për tu takuar në restorantin si atë ditë, që d.m.th. se aty janë takuar edhe më herët. Të njëjtën ditë pakëz më vonë në ora 13:20:33 A i thotë: Transkripti: “kur të vish ktu veç cingrroma se hypa atje te restorani tu pi kafe, NN: hajt hajt, A: cingrroma zhdrypi poshtë ....si të afrohesh ngat, hajt hajt”

Me datë 30.05.2019 në ora 15:59:31 i akuzuari A S bisedon me NN personin e njëjtë të panjohur me numër të njëjtë të telefonit 043///-///, Transkripti: A: a ke te M atje nalt a, .....**a kam me shku unë për te M a ku, NN i thotë: te M ke me shku ama**, A: shko vet kallxojë, NN: do janë te ti ti ke mi marrë, A: ani ani hajt, veç **shko te M vet kallxojë, NN: për sabah i tham, A: pode hajt u ba, hajt hajt”**

Me datë 30.05.2019 në ora 20:58:38 A të njëjtit person i të thotë: Transkripti “....hajde hajde nalu te kafiqi, NN: po jam te freskia, hala kha,....për njo një sahat, A: mos e le ne asgja,

Me datën 30.05.2019 ne ora 22:27:56 i akuzuari A S sërish kontakton me NN personin e panjohur Transkripti: A: “qe në kafiq, NN: **shko nesër kah 09:30 te ai, ... qe aftuban jam tu hie, ...edhe të jep diqka ai, ja jep nesër**, i lajmrohesh ja jep për me ma pru kah shpija



mu, A:u kry u kry, hajt,hajde ndalu këtu te Kafiqi këtu poshtë e hin ne parking ndalu, ndërsa Kimrani i thotë unë jom te Freskia e për nja 1 ore shihemi;

Me datën 30.05.2019 ne ora 22:33:02 A komunikon me NN personin e panjohur, Transkripti: “A: sun folsha mirë se isha me njanin, NN: qe valla tu shku....që ai vjen ma herët, A po aa, NN:se mthirri prej Shkupi qitashti, edhe mkallxojë thuj që nestra të lajmrohna thuj diqka mi que natanë për mue, A: ani ani hajt kur shkojë atje folmi në viber”

*Nga këto komunikime të lartshënuara gjykata ka vërtetuar se i akuzuari A një ditë para se të kapej nga policia gjatë transportit të armëve, disa herë ka komunikuar dhe është takuar me personin K.i nga Maqedonia dhe janë marrë vesh për transportimin e armëve, që armët t'i dërgoj ditën vijuese në mëngjes rreth orës 09:30 te “M” e që është M.sh të cilit diqka ka me i dhanë e diqka ka me i marrë, dhe ky fakt vërtohet edhe me faktin se i akuzuari A vërtetë është kapur nga policia të nesërmen gjatë transportit të armëve në hyrje të qytetit të Fit, tek marketi “Eli Abi”. Faktin se bëhet fjalë për bisedën e të akuzuarit A me personin K.i nga Maqedonia e pohon edhe vet i akuzuari Advavn gjatë deklaramit në polici të Fit.*

**Nga Prova nr.12** dëshmohe se gjatë periudhës kohore 03.05.2019-31.05.2019 hetuesit policor kanë vëzhguar të gjitha lëvizjet e të akuzuarit A S dhe kanë kosntatuar se i njëjti është i involvuar në veprimtari të kundërligjshme me armë dhe në këtë veprimtari janë të përfshirë një rreth i gjërë i të dyshuarve të cilët veprojnë për qëllime përfitimi, i dorëzojnë raportet për vëzhgim me GPS, ndërsa me datë **31.05.2019** arrestojnë tani të akuzuarin A S në flagrancë duke transportuar armë.

**Nga Prova nr.13** dëshmohe se nga përgjimi ligjor i telekomunikimeve, për periudhën kohore 14.05.2018-28.05.2018, nga numri tel 045/////janë zhvilluar disa biseda dhe është konstatuar se shfrytëzues i këtij numri të telefonit nuk është personi me emrin Adil Bruti por është A S, i cili punon tek Adil Bruti. Janë tre biseda telefonike që A S flet me personin me emrin Islam rreth armëve në numrin e tel. 046/156-196, ku Islami dëshiron ti blej prej tij dhe gjatë bisedës psh. me datë **30.05.2018 në ora 14:35:04** i shmangen fjalës armë dhe përdorin fjalën “makiato”. Islami i thotë: “nëse shkon najkah lemi makiatot e hekrave atje një makiato, A e pyet: sa makiato, Islami i thotë...edhe një makiato qorre me shkum sun pi pij a pe din, A: po, Islami: që shkon najkah i len te ai tjetri i la paret aty i merr, A: ani thirrëm kur të vijsh”. Më vonë në bisedën tjetër të njëjtën ditë në ora 16:27:13 merren vesh

për takimin. Pastaj me datë 08.06.2018 në ora 10:07:11 Islami e pyet An “a janë qato muhabete që folëm një ditë a janë hala qashtu a mujm mu taku mbas dy orëve”.

**Nga Prova nr.14** dëshmohej se nga shfrytëzimi i mjeteve për përcjelljen e vendndodhjes-GPS i akuzuari **A S** me veturën Golf V, ngjyrë hiri, me targa ///-KS-///, me datën **30.04.2019** rreth orës 11:24:00 ka ardhur ne Prishtine dhe atë ka shkuar tek shtëpia e të akuzuarit A Ft ne lagjen Kodra e Trimave. Gjithashtu sikur edhe nga video incizimi i kamerave, edhe GPS-i shihet se Vetura Golf V ngjitet rrugës për tek shtëpia e A Ft, ne krye te rrugës kthehet dha lëshohet përsëri te poshtë dhe parkohen ne anën e djathte te rrugës përballe dyerve te oborrit tek shtëpia e Ait, shihet kur A zbret nga vetura dhe futet ne oborrin e shtëpisë se Ait ne ora 11:25:10 ku aty takohet me Ain dhe disa nga vëllezërit e Ait, ku me Ain qëndron deri ne ora 11:42:20 koha kur shihet duke dale nga oborri se bashku me te. Në ora 11:43:30 largohet i vetëm nga shtëpia e A Ft, *(e gjithë kjo vërtetohet nga aplikimi i masave të fshehtë me mjete të përcjelljes, dhe me video incizimi të kamerave të vëzhgimit si dhe me vëzhgim të dretjepërdrejtë të hetuesvetë rastit.)*

*Gjykata ka vërtetuar se prova nr.14 ka fuqi provuese të padiskutueshme meqë lëvizjet e lartshënura edhe janë inqizuar nga kamera edhe janë parë nga vëzhgimii hetuesve.*

Me datën 03.05.2019 nga ora 08:39:05 i akuzuari A S nga Kaqaniku shkon dhe ndalet tek shtëpia e **M.sht** ne rr. Kruja në F, ndërsa nga aty rreth orës 09:20 - 09:50 vjen në Prishtine;

Me datën 03.05.2019 prej orës 09:20 - 09:50, në Prishtine **A S** me veturën e tij ka shkuar rrugës afër shtëpisë se **A Ft**, ka qenë edhe vetura Golf V ngjyrë e hirtë targa 01-//// e te cilën e ka drejtuar A F, po ashtu edhe ajo është përcjell nga GPS me zë, nuk ka qenë e mundur te fotografohet ky veprim i At dhe Ait, për arsye se gjatë kohës së aplikimit të vëzhgimit ka qëndruar vetura Golf V ngjyra e hirtë e mbylltë me targa 01-492-FP pronë e P Ft vellai i A Ft i cili edhe ka drejtuar këtë veturë (**kundër vëzhgim**). Këtë fakt hetuesit e kishin kuptuar nga biseda midis Pt dhe Ait të cilët potencojnë targat e veturës së policisë që i vëzhgonte ata, duke i thënë Pi se “një veturë (ia citon targat) ka qenë duke iu përcjellë por nuk iu ka parë”, e krejt kjo pasi qe është larguar A, meqë Ai me An janë takuar shumë shkurt.

Me datën 12.05.2019 i akuzuari **A S** shkon ne Shkup, ku ne ora 12:32:26 kalon ne piken kufitare ne Elez Han ndërsa ne ora 13:17 mbërrin ne Shkup ne Rr. Bosnja e Hercegovina ne lagjen Butel.

Me datën 26.05.2019 rreth orës 10:00 i akuzuari **A S** ka shkuar përsëri tek shtëpia e **M.sht** ne F ku shihet edhe ne fotot e marra nga GPS i veturës.

Me datën 27.05.2019 rreth orës 18:17:44 shihet se ka qenë ne F, Nerodime dhe Shtime.

Me datë 31.05.2019 është ndaluar dhe është arrestuar përball Market “ELI ABI” në F, ku në veturë i janë gjetur dhjetë armë, etj.

*Nga provat e lartshënuara gjakta ka vërtetuar se i akuzuari A S është furnizuar me armë nga personi i cili ka ardhur nga Shkupi me emrin siç e thotë “Kema” e që në fakt është K.i dhe, ka bërë transportimin e armëve në destinacione të ndryshme. Për më shumë vërtetohet se i njëjti është njohur mirë me të akuzuarit M.sh dhe A F, madje e ka dijtur saktë ku të njëjtit banojnë, e ka dijtur se personi me shkurtesë emri “Mi.,” është M.sh dhe kështu iu kanë referuar gjatë komunikimit, Tek i njëti ka shkuar disa herë në shtëpi dhe kjo është konstatuar edhe nga fotot e marra nga GPS i vendosur në veturë të t’akuzuarit A nga i cili fotografim figuron adresa e shtëpisë së të akuzuarit Mim.*

**Nga Prova nr.15** dëshmohe se nga numri 044////-/// të cilin e ka përdorur i akuzuari M.sh, i njëjti ka shkëmbyer vazhdimisht thirrje me të akuzuarit A F, P F, A S por edhe me K.i nga Maqedonia.

*Nga kjo provë nuk mund të anashkalohe fakti tjetër shumë i rëndësishëm që vërteton njohjen dhe kontaktin e të akuzuarit M.sh me të akuzuarit A, A dhe vëllezërve të tij, konkretisht në listën e kontakteve në telefonin e të akuzuarit Mim ishin të regjistruar numrat e telefonëve të përdorur nga të akuzuarit A (044/////), P (044/////), A S (045/////), dhe K.i nga Maqedonia e Veriut (3897/////).*

- **Nga Prova nr.16** vërtetohet se A F është vëzhguar ashtu që me datë 16.04.2019 rreth orës 08:34 vërehet një veturë e tipit Golf 4 ngjyre e kaltër e mbylltë ose e zezë hyn në

brendësi te oborrit të t'akuzuarit A dhe pasi që mbyllin dyert e oborrit vërehet se i akuzuari A hap derën e bagazhit dhe nxjerr dy qese te zeza te cilat i mban ne te dy duart e tij dhe nga pozita e trupit dallohet se ato qese kanë peshë të rendë, Ai vazhdon me qese ne mes të dy shtëpive ku e shoqëron edhe personi i cili e drejton veturën Golf 4, më pas vërehet Ai me personin e pa identifikuar mashkull që qëndrojnë afër veturës Golf 4 dhe shihet se Ai numëron para te cilat i dorëzon tek ky person dhe i njëjti i fut ne xhep. Pasi që largohet vetura Golf 4, i akuzuari A merr ato dy qese dhe shihet se **hap një gropë ne oborrin e tij** ne ora 08:46:00- 08:48:00 ku i fut ato qese dhe i mbulon. Po ashtu rreth orës 19:19:30-19:22:00 i akuzuari A dhe vëllai i tij **Pi** vërehen se nxjerrin nga dheu vendi i njëjtë ato dy qese dhe i zhvendosin ë thellë në oborr ku nuk vërehet në video incizim, vërehet Pi që mban në dorë një sasi të madhe qesesh plastike (kemi te bëjmë me arme zjarri me te cilat furnizohet i akuzuari A dhe me pas i shet neper vende te ndryshme). Nga video incizimet vërehet se i akuzuari A dhe vëllai i tij **Pi** shkojnë herë pas here tek vendi ku kanë fshehur armët dhe menjëherë e kalojnë rrugën ku përballë kanë tjetrën shtëpi të familjes dhe aty vëllezërit e tyre Ai dhe Pi kanë një punëtori automekanike, me çka kuptohet që armët me gaz aty përpunohen dhe u modifikohet tyta për të përdorur municion të vërtetë.

Me datën 30.04.2019 rreth orës 11:24:00 i akuzuari A ka ardhur ne Prishtine dhe atë ka shkuar tek shtëpia e të akuzuarit A ne lagjen Kodra e Trimave. Gjithashtu edhe nga video incizimi i kamerave dhe GPS-i shihet se Vetura Golf V ngjitet rrugës për tek shtëpia e Ait, ne krye te rrugës kthehet dha lëshohet përsëri te poshtë dhe parkohen në anën e djathtë të rrugës përballë dyerve te oborrit tek shtëpia e Ait, shihet kur A zbrit nga vetura dhe futet ne oborrin e shtëpisë se Ait ne ora 11:25:10 ku aty takohet me Ain dhe disa nga vëllezërit e Ait, ku me Ain qëndron deri ne ora 11:42:20 koha kur shihet duke dale nga oborri se bashku me te. Në ora 11:43:30 largohet i vetëm nga shtëpia e A Ft,

**Nga Prova nr. 17** dëshmohen lëvizjet e të akuzuarit A me veturën Golf V dhe atë nga shfrytëzimi i mjeteve për përcjelljen e vendndodhjes-GPS me zë, dëshmohen edhe bisedat që i ka zhvilluar i njëjti me persona të tjerë brenda në veturë, ashtu që përfshirë edhe personat e akuzuar apo dëshmitar sipas kësaj aktakuze dhe jo vetëm, si N.M, R.M, M.sh, S.A etj, ndërsa lokacionet janë të ndryshme, ashtu që;

Me datën 14.02.2019, bisedat ne ora 23:13:16 dhe 23:21:36 dëgjohen Ai duke biseduar me NN personin e panjohur ku bëjnë biseda te ndryshme rreth veprimtarisë se tyre (*bisedat me nr. regjistri 215 dhe 216*).

Me datën 17.02.19 ne ora 21:32:19 dëgjohen Ai dhe NN personi i panjohur i cili ne fillim te bisedës e pyet: çfarë është kjo Ekol (arme me gaz) dhe vazhdojnë bisedën dhe shkojnë te **M ne F** dhe dyshohet se pas takimit marrin një armë në veturë. (*biseda me nr. regjistri 348*).

Me datën 19.02.2019 ne ora 22:26:28 dëgjohe NN personi i panjohur duke i thënë ë akuzuarit A “o bir ku me ja gjete një okfir qesaj alltisë (*biseda me nr. regjistri 484*).

Me date 26.02.2019 ne ora 11:39:07 i akuzuari A bisedon me NN personin e panjohur dhe i thotë: “hajt ka shpija jam, NN: ama një çmim tjetër, Ai: jo ska çmim tjetër valla, NN: e ajo 15-tsha, Ai: 15-tshen e ki 300 euro (*biseda me nr. regjistri 771*);

Me datën 03.03.2019 nga ora 20:28:33 GPS ka regjistruar se vetura e A Ft ka qene në F te **M.sh** dhe te N.M në ora 21:16:35.

Me datën 06.03.2019 GPS ka regjistruar se vetura e A Ft ka qene ne ora 19:10:33 në fsh. S te R.M, ne ora **19:59:32 te M.sh te lokali (K ) F**, në ora 21:25:07 tek familja J (Nexhat J ,Urime J) ne Viti.

Me datën 12.03.2019 ne ora 12:58:30 i akuzuari A dëgjohe duke biseduar ne telefon, dhe ne baze te ziles se tel. vërehet se e përdorë aplikacionin VIBER. (*biseda me nr. regjistri 511*).

Me datën 12.03.2019 ne ora 19:05:02 ne Gjilan të akuzuarit Ai se bashku me Mn takohen me personin S N tek Marketi “DRINI” ka edhe video –Incizim, *biseda me nr. regjistri 1515*, dëgjohen bisedat ne mes te Ait dhe Mt brenda veturës duke biseduar me S Nn, dëgjohe M duke i thënë “që i ki paret mere se a po tutesh qe nuk pe shet a” pastaj dëgjohe duke numëruar para ku numërojnë deri ne 18 dy herë. Personi S N i thotë se a mundesh me ma be një qasi nëntëshe, Ai i thotë qe jo dhe i thotë qe vjen M pas dy tri dite, M i thotë Sit se kur te ma cingërosh ti unë vij pa ma cingëruar nuk vij.

Me datën 13.03.201 në ora 22:48:22 sipas pajisjes se pozicionimit Ai dhe NN personi i panjohur kanë shkuar ne fshatin Guriq tek shtëpia e N.Mt, qëndrojnë një kohë në oborrin e tij e pastaj dyshohet se kanë dërguar armë, në ora 22:48:28 dëgjohet N duke i thënë Ait qysh u met ky njeri qe sigurisht 5-60 mijë euro ka punua me ty, Ai i thotë: **jo ma shume** (biseda me nr. regjistri 1569).

Me datën 14.03.2019 ne ora 17:34:58, ne fund te bisedës dëgjohet njëri prej vëllezërve F qe përmend “Gipes a”, ku dyshohet se behet fjalë për R.Mn (biseda me nr. regjistri 1599).

Me datën 21.03.2019 ne ora 22:03:01 GPS ka regjistruar se vetura e A Ft ka qene tek shtëpia e R.Mt ne fsh. S.

Me datë 12.04.2019 në ora 13:50:47 M shkon te shtëpia te S.A në fshatin Gumnasellë e merr atë në veturë dhe së bashku shkojnë dhe përmendin edhe **Mn** që merret me veprimtari të njëjtë, bisedojnë për lloje të pistoletave dhe për çmimet, biseda vazhdon edhe në regjistrin 3222,3223,3224,3225 deri rreth orës 14:3100 ku lokacioni i tyre i ndaljes ishte tek **lokali i M.sht** i quajtur “K” në F në rrugën “2Korriku” pasi janë larguar nga M kanë shkuar në fshatin Cërnillë tek shtëpia e Beratit në ora 14:46:30.

- Me date 03.05.2019 nga ora 10:26:08 **P F** bisedon me **A Fn**, ku Pi i thotë: sot duhet me shku gjithqysh ne Kaçanik, kurse Ai i thotë: **nale “Kemes thuj mos bir njëherë, Pi i thotë edhe sbon këtu me të ardhë te shpija edhe këtij të Ss o mire mi thane mos um hajde ne shpi”, bisedojnë edhe për A Sopen qe e kanë vërejtur se është përcjelle nga ana e policisë dhe Pi i thotë: ata e dine nëse e shohin në këtë rrethinë se ku lidhet ai, bisedojnë edhe për hetimet e policisë ku thonë mos e kanë përfundimin se qe tre muaj i kanë bo prej janarit, Pi thot: ti hjekum senet (armet) se tash e kanë përfundimtare, poshtë na qojnë, busullën na e hupin, po ashtu kuptohet se bisedojnë për telefona se si duhet te ruhen edhe me mire qe te mos i përdorin hiq, Ai i thotë: du me marre një telefon tjetër, Pi i thotë: po te përcjellin me vale se kur të lëshohen ata ruju, me nal pak veprimtarinë, një dite e qon një, një dite e qon me motor tash vera gat është, thuj njërit prej ndërmjetësuesve qe të mos folë në telefon se ki me ra, senet mi hjek krejt edhe paret po ja dha Les (gruas se tij-Pit) le ti deponon ose le tja jep babës së saj, se po me dhimesh ti me bo me ra, hec kah Shqipnija nja 5-6 dite, shëtite krejt Shqipnin. (biseda me nr. regjistri 3963 dhe 3964).**

- Me datën 05.05.2019 ne ora 15:10:52 deri ne ora 15:40:00 M me veturën e Golf V ka shkuar tek personi S.A ne fshatin Gumnaselle me qellim te shitblerjes se armeve.

*Raportit i janë të bashkangjitura fotot nga vendosja e sistemit të vëzhgimit me GPS me zë në veturën Golf të t'akuzuarit A F në bazë të urdhëresës së gjykatës UGJK nr.95/18 dhe komunikimet janë nxjerrë nga CD e bashkangjitura me të dhënat sipas datave të lartshënuara.*

**Nga Prova nr.18** dëshmohen lëvizjet e të akuzuarit A me veturën Golf VI ngjyrë e kaltër dhe atë nga shfrytëzimi i mjeteve për përcjelljen e vendndodhjes-GPS dëshmohet se i njëjti me datë 30.04.2019 rreth orës 11:24:00 takohet me A S (takimi mes tyre është i përshkruar tek i akuzuari A S);

Me datën 03.05.2019 prej orës 09:20 - 09:50 në Prishtinë A S me veturën e tij ka shkuar rrugës afër shtëpisë se A Ft janë takuar shkurt, P F ka qenë kundërvëzhgim (siç përshkruhet më lartë tek i akuzuari A S);

Me datën 18.04.2019 i akuzuari A gjatë rrugës nga P ka shkuar ne Kjeve dhe është takuar me të akuzuarin N.M ne ora 19:50:35 dhe pasi qe është kthyer në drejtim të Ps në ora 20:50:33 është ndaluar ne shtëpinë e R.Mt ne fshatin Sllatine.

Me datë 18.04.2019 në ora 19:50:35 i akuzuari A me veturën Golf VI nga P shkon në Kijevë takohet me N.Mn, gjatë kthimit për në P është ndalur në shtëpinë e R.Mt në fshatin S.

Me datën 19.04.2019 rreth orës 17:00 i akuzuari A nga P ka shkuar ne F tek lokali i **M.sht** ne rr. “2 Korriku” dhe nga aty ka shkuar tek shtëpia e Mt ne rr. “Kruja” ne F ne ora 17:06:45 nga F, është kthyer ne Prishtinë ne ora 21:59:18 ka qenë në shtëpinë e tij ne Lagjen Kodra e Trimave dhe nga aty ne ora 22:38:33 ka shkuar tek shtëpia e R.Mt ne S dhe nga aty ka shkuar ne fshatin Goriq tek shtëpia e Nuhi Mazrekut ne ora 23:15:35.

Me datën 20.04.2019 në ora 18:30:10 ka shkuar ne Kijevë, e po ashtu edhe me datën 22.04.2019 ne ora 20:38:03 shihet ne lokacionin e njëjtë.

Me datë 26.04.2019 dhe 27.04.2019 i akuzuari A me veturën Golf VI shihet në afërsi të shtëpisë së **M.sht.**

Me datën 01.05.2019 ne ora 21:33:31 i akuzuari A ka shkuar ne shtëpinë e N.Mt në fshatin Goriq.

Me datë 04.05.2019 deri më 10.05.2019 i akuzuari A frekuenton fshatin Goriç dhe Vermicë të Malishevës si dhe Fin, me datë 07.05.2019 në ora 23:00:57 takohet me N.Mn në fshatin Goriq të Malishevës, ndërsa me datë 08.05.2019 ne ora 22:07:55 dhe 09.05.2019 ne ora 21:27:57 është ndalur në një shtëpi në rr.Hasan P në Viti dhe me datë 10.05.2019 shkon në fshatin Vermice të Malishevës

Me datën 12.05.2019 rreth orës 21:50:26 i akuzuari A, poashtu me datë 14.05.2019 ne ora 22:39:37 si dhe me datë 16.05.2019 ne ora 21:57:59 ka shkuar në fshatin Goriq Malishevë.

Me datën 15.05.2019 ne ora 21:39:01 i akuzuari A ka shkuar dhe është ndaluar tek shtëpia e M.sht ne Rr. Kruja (kjo rrugë nuk është e shkruar ne hartë).

Me datën 22.05.2019, gjate rrugës nga P ne drejtim te Malishevës, rreth orës 22:28:42 është ndaluar ne shtëpinë e R.Mt ne fshatin S dhe është takuar me të, ku ka qëndruar rreth 10 minuta, ndërsa nga aty ka vazhduar për ne fshatin Goriq të Malishevës në ora 23:01:41.

Me datën 23.05.2019 në ora 21:41:08, ka shkuar **tek shtëpia e M.sht ne Rr.Kruja F**, ndërsa nga aty ne ora 22:25:78 ka shkuar tek shtëpia e familjes së Nexhat Jt, Rr. Tirana-Viti.

Me datën 24.05.2019 ne ora 21:28:41 ka shkuar tek shtëpia e R.Mt ne fsh. Sllatine-Fushe Kosove dhe nga aty ne ora 22:17:59 ka shkuar tek Restorant “Liburnia”-Kaqanik, në të cilin si menagjer i këtij restoranti është A S, ai nuk ka hyr brenda në restorant por ka qëndruar ne veturën e tij në një pjesë të errët të parkingut dhe është takuar me disa persona (fotografimi nuk ka qenë i mundur).



Me datë 26.05.2019 në ora 22:57:42 ka shkuar tek shtëpia e N.Mt në fshatin Goriq – Malishevë, sërish me datë 30.05.2019ka shkuar tek i akuzuari Nuhi dhe pastaj së bashku an shkaur në Pejë në fshatin Nabërgjan,

Me datën 27.05.2019 rreth orës 18:17:44 shihet ka qenë ne F, Nerodime dhe Shtime.

Me datën 11.06.2019 nga ora 21:35 i akuzuari A me veturën Golf VI nga Kodra e Trimave në P është nisur ne drejtim te fshatit Sllatin dhe është ndaluar ne ora 21:49 tek R.M, ku ka qëndruar për rreth 5 minuta, pastaj ka shkuar ne Drenas tek pompa e derivate Shell ne hyrje te Drenasit, ka qëndruar pak dhe përsëri është kthyer tek Ragipi ne S ku ka qëndruar për rreth 30 minuta.

*Nga të tëra lëvizjet e lartpërshkruara të t'akuzuarit A gjykata ka vërtetuar se i njëjti në vazhdimësi është i angazhuar lidhur me shitblejen e armëve dhe të tëra këto lëvizje janë rezultat nga aplikimi i pajisjes së vëzhimit dhe përcjelljes me GPS si dhe përcjelljes në teren nga ana e hetuesve. I njëjti shieht se disa herë shkon tek shtëpia e të akuzuarit M.sht në F dhe ky fakt bashkë edhe me kontaktet telefonike që ata i kanë patur janë arsye e fortë për të besuar se të njëjtit janë njohur dhe kanë bashkëpunuar në furnizimin me armë me qëllim të blerjes dhe shitjes.*

**Nga Prova nr. 19** dëshmohe se i akuzuari **P F** gjatë periudhës kohore 20.02.2019-21.04.2019 ka përdorur numrin e tel **049/639-990**, ashtu që me datë 03.04.2019 ne ora 19:07:06 Pi kontakton me NN personin e panjohur në numrin tel.043///// (abonent është H.m fsh. Prelez i Jerlive- F), te dy merren vesh mes vete qe te takohen ditën e premte para orës njëmbëdhjetë ne një lokal te cilit emrin nuk ja përmendin.

Me datën 13.04.2019 ne ora 17:21:17 NN personi i panjohur bisedon me Pin Transkripti: “NN: ai shkoku më tha ta pijmë nga një kafe, Pi: sikur at dit a po, NN: sikur atë dit edhe një makiato ma te madhe, Pi: ani pra nesër unë dal, NN: dy kafe i bjen pra, Pi:hajt u kry”

*Nga këto transkripte bisedash gjakta vërteton se i akuzuari P me bashkëbiseduesin flasin me kode, duke iu shmangur fjalës armë përmendin fjalën kafe makiato ma të mëdha për ta sjellur në vendtakim.*

Me datë 04.03.2019 në ora 21:57:27 i akuzuari P bisedon edhe me personin D Mjeku në numrin e tel.044////, Transkripti “Di: “duhet me ardhë te ti skam qare”, me datë 16.03.2019 në ora 22:23:50 Transkripti: “Di:aty poshtë të pres veq qashtu qysh tkallzova”. Në shkresa të lëndës ekziston edhe Raporti i dt.23.01.2019, sipas të cilit me datë 03.01.2019 Pi dhe Di nga numra të njëjtë të telefonit bashkëbisedojnë, Di i kërkon diçka siç thotë “të njëjtë sikur kjo”, Pi i thotë hajt se po vij dhe e lënë takimin në orët e mbrëmjes në Obiliq. Kjo dëshmon se të njëjtji njihen edhe më parë.

**Nga Prova nr.20** dëshmohet prë lëvizjen e të akuzuarve A e P F të inqizuara me video në vende publike gjatë periudhës kohore 08.02.2019-10.04.2019.

Me datë 05.03.2019 ne ora 20:48 i akuzuari P F së bashku me Ain shkojnë me veturën e tipit Gollf V me targa 01-492-FP dhe ndalen ne fshatin Kijeve ne Llozice përballë restorant Mendi, ku nga vetura del A F dhe i njëjti shkon ne parking te restorantit dhe takohet me N.Mn dhe hyjnë ne veturën e tij te tipit Golf IV me targa 07-158-CT dhe pasi qëndrojnë aty A F del nga vetura dhe pret ne rruge ku pastaj vjen P F me veturën e tij, e merr te njëjtin dhe se bashku vazhdojnë ne drejtim te Ps .

**Nga Prova nr. 21** dëshmohet se me anë të GPS është vërejtur se i akuzuari A me veturën Golf V ngjyrë hiri, ka vizituar të akuzuarit tjerë, N.Mn në fshatin Goriq të Malishevës dhe R.Mn në S, ka shkuar **tek M.sh në F**, pastaj në Kaqanik, në Viti, gjatë qëndrimit në veturë ka biseduar me persona të tjerë, ku në një rast ka përmendur armen si Ecol dhe në një rast tjetër 15-she.

**Nga Prova nr.22** dëshmohte se i akuzuari A ka komunikuar me shumë numra, e në mesin e tyre janë edhe numrat e të akuzuarve: **M.sh**, P M. Po ashtu në bazë të hartografisë vërehet se ka vizituar qytetet: Prizren, Viti, Gjilan, F, Podujevë etj.

**Nga Prova nr.23** dëshmohet se i akuzuari A gjatë periudhës kohore 10.12.2018 - 08.01.2019 ka bërë lëvizje të shumta me veturën Golf V me targë regjistrimi 01-////në vende të ndryshme të Kosovës, si raste të dyshuara vlen të cekem datat: 27, 28,29,30 dhjetor 2018, si dhe 08.01.2019, kur i akuzuari A shetitet brenda ditës nëpër disa qytete e fshatra të Kosovës dhe vazhdimisht takohet shkurt me njerëz të ndryshëm, disa i merr në veturë në

vend të caktuar i zbret në një vend tjetër, andaj gjitha këto takime dyshohet se janë bërë me qëllim të shitblerjes së armëve.

**Nga Prova nr.24** dëshmohet se gjatë periudhës kohore 18.12.2018 -16.01.2019 i akuzuari A Raport nga numri tel 045/677-727 komunikon me personin Besim Hasani në numrin tel 044/808-111 me datat 27 dhe 28.12. 2019, flasin në mes vete dhe mundohen të caktojnë një takim, po ashtu në bisedën e datës 28.12.2018 në ora 12:45:18 Besimi i thotë Ait se i ka marrë ato haletet krejt 3000 euro, e Ai i pergjigjet: hajt hajt se nuk po dihet mirë për hajër koft. Me datë 02.02.2019 në ora 11:36:22 merren vesh që Besimi të shkoj tek Ai dhe të takohen.

**Nga Prova nr.25** dëshmohet se janë bërë disa bastisje në pronat e të akuzuarve si më poshtë:

**M.sh**, bastisja me datë 24.07.2019, në shtëpinë e të akuzuarit M.sh me adresë banimi në rr.”Kruja” nr.28 në F, si dhe në lokalin-kafiterinë “K” në rrugën “Kemail Hetemi” që lidhë me rrugën “2 Korriku “ në F pronë e të akuzuarit Mim.

Bastisja është kryer pa vërejtje në të dy lokacionet dhe nuk është gjetur diqka e dyshuar përveç se, nga i akuzuari është sekuestruar: një telefon Samsung Imei 353605/05/767438/3 me sim kartel me numër 044-///-///,

**A F**, bastisja me datë 24.07.2019 në rrugën “S Luarasi” nr.19 në P, Bastisja është kryer pa vërejtje dhe nga i akuzuari A janë sekuestruar: **25 armë (5 janë revole Ecol Jackl Duala, 20 janë revole Zoraki M-///), veturë “Golf V me targa regjistrimi 01-///-ET, dhe veturë Golf VI me targa regjistrim 01-///-MM , 4 telefon (2 të tipit Iphone dhe 2 të tipit Nokia) (në vendlokacion kanë qenë të pranishëm të akuzuarit Ai, Pi dhe M F),**

**A F**, bastisja me datë 24.07.2019 në rrugën “S Luarasi” nr.19 në P, Bastisja është kryer pa vërejtje dhe nga i akuzuari A janë sekuestruar: mbi 100 fishek të kalibrave të ndryshëm, 10 tyta të modifikuara të improvizuara, dhe 2 herë nga 39 të tjera tyta të modifikuara, për armë të shkurta, 17 burgia për modifikim të tytave, brusha për pastrim të armëve, goditëse metali me numra, pjesë metali për armë, mjete pune etj, siç janë të precizuara në Vërtetimin për sekuestrim të përkohshëm të sendeve të datës 24.07.2019, sende këto të gjetura në garazhe dhe të nënshkruara pa vërejtje nga i akuzuari A F.

Sa i përket ligjshmërisë së provave materiale të paraqitura në aktakuzë për të dy periudhat inkriminuese, të njëjtat nuk janë kontestuar nga mbrojtësit, si të tilla kanë bazë ligjore, janë të nxjerrura në procedurë hetimore bazuar në urdhëra të ligjshëm të gjykatës kompetente për masa të fshehta, janë përmbledhur në raportet e personave zyrtar të autorizuar të policisë me transkripte të bisedave, nga vëzhgim i drejtprëdrejtë, apo inqizimi me kamera, rrjedhimisht të njëjtat gjykata i konsideroi si prova të sakta, të besueshme, të pranueshme, me fuqi të madhe provuese, në përputhshmëri njëra me tjetrën, andaj ua fali besimin e plotë dhe mbi bazën e të njëjtava e mbështeti aktgjykimin.

#### 7. Vlerësimi i pretendimeve të mbrojtësve të t'akuzuarve

Gjykata ka vlerësuar dhe analizuar edhe pretendimet e mbrojtësve të t'akuzuarve, ashtu që sa i përket pretendimit të përbashkët të të gjithë mbrojtësve se, gjatë shqyrtimit gjyqësor nuk është arritur të provohet se tek të akuzuarit janë konstatuar veprime inkriminuese në të cilat do të përmbusheshin elementet e veprës penale të krimit të organizuar, gjykata e akceptoi si të bazuar dhe e vlerësoi të drejtë, kjo ngase vërtetoi se të akuzuarit nuk vepruan si anëtar të grupit kriminal, me strukturë të qëndrueshme, nuk u vërtetua dijenia e të akuzuarve për veprimatrinë e grupit, për ekzistimin e trajtës së krimit të organizuar, ndonëse veprimet e të akuzuarve janë ndërmarrë me qëllim të realizimit të përfitimeve materiale. andaj edhe bëri ricilësimin e veprës penale si në pjesën hyrëse të këtij aktgjykimi (*sqarimi më i detajishëm për krim të organizuar do të konstatohet më poshtë*), ndërsa të tjera pretendimet i vlerësoi të pa baza, të qëndrueshme dhe tendencioze me qëllim të zvogëlimit të përgjegjësisë së të mbrojturve të tyre, ngase të gjitha faktet e provat e kontestuara nga mbrojtësit, gjykata i ka vlerësuar në ndërlidhje me njëra tjetrën.

Më poshtë jepen përgjigjet e gjykatës lidhur me pretendimet tjera të ngritura nga mbrojtësit.

Pretendimin e mbrojtësit të t'akuzuarit A F, av. Imer Beka se armët nuk janë modifikuar, nuk janë shitur, apo se në përgjime ligjore nuk është përmend tregtimi me armë, gjykata e vlerësoi tërësisht të pabazuar, ngase provat shkencore nga laboratorit AKF kanë saktësuar se cilat armë të konfiskuara janë modifikuar e cilat jo, pastaj vetë fakti se ato armë të transportuara të gjetura në veturën “Golf 2” të t'akuzuarit A, apo në pronë të tij familjare

qoftë në vitin 2013 apo në vitin 2019, janë blerë me qëllim shitjeje, ashtu që sipas provave të administruara, përkatësisht nga përgjimet telefonike shihet se shumë njerëz kanë blerë armë personalisht nga i akuzuari A, nga të cilat vërtetohet se i njëjti jo vetëm që ka blerë armë është furnizuar, ka transportuar edhe ka shitur të tjerëve dhe, e tëra kjo përbën tregtimin me armë.

Pretendimin e mbrojtësit të t'akuzuarit A S av. Valdrin Behrami, që ndaj të mbrojturit të tij gjykata të bëjë ricilësim të veprës penale sipas aktakuzës në veprë penale të armëbajtjes, gjykata asesi nuk e pranoi, i mbrojturi i tij është përgjuar e vëzhguar dhe ditën kritike pasi është furnizuar me armë, është kapur duke transportuar armët dhe duke i dërguar në destinacionin e caktuar me qëllim shitjeje dhe atë dhjetë armë me gas. Rrjedhimisht nuk ka të bëjë me veprëj të sosh.

Pretendimin e mbrojtësit të t'akuzuarit P F av. Ali Beka se përgjimet ligjore nuk kanë mbështetje në ndonjë bazë tjetër ligjore, gjykata e vlerësoi poashtu të pabazë, meqë përveç përgjimeve ligjore, gjykata ka administruar edhe prova të tjera të konstatuara, që dalin nga vendosja e GPS me zë për përcjlljen e veturave të t'akuzuarve, pastaj janë bërë edhe vëzhgimet e drejtpërdrejta nga ana e hetuesve policor, inqizimet me kamera në vendbanimin e të akuzuarve F, janë bërë bastisje dhe janë kapur numër i konsideruar i armëve të cilat janë ekzaminuar, andaj asesi nuk mund të mbesin nën pragun e supozimeve. Pretendimin e mbrojtësit të t'akuzuarit A F av. Osman Havolli se, nuk mund të ketë përgjegjësi kolektive ngase siç përshkruhet në aktakuzë të gjithë kanë sjellë armë, se nuk ka individualizim të veprimeve të t'akuzuarve, gjykata e konsideroi të paqëndrueshëm, ngase vërtetë nuk ka përgjegjësi kolektive, mirëpo në aktakuzë janë të përshkruara veprimet e secilit të akuzuar, përderisa vet përshkrimi ligjor i veprës penale nga neni 364 të KPRK përfshinë Importin e furnizimin, e transportimin ose shitejen e paautorizuar të armëve, ndërsa nga provat e shumta të admisnitruara, është vërtetuar se cili nga të akuzuarit është angazhuar për sjelljen e armëve nga Maqedonia, cili i ka transportuar, kush është angazhuar për vendosjen apo largimin e armëve qoftë në shtëpitë brenda oborrit të vëllezërve F apo edhe në shtëpi të t'akuzuarit D F, cili është marrur me me modifikimin e armëve si dhe me shitjen e tyre. Me këtë shpjegim refuzohet edhe pretendimi tjetër se armët e groposuar janë gjetur 110 m larg shtëpisë, e rëndësishme është se gjithë vëllezërit kanë qenë në dijeni se ku ka qenë armët e grposura, siç thotë Ai “aty ku nan qet flija” e kjo është në brendi të oborrit të familjes F. Ndërsa për pretendimin për funksionalitetin e armëve është bërë ekspertiza balistike e armëve, krahasimi i armëve etj, sipas metodave shkencore të AKF, cialt janë modifikuar e cilat jo, janë krahasaur armët, kishte armë të zjarrit, armë

me gas, të modifikuara dhe ende të pamodifikuara, ndërsa për faktin se nuk është provuar se të kujt janë armët, gjykata ka konstatuar kur dhe në çfarë vendi janë gjetur armët dhe pjesët, veglat apo pajisjet tjera për prodhimin e tyre

Pretendimin e mbrojtësit të t'akuzuarit P F av. Osman M se masat e fshehta janë të pavërtetuar me prova të tjera, gjykata e konsideroi të pabazuar, ngase janë administruar edhe prova të tjera dhe të njëjtat nuk janë kundërshtuar në asnjë fazë të procedurës, ndërsa sa i përket pretendimit se nga i akuzuari P nuk është konfiskuar asgjë, gjykata e besoi ngase i njëjti ditën e bastisjes nga policia në pronat e familjes F me 23.11.2013 nuk ka qenë në shtëpi sikur që nuk ka qenë as i akuzuari A, mirëpo ky fakt nuk e arsyeton pafajsinë e tij sa i përket kryerjes së veprës penale në vitin 2013.

Pretendimin e mbrojtëses së të akuzuarit M.sh, av.Kosovare Kelmendi se, i mbrojturi i tij nuk është marrë me furnizim me armë me gas nga i pandehuri K.i, gjykata e konsideroi jo të qëndrueshëm, ngase ekziston prova përkatësisht dëshmia e dëshmitarit S.A i cili në kafene të t'akuzuarit Mim derisa po tentonte t'ia shes një armë (*që ia kishte sjellë i akuzuari M F për shitje me përqindje*), i akuzuari Mim ia kishte thënë në sy, se është duke i pritur disa armë me gas. Se kjo thënie e dëshmitarit ishte e vërtetë, e dëshmon edhe biseda telefonike që i akuzuari Mim e kishte zhvilluar me të akuzuarin A dhe me të pandehurin K.i nga telefoni i At 045/////me dt. 09.04.2019 në ora 07:52<sup>50</sup>, si dhe biseda telefonike që kishte zhvilluar i akuzuari A me të pandehurin K.i me datë 30.05.2019 vetëm një ditë përpara se i akuzuari A të kapej nga policia, i pandehuri K.i i kishte treguar edhe kohën kur duhej të nesërmen të shkojë A te “Mi.” dhe t'i jap diqka e ti merr diqka etj, ashtu që i akuzuari A të nesërmen në hyrje të Fit te “Eli Abi” ishte ishte kapur nga policia duke transportuar armë me gas. Gjukata nuk e akceptoi poashtu as pretendimin se i mbrojturi i saj nuk ka patur kontakte me të akuzuarit tjerë, përderisa vetëm i akuzuari A disa herë ka shkuar tek shtëpia e të akuzuarit Mim apo e ka kontaktuar në telefon, numri i telefonit të Mt ka qenë i regjistruar në telefonët e të akuzuarve F, përndryshe për të akuzuarin Mim si person i arsimuar, i pjekur në moshë, është normale që ai në biseda me vëllezërit F apo të tjerët të jenë më të kujdesshëm dhe t'i shmangen përdorimit të termeve armë e municion, aq më shumë kur të akuzuarit F veç e kishin një proces gjyqësor të papërfunduar për armët. Përderisa me asnjë provë nuk vërtetohet lidhja midis të akuzuarit Mim dhe të akuzuarve F nga P, e A S nga Kaqaaniku qoftë si familjarë, shokë gjenerate apo qfarëdo miqësie tjetër,

<sup>50</sup> I pandehuri K.I., me këtë datë dhe në këtë kohë bisedon me Mn dhe i thotë se duhet të takohen menjëherë tek vendi, kurse M i thotë se “po është herët ende nuk është qel aty”, pastaj K.I., i thotë po vij pra tek ti, M i thotë “hajde veç të bëhem gati se kesh duke fjetë”,

mjaftueshëm arsyetohet qëllimi i kontakteve midis tyre për furnizim me armë me qëllim të shitjes dhe realizimit të përfitimit material. Për numrin e telefonit të t'akuzuarit Mim 044 ///-/// gjykata tashmë ka dhënë shpjegimin. Fakt tjetër tanimë i arsyetuar është edhe fakti për adresë të shtëpisë në rrugën “Kruja” dhe të lokalit në rrugën “Kemajl Hetemi”, ngase sipas fotografive nga vendosja e GPS vërtetohet vend ndodhja e lokalit në udhëkryqin e rrugëve ku evidentohet edhe rruga “Kemajl Hetemi”. Sa i përket pretendimit se lokalin e M.sht e kanë përmendur si pikë orientuese e jo si vendtakim për veprimtari ilegale, gjykata e kosdieron jo të saktë, për faktin se bashkëbiseduesit apo vizitorët me dije kanë shkuar drejtë në vend ku e kanë dijtur se do ta takojnë të akuzuarin Mim, andaj edhe iu kanë referuar “te M” apo “te lokali Milës”, andaj asnjë lloj interpretimi i hetuesve policor nuk ka arsye të konsiderohet i gabuar. Poashtu nuk qëndron as fakti se të akuzuarin Mim e kanë motivuar apo “joshur” për kontrabandim të armëve, meqë i njëjti nuk ishte i mitur, nuk ishte imponuar, por tërësisht i vetdijshëm për veprimet e veta.

Pretendimin e mbrojtëses së të akuzuarit D F av.Shemsije Sheholli se sipas Gjykatës Evropiane për të drejtat e njeriut përgjimet e telekomunikimeve mund të shërbejnë vetëm në rastet kur kanë të bëjnë me siguri nacionale, gjykata e vlerësoi si interpretim jo të saktë dhe jo të plotë, ngase sipas nenit 8 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut<sup>51</sup> ndërhyrja e autoritetit publik në ushtrimin e të drejtës për respektim të jetës private dhe familjare, banesës dhe korrespondencës, mund të bëhet edhe për mbrojtjen e rendit publik i cili në këtë rast ka mund të rrezikohej nga futja arbitrare dhe e pakontrolluar e armëve dhe përdorimi i tyre ielgal paraqesin rrezik për jetë njerzish, rrjedhimisht çënojnë sigurinë e qytetarëve dhe stabilitetin e vendit.

Pretendimet e të akuzuarit Xh.Sav.M N., se nuk ka përgjime telefonike midis të akuzuarve me rastin e pranimit të armëve nga të akuzuarit A dhe D F në Maqedoninë Veriore, tansportimin e tyre nga Maqedonia Veriore për në Kosovë dhe dorëzimin e tyre në Kosovë, gjykata e konsideron si tërësisht të paqëlluar ngase të njëjtave përgjime tanimë i është referuar, poashtu edhe vet i akuzuari ka përshkruar mënyrën e dorëzimit të armëve të akuzuarve A dhe D F tek restorant “Alba” në Han të Elezit, e që fundja ka rezultuar se

---

<sup>51</sup> Neni 8 i KEDNJ i datës 1 Nëntor 1998: *E drejta për respektimin e jetës private dhe familjare*

1. Çdokush ka të drejtën e respektimit të jetës së tij private dhe familjare, banesës dhe korrespondencës së tij.  
2. Autoriteti publik nuk mund të ndërhyjë në ushtrimin e kësaj të drejte, përveçse në shkallën e parashikuar nga ligji dhe kur është nevojshme në një shoqëri demokratike, në interes të sigurisë publike, për mbrojtjen e rendit publik, shëndetit ose moralit ose për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të tjerëve.

vërtetë janë dorëzuar dhe vendosur në veturën “Golf 2” të t’akuzuarit A meqë edhe janë kapur nga policia. Poashtu gjykata nuk e akceptoi konstatimin e mbrojtjes se i mbrojturi i tij nuk dyshohet për vepra të tjera, përderisa i njëjti gjatë tërë procesit gjyqësor ka qenë në vuajtje të dënimit për vepër tjetër penale.

Pretendimin e mbrojtësit të t’akuzuarit K.S av. Qëndrim Reçica se nuk ka prova se i njëjti ka blerë armë, ndërsa gjatë fazës së hetimeve i mbrojturi i tij kishte deklaruar se 2-3 herë ka blerë armë me gas për nevoja të tija personale, pasi që ka qenë i angazhuar në lokale të natës si këngëtar, dhe se ato armë nuk paraqesin armë zjarri, gjykata gjithashtu e konsideron të pabazuar, meqë blerja disa herë armë dhe municion nga i akuzuari A nuk arsyeton aspak faktin se të njëjtat i ka blerë për vete, ngase si roje e natës nuk ka patur të luftojë, ka mund të ketë një armë me leje e jo më shumë, për më tepër gjykata e vlerësoi të pabazë edhe pretendimin se armët me gas nuk janë të vërteta, ngase edhe armët e tilla janë të përfshira me dispozita të ligjit të aplikueshëm, Ligjit për armë 05/L-022 si armë, kanë cilësinë e armës dhe mbajtja apo përdorimi i tyre është i ndëshkueshëm.

#### **8. Gjetjet e gjykatës për fajsinë e të akuzuarve**

Fillimisht gjykata gjatë gjithë procesit gjyqësor është përkujdesur në respektimin e nenit 5 të KPRK që ka të bëjë me një gjykim të drejtë, të paanshëm të zbatuar me përkujdesje të veçantë që të mos ketë absolutisht zvarritje të procedurës dhe që të pengohet çdo keqpërdorim i të drejtave të të gjitha palëve që janë pjesë e procedurës.

Prokurorja në fjalën përfundimtare ka bërë precizimin e aktakuzës duke i përfshirë të gjitha veprimet inkriminuese të t’akuzuarve në një dispozitiv me dy pika, ku njëra përfshinë periudhën kohore nga fillimi i vitit 2013 dhe tjetra periudhën e vitit 2018-2019, ndërsa gjykata ka vlerësuar se ato veprime nuk paraqesin ndonjë ndryshim substancial të veprimeve të t’akuzuarve dhe për ato veprime ishin administruar të gjitha provat e prezantuara nga prokuroja, të selektuara nga aktakuza fillestare<sup>52</sup>, ndërsa prova tërësisht të reja nuk pati.

---

<sup>52</sup> Prokurorja ka larguar nga aktakuza bazë provat të cilat nuk janë të ndërlidhura me të akuzuarit që janë objekt i shqyrtimit gjyqësor (në kohën derisa edhe i akuzuari M F ishte pjesë e gjykimin të çështjes), poashtu ka larguar edhe provat që janë shpallur të papranueshme



Nga provat e lartshënuara të administruara, të ndërlidhura njëra me tjetrën vërtetohet se gjithë të akuzuarit me veprime të tyre inkriminuese kanë dhënë kontribut thelbësor në kryerjen e veprës penale Importi, eksporti, furnizimi, transportimi, prodhimi, këmbimi, ndërmjetësimi ose shitja e pa autorizuar e armëve nga neni 364 par. 2 lidhur me nenin 31 të KPRK. Pra, gjykata ka vërtetuar se të akuzuarit ***në bashkryerje*** kanë kryer këtë vepër penale të përshkruar si në pikët I dhe II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, duke qenë se janë vëllezër janë marrë vesh lehtësisht në sigurimin, importimin, blerjen transportimin, prodhimin si dhe shitjen e armëve e municionit se kujt, ku, sa dhe me çfarë çm duhet shitur armët dhe ka vërtetuar lidhshmërinë e veprimeve të t'akuzuarve të cilat paraqiten ***në vazhdimësi*** gjatë dy periudhave kohore. Është e rëndësishme se është përmbushur edhe elementi subjektiv, që konsiston në faktin se të akuzuarit kanë qenë të vetëdijshëm dhe e kanë dëshiruar kryerjen e veprës penale, kanë vepruar së bashku me mirëbesim, duke kontribuar thelbësisht secili në mënyrën e vet, për sigurimin e armëve, për transportin dhe shitjen e armëve për qëllime përfitimi material e që ka qenë qëllimi i tyre i përbashkët.

Rrjedhimisht, gjykata nga provat e administruara ka vërtetuar se në rastin konkret ka ekzistuar lidhja objektive, që konsiston në veprimet e të akuzuarve të cilat kanë qenë të lidhura mes vete dhe të drejtuara me qëllim të arritjes së rezultatit të njëjtë përkatësisht të pasojës së ndaluar, andaj të njëjtit i ka shpallur fajtor, gjatë nxjerrjes së vendimit për llojin dhe lartësinë e dënimit, ka zbatuar parimin e përgjegjësisë individuale të kryesve të veprës penale dhe sipas këtij parimi ka marrë parasysh të gjitha rrethanat qofshin ato lehtësuese apo rënduese që ndikojnë në matjen e dënimit për secilin bashkëkryes të veprës penale.

## **9. Vlerësimi ligjor i veprave penale**

Vepra penale “Importi, eksporti, furnizimi, transportimi, prodhimi, këmbimi, ndërmjetësimi ose shitja e paautorizuar e armëve apo materive plasëse nga neni 364 par.2 të KPRK, në formën e saj themelore përfshinë cilëndo nga veprimet e cituara alternative dhe vepra konsiderohet e kryer nga çdo kush i cili kryen cilëndo nga këto veprime me cilëndo armë, në mënyrë të paautorizuar. Në paragrafin 2 të nenit 364 të KPRK është parashikuar forma e rëndë e kësaj vepre penale kur bëhet fjalë për cilëndo veprim nga paragrafi 1 i këtij neni, e që ka të bëjë me më shumë se katër armë dhe më shumë se 400 fishekë, ashtu siç është edhe rasti me të akuzuarit në këtë çështje penale.

***Bashkëkryerja*** - Si formë e bashkëpunimit, përkatësisht e kryerjes së veprës penale sipas nenit 31 të KPRK të pjesës së përgjithshme të Kodit Penal të Republikës së Kosovës dhe është e precizuar, nëse dy apo më shumë persona së bashku kryejnë veprën penale duke marrë pjesë në kryerjen e veprës penale ose thelbësisht duke i kontribuar kryerjes së saj në ndonjë mënyrë tjetër, secili prej tyre është përgjegjës dhe dënohet me dënimin e paraparë për vepër penale.

Në nenin 36 par.1 të KPRK tek kufinjte e përgjegjësisë penale dhe ndëshkimit për bashkëpunim, bashkëkryesi është penalisht përgjegjës brenda kufijve të dashjes apo të pakujdesisë së vet.

***Vepra penale në vazhdim*** – si mënyrë e kryerjes së veprës penale sipas nenit 77 të KPRK përbëhet nga disa vepra të njëjta ose të ngjashme të kryera në lidhshmëri kohore nga të njëjtët kryes dhe të cilat paraqesin tërësi për shkak të ekzistimit të së paku dy prej kushteve, e që në këtë çështje penale është dashja e njëjtë dhe objekti i njëjtë i veprës penale.

***Sa i përket veprës penale Pjesëmarrja ose organizimi i grupit kriminal të organizuar nga neni 277 par.1 të KPRK***, ligjvënësi përcakton se kushdo që me dashje dhe me dijeni qoftë të qëllimit dhe veprimtarisë së përgjithshme të grupit kriminal të organizuar ose qëllimit të grupit për të kryer një apo më shumë vepra penale të cilat janë të dënueshme me burgim prej së paku katër (4) vjet, aktivisht merr pjesë në veprimtaritë kriminale të grupit duke ditur se pjesëmarrja e tillë do të kontribuojë në realizimin e veprimtarive kriminale të grupit.

Ndërsa në nenin 120 të KPRK tek Përkufizimet e termeve, termi Grupi kriminal i organizuar përkufizohet si - bashkimi i strukturuar, që ekziston për një kohë të caktuar të tre apo më shumë personave për kryerjen e veprave të caktuara penale, që vepron në bashkëpunim me qëllim të kryerjes së një apo më shumë veprave të rënda penale për përfitim të drejtpërdrejtë ose të tërthortë të dobisë financiare apo dobisë tjetër pasurore. Në të njëjtin nen termi bashkim i strukturuar përkufizohet si - bashkim i cili nuk është formuar rastësisht për kryerjen e menjëhershme të veprës penale, por nuk është e nevojshme që anëtarët e këtij bashkimi të kenë role formalisht të përcaktuara, vazhdimësi të anëtarësisë së tyre apo strukturë të ndërtuar.

Bazuar në elementet e veprës penale të krimit të organizuar, gjykata ka vlerësuar se në këtë çështje penale nuk është plotësuar elementi i pjesmarrjes së personave me dashje për kryerjen e veprimtarisë kriminale të grupit të organizuar dhe strukturuar, kjo për faktin se, për të ekzistuar krimi i organizuar, duhet të përmbushen katër karakteristika mandatore, pa të cilat nuk mund të ekzistoj krimi i organizuar si dhe së paku dy nga karakteristikat alternative të cilat e formojnë krimin e organizuar. Këto katër karakteristika bazë të krimit të organizuar janë: **1)** përfshirja e tre apo më shumë personave si grup i organizuar kriminal; **2)** për periudhë të gjatë ose të pacaktuar kohore; **3)** të dyshuar apo të dënuar për vepra penale të rënda (për të cilat përcaktohet dënimi me 4 (katër) vite burgim apo më shumë dhe **4)** me qëllim të përfitimit material apo të pushtetit <sup>53</sup>.

Përpos karakteristikave mandatore për të ekzistuar krimi i organizuar, grupi i ekspertëve të KE, ka përcaktuar edhe karakteristikat alternative e të cilat duhet së paku dy nga to të plotësohen, si karakteristika alternative konsiderohen: **1)** të ketë një rol ose detyrë të veçantë për secilin anëtar të grupit; **2)** përdorin ndonjë formë disipline ose kontrolli të brendshëm; **3)** përdorin dhunë ose forma tjera frikësuese; **4)** ushtrojnë ndikim tek politika, mediat, administrata publike, organet e zbatimit të ligjit; **5)** përdorin strukturë tregtare ose të ngjashme me biznesin; **6)** janë të përfshirë në pastrim parash; **7)** operojnë në nivel transnacional.

Këto karakteristikat që duhet të plotësohen për ekzistimin e veprës penale të krimit të organizuar, i kanë akceptuar dhe instrumentet me të rëndësishme ndërkombëtare në definimin e krimit të organizuar.

Është e rëndësishme se në këtë çështje penale përkatësisht në veprimet e të akuzuarve janë plotësuar disa nga këto karakteristika, nuk ka dilemë se në rastin konkret kemi të përfshirë në këtë vepër penale më shumë se tre persona, por nuk kemi të bëjmë me grup-kriminal të organizuar, por me disa njerëz kryesisht vëllezër të cilët kanë vepruar në vazhdimësi, herë pas here kanë ndërmarrë veprime në drejtim të kryerjes së veprës penale

---

<sup>53</sup> *List of Characteristics of Organized Crimes / Experts of Council of Europe - Lista e Karakteristikave të Krimit të Organizuar / Ekspertët e Këshillit të Evropës;*  
*UN Convention on Transnational Organized Crime (General Assembly Resolution 55/25 of 15 November 2000) - Konventa e OKB për Krimin e Organizuar Transnacional (Rezoluta 55 /25 e 15 nëntor 2000 e Asamblesë së Përgjithshme të OKB;*  
<https://www.unodc.org/e4j/en/organized-crime/module-1/key-issues/activities-organization-composition.html>

për të cilën janë shpallur fajtor. Për të ekzistuar krimi i organizuar grupi prej tre e më shumë personave duhet të jetë grup kriminal i organizuar e jo një përbërje e thjeshtë prej tre e më shumë personave<sup>54</sup>; Pastaj grupi kriminal i organizuar është përcaktuar si grupi strukturuar i tre e më shumë personave i cili ekziston për një periudhë të caktuar kohore me qëllim të kryerjes së një apo më shumë veprave të rënda penale, ndërsa në rastin konkret, gjykata, nga provat e administruara ka ardhur në përfundim se nuk kemi pasur një grup mirëfilli të organizuar me një strukturë udhëheqëse, ku definitivisht është ditur se kush është lideri i grupit, kush jep urdhër, kush janë zbatuesit e këtyre urdhrave dhe cilat janë detyrat e ndara për çdo njërin anëtar të grupit; cilat janë detyrat dhe përgjegjësit e caktuara, ndëshkimet në rast të mosbindjes së urdhrave, nëse ka frikësime, kërcënime, shantazhe apo ndonjë shprehje dhune, vrasje etj, ndërsa pretendimet e prokurorisë më shumë gjasojnë në marrëveshje e komunikime përbrenda të akuzuarve. Nga provat e administruara (përgjimi i telekomunikimeve të t'akuzuarve) ndërmjet vete shihet qartë se në raste të caktuara jo vetëm A F por edhe vëllezërit tjerë japin udhëzime në drejtim të kryerjes së veprës penale. Pra nuk ka ekzistuar ndonjë disiplinë, kontroll brenda grupit kriminal të organizuar, që të jep të kuptojmë se në rast të mos zbatimit të urdhrave të dhëna nga udhëheqësi i grupit do të ketë pasoja, që është karakteristikë e grupit kriminal të organizuar dhe kriminit të organizuar. Të akuzuarit kryesisht janë vëllezër të cilët në periudha të ndryshme kanë bashkëpunuar me njerëz të tjerë të ndryshëm, por jo se këta i ka ndërlidhur fakti i strukturës së organizuar, urdhër-dhënies dhe zbatimit të urdhrave, të akuzuarit kanë vepruar për një periudhë kohore të limituar të përshkruar sikurse në dispozitiv të aktgjykimit, mirëpo nuk mund të thuhet se kanë vepruar për një periudhë të gjatë kohore e cila mund të cilësohet si ndërmarrësi kriminale<sup>55</sup> në drejtim të kryerjes së veprave të natyrave të ndryshme kriminale. Vërtetë të akuzuarit kanë vepruar me qëllime përfitimi material, por nga hetimi financiar tek asnjëri nuk janë gjetur shuma të mëdha parash të deponuara në bankë, ata kanë patur marrëveshje ndërmejt vete për furnizim, transportim dhe shitje të armëve.

Pra, gjykata nuk vërtetoi se të njëjtit kanë vepruar në formën dhe mënyrën e paraparë me ligj për ekzistimin e kriminit të organizuar, nuk vërtetoi se të akuzuarit kanë marrë pjesë aktivisht<sup>56</sup> në aktivitetin e grupit të organizuar kriminal, ngase të njëjtit nuk kanë qenë të

<sup>54</sup> Neni 2 i Aneksit të Konventës së OKB për Krimin e Organizuar Trans-nacional;

<sup>55</sup> Ndërmarrësi kriminale - criminal enterprise e definuar sipas Konventës së OKB.

<sup>56</sup> Neni 277 par.5 të KPRK "aktivisht merr pjesë" përfshin, por nuk kufizohet në ofrimin e informatave ose mjeteve materiale, rekrutimin e anëtarëve të rinj dhe të gjitha format e financimit të veprimtarive të grupit.

vetëdijshëm se pjesmarrja e tyre do t'i kontribuonte kryerjes së krimeve të rënda si pjesë e grupit, andaj komfor nenit 360 par.2 të KPP për të akuzuarit bëri rikualifikimin ligjor të veprës penale duke i shpallur fajtor vetëm për vepër penale bazë të kryer në bashkëkryerje Importi, eksporti, furnizimi, transportimi, prodhimi, këmbimi, ndërmjetësimi ose shitja e pa autorizuar e armeve nga neni 364 par. 2 lidhur me nenin 31 të KPRK, të cilën veprë e kanë bërë me dije dhe me dashje, përkatësisht kanë qenë të vetëdijshëm për qëllimin e furnizimit, transportimit apo shitjes së armëve, si dhe për pasojën e ndaluar të veprimeve të tyre të kundërligjshme, por këtë qëllim e kanë dashur.

***Sa i përket vendimit për konfiskimin*** e sendeve të luajtshme të propozuara nga prokuroria, gjykata nuk gjeti asgjë kontestuese, pasi që të njëjtat ishin identifikuar lehtësisht, armët, fishekët e gjësendet tjera të ndërlidhura me armët, të gjitha të gjetura dhe të sekuestruara përkohësisht, automatikisht komfor nenit 364 par.4 të KPRK me vendim gjykata i konfiskoi përherë, ndërsa i konfiskoi përherë edhe veturat, telefonët dhe paratë e gjetura, si mjete të kryerjes së veprës penale, me të cilat të akuzuarit kanë bërë transportimin e armëve të lartshënuara, kanë tregtuar, kanë komunikuar mes vete për dhe lidhur me kryerjen e veprës penale, ashtu që siç parashihet në nenin 364 par.4 të KPRK gjithmonë armët dhe mjetet për transportimin e armëve, apo për prodhimin e armëve duhet të konfiskohen.

Sa i përket veturës “Xhip Suzuki” në posedim të t’pandehurit Sh H dhe armëve të gjetura në këtë veturë e cila është gjetur në oborrin e familjes së A Ft ditën që është bërë bastisja në pronën e tyre me datë 23.11.2013, gjykata ka vlerësuar se ato sende sipas detyrës zyrtare duhen konfiskuar përherë, si sende të rrezikshme që automatikisht duhet konfiskuar. Për të pandehurin Sh H gjatë zhvillimit të këtij shqyrtimi gjyqësor gjykata ka siguruar informacionin nga zyrtarë të Stacionit Policor në Viti se i njëjti ka vdekur, por ende gjykata nuk ka siguruar zyrtarisht dëshminë për vdekjen e të njëjtit andaj edhe nuk është pushuar proceduara. Për më shumë këto sende janë konfiskuar përherë edhe me aktgjykimin e nxjerrë jatë shqyrtimit të parë gjyqësor nga kjo gjykatë dhe, asnjëherë kjo çështje nuk ka qenë objekt i ndonjë ankese.

Ndërsa propozimin për konfiskimin e veturës “Golf 5” me targa 01-905-ET gjykata nuk e akceptoi, ngase në atë veturë nuk është gjetur asnjë armë, ndërsa pronari i të njëjtës ishte i akuzuari G i cili edhe është liruar nga akuza, ndërsa fakti që këtë veturë ia ka marrë vëllau

Ai për të shkuar në Maqedoni nuk është bazë për konfiskim, ngase nuk është provuar se në atë veturë është vendosur ndonjë lloj armatimi, edhe pse bazuar në komunikimet midis vëllezërve vetura gjatë kthimit nga H.Et në P me datë 21.09.2013 është ndaluar nga policia por nuk është raportuar për gjetje të armëve. Rrjedhimisht gjykata nuk gjeti bazë të arsyeshme për konfiskimin e kësaj veture, andaj të njëjtin komfor nenit 116 të KPP e liroi.

#### **10. Vlerësimi për dënimet e shqiptuara**

Me rastin e matjes së dënimit, gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese në kuptim të neneve 69 e 70 të KPRK që përcaktojnë llojin dhe lartësinë e dënimit për secilin të akuzuar. Gjkata, gjatë vendosjes për dënimin, nuk gjeti ndonjë rrethanë tejet lehtësuese por si rrethana relativisht lehtësuese ndaj gjithë të akuzuarve posaçërisht ndaj vëllezërve F, pati parasysh gjendjen e tyre materiale që është kryesisht mesatare, gjashtë nga të akuzuarit janë vëllezër, thujse të gjithë një kohë kanë qenë në masë të paraburgimit dhe gjendja e tyre financiare në familje është vështërsuar, të njëjtit janë mbajtës të vetëm të familjes, janë kryesisht të moshës së re me fëmijë, nga baza e të dhënave në gjykatë, nuk është vërtetuar me aktgjykim të formës së prerë, se më herët janë dënuar për ndonjë veprë të njëjtë apo të ngjashme penale, posaçërisht prej kur janë në liri. Poashtu vlenë të theksohet edhe sjellja e tyre korrekte gjatë tërë proqesit gjyqësor, asnjëherë nuk kanë munguar por kanë rrespektuar rendin dhe procedurën në gjykatore. Si rrethanë lehtësuese për të akuzuarin A pati parasysh edhe shprehjen e pendimit, pranimin e pjesshëm të fajsisë për veprën penale bazë. Të akuzuarit P dhe D F kanë kryer këtë veprimtari kriminale me armë vetëm gjatë vitit 2013 dhe jo më parë e as më vonë, dhe këtë rrethanë gjykata e pati parasysh si rrethanë gjithashtu lehtësuese për të njëjtit. Poashtu edhe për të akuzuarin K.S gjykata pati parasysh si rrethanë lehtësuese faktin se me vendim të formës së prerë para vitit 2013 apo pas kësaj kohe, nuk evidentohet si kryes i ndonjë veprë tjetër penale. Sa i përket të akuzuarit Xh.S gjykata pati parasysh si rrethanë rënduese faktin se i njëjti me atgjykim të formës së prerë PS.nr.39/2019 të datës 26.02.2021 është shpallur fajtor për veprë penale në vazhdimësi blerja, posedimi dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 273 paragrafi 2 të KPRK, lidhur me nenin 281 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 e 1.9 të KPRK dhe nenin 81 të KPRK, që ka të bëjë me transportin e narkotikut në rrugë ilegale nga Kosova në Maqedoni poashtu gjatë vitit 2018-2019. Gjithashtu edhe për të akuzuarit A, A dhe P F gjykata pati parasysh si rrethanë rënduese

faktin se përveç në vitin 2013 të njëjtit kanë vazhduar veprimtarinë kriminale edhe në periudhën e vitit 2018-2019 deri në arrestim.

Rrjedhimisht, pas vlerësimit të shkallës së pjesmarrjes dhe kontributit të secilit të akuzuar në kryerjen e veprës penale për të cilën janë gjetur fajtor, të njëjtëve gjykata u shqiptoi secilit dënimet e precizuara si në dispozitiv të këtij aktgjykimi. Gjkata vlerësoi se të gjitha dënimet janë adekuate dhe të drejta për secilin të akuzuar, me bindje se dënimet e tilla i përgjigjen peshës së veprës penale, sjelljeve dhe shkallës së përgjegjësisë penale të secilit të akuzuar, se do të ndikojnë në risocializimin e të njëjtëve, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit, gjithashtu, do të ndikojnë tek të tjerët në mos kryerjen e veprave penale dhe se, me dënime të tilla do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me nenin 38 të KPRK dhe në fund, me bindje se të akuzuarit në të ardhmen nuk do të përsërisin veprë tjetër penale të natyrës së tillë apo të ngjashme.

Vendimin për llogaritjen e kohës së kaluar në masë të paraburgimit në dënimin e shqiptuar për gjithë të akuzuarit, gjykata e mori në bazë të nenit 79 par.1 të KPRK.

Vendimin mbi shpenzimet e procedurës penale dhe paushallit gjyqësor, gjykata e mori në bazë të nenit 450 par.2 lidhur me nenin 453 par. 1 të KPP, ndërsa Vendimin për pagesën e taksës për kompensimin e viktimave të krimit, gjykata e mori në bazë të nenit 39 par.3 nënpar.3.2 të Ligjit Nr.05/L-036.

Vendimin mbi shpenzimet e procedurës penale dhe paushallit gjyqësor, gjykata e mori në bazë të nenit 450 par.2 lidhur me nenin 453 par. 1 të KPP.

Nga sa u tha më lartë dhe në bazë të nenit 365 të KPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

## **GJYKATA THEMELORE NË P/DEPARTAMENTI SPECIAL**

**PS.nr.5/2020, datë 15.12.2022**

**Vanesa Rama**  
**Zyrtare ligjore,**

**Suzana Çerkini**  
**Kryetare e trupit gjykues-gjyqtare,**

**UDHËZIMI JURIDIK:** Kundër këtij aktgjykimi, ankesë mund të paraqesin personat e autorizuar brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh, nga dita e dorëzimit të kopjes së aktgjykimit. Ankesa bëhet përmes kësaj Gjykate, për Gjykatën e Apelit në P.